

Qershor 2022
Numri: 171
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



LUTMUNI T'JU PËRGJIGJEM

(Bekare, 186)



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



Pa marrë parasysh se çfarë lloj shqetësimesh i ndodhin njeriut përgjatë jetës, të gjitha ato dhe zgjidhjet për to janë vetëm prej Allahut. Është e pamundur që njeriu të jetojë pa ndihmën hyjnore. Kurse ndihma hyjnore ka disa kushte. Sipas shprehjeve të mësipërme në letrën e Omerit, (r.a.), i njohur për largpamësinë dhe mendjemprehtësinë e tij, këto zgjidhje janë: Rregullimi i nijetit, shfaqja e durimit dhe rezistencës, të qenët një dhe përgjërimit ndaj Allahut me përkushtim. Ndihma kërkohet nga Allahu (xh.xh.). Sigurimi i kushteve të jashtme, marrja e masave paraprake dhe kryerja e asaj që e kemi për detyrë është lutje de facto, por kërkohet edhe përgjërimit. Kur Omeri i këshilloi Amrit (r.a.), nijet të pastër, zemër të dëlirë nga dynjaja e bidatet dhe përgjërimit që bëhet me zë të lartë, i tregoi gjithashtu se edhe nga kush duhet kërkuar ndihma në të vërtetë. Pikërisht si përgjigja e Ebu Bekrit, (r.a.), që ua dha atyre të cilëve i kërkuan ndihmë në Jermuk: “Në letrën tuaj më kërkoni t’ju dërgoj përforcime. Ju këshilloj të kërkoni ndihmë nga Allahu, i cili ka ushtarë të shumtë dhe gjithmonë të gatshëm dhe është më i fortë se kushdo. Siç e dini, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, fitoi në Ditën e Bedrit me një numër më të vogël forcash se ju.”

Po jetojmë në kohë të vështira, andaj duhet t’i kthehemi nefsit tonë. Morali i këtyre kohërave është të kesh një qëndrim që tërheq mëshirën hyjnore. Kur Ibrahim, alejhi’s-selam, i shkatërroi idhujt e popullit të tij dhe ia vari sëpatën në qafë idhullit më të madh, ai u tregoi me gisht atë idhullin e madh atyre që pyesnin: “Kush e bëri këtë?” Pastaj u tha: “Ndoshta këtë punë e ka bërë ky më i madhi. Hajt, pyetini ata nëse flasin!” Atëherë ata iu drejtuan ndërgjegjes së tyre dhe thanë: “Ju jeni keqbërësit!” (shik. Enbija, 64) Ne duhet të kthehemi te ndërgjegjja jonë dhe të zbulojmë se ku dhe si kemi gabuar. Ne e kemi lënë pas dore adhurimin, ndërkohë jemi dërguar me qëllimin për t’i bërë adhurim Zotit (xh.xh.). Ne paguajmë çmimin e atyre që bëjmë me ngushtimin e tokës dhe të zemrave tona.

Kur bëhet fjalë për moralin e kohëve të vështira, gjëja e parë që të vjen në mendje duhet të jetë istigfari (kërkimi i faljes nga Allahu). Meqenëse nuk kemi strehim tjetër përveç Allahut, ne kemi nevojë të pendohemi. Gjendja shpirtërore e atyre tre sahabëve, të cilët iu nënshtruan një izolimi 52-ditor pas luftës së Tebukut, përshkruhet si vijon: **“Ai ua pranoi pendimin edhe atyre të treve, që mbetën prapa atëherë, kur toka, sado e gjerë, iu duk e ngushtë dhe iu shtrënguan shpirtat, aq sa u bindën se nuk ka strehim tjetër përveç Allahut e pastaj Allahu u dha mëshirë që të pendohen. Me të vërtetë, Allahu pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë.”** (Teube, 118)

Qershor 2022

VITI: XVI

NUMRI: 171

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t’i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Ramazani në karantinë
Ali Riza Temel

15

Përmbajtja




8

Hapja e një dritareje
për zemrat e tymosura
Dr. Adem Ergyl



Shtëpia e parë në tokë dhe itikafi
Ahmet Hamdi Jëlldërëm

18




24



34

Shoqëri që kishte arritur prehjen
Osman Nuri Topbash

- 5 Edukata e Lutjes
Mehmet Lutfi Arslan
- 10 Sjellja e mirë ndaj prindërve
Prof. dr. M. Jashar Kandemir
- 22 Gjatë periudhave të sëmundjes
M. Sami Ramazanollu
- 23 Vendosmëria në fe
M. Sami Ramazanollu
- 24 Gara për në xhenet
Ali Riza Temel
- 26 Stacioni shpirtëror i kënaqësisë ndaj Zotit
Ibn Kajim El-Xheuzije
- 29 Rinia dhe xhamia
Prof. dr. Mehmet Gërmez




48

- Rrapi që quhet mëshirë 30
Mehmet Dinç
- Popullsia e botës dhe siguria ushqimore 32
Dr. Halil Kurt
- Mbi natyrën e vërtetë të lumturisë 40
Shah Veli Allah El-Dehlevi
- Stresi do të jetë gjithmonë ai që e përballon do të fitojë 42
Doç. dr. Fërat Erdoan
- Vetëllogaria sociale: Përse jemi në këtë gjendje 46
Idris Arpat
- Llogaria ne namazit 48
Xhafer Durmush
- Kurbani dhe vetëdija për devotshmëria 52
Dr. Kerim Bulladë
- Puna e mirë dhe jeta e bukur 55
A. Jasin Demirxhi



44

Dëshmorët nuk vdesin
Osmar Ersan



Udhëzimi në rrugën e drejtë
Sadik Dana

50

EDUKATA E LUTJES

Kur bëhet fjalë për moralin e kohëve të vështira, gjëja e parë që të vjen në mendje duhet të jetë istigfari (kërkimi i faljes nga Allahu). Meqenëse nuk kemi strehim tjetër përveç Allahut, ne kemi nevojë të pendo kemi. Le të krahasojmë gjendjen tonë aktuale me atë të mëparshmen: Nëse përgjërimit dhe lutjet tona janë shtuar, ka të ngjarë që shpëtimi të vijë së shpejti. Dera e pendimit, të cilën Zoti e mban gjithmonë të hapur, është pasqyrimi i mëshirës së Tij që na rrethon. Mëshira do t'i arrijë ata që mund të hyjnë nga ajo derë dhe si rrjedhojë, toka dhe zemrat tona do të zgjerohen përsëri.

— Mehmet Lutfi Arslan —

Amr ibn Asi, (r.a.), i cili çliroi Kudsën në vitin 640, mendonte se Egjipti ishte objektivi i radhës për t'i dhënë fund dominimit bizantin në rajon. Ai e informoi kalifin, Omerin, (r.a.), për situatën dhe i kërkoi leje për të përparuar. Kur erdhi miratimi, u nis me ushtrinë e tij prej 4000 vetash dhe hyri në Egjipt. Banorët vendas, të cilët ishin tërësisht të tronditur nga administrata bizantine, e pritën me entuziazëm ardhjen e myslimanëve. Megjithatë, përparimi u ndal pas një kohe. Kur Amri (r.a.), njoftoi se duhet të vijnë përforsime nga qendra, në mënyrë që çlirimi të ishte më i shpejtë, Omeri i dërgoi një letër Amrit së bashku me një forcë shtesë prej pesë mijë vetash. Në këtë letër, kalifi rendiste disa rekomandime që duheshin bërë për të marrë ndihmën hyjnore.

Përmbajtja e kësaj letrë, e cila pasqyrore linjat e karakterit të Omerit (r.a.), është shumë e rëndësishme në këtë trazirë ku qeniet njerëzore iu dorëzuan një virusi të padukshëm dhe i kthyen sytë nga qielli. Omeri e nxori në pah me një largpamësi që e shfaqte qartë cilësinë e tij Faruk (ai që e ndan të

vërtetën nga e pavërteta) se në cilat kushte mund të vinte ndihma hyjnore dhe se çfarë duhej bërë për këtë në planin njerëzor. Në këtë mënyrë shfaq një shembull të shkëlqyer të udhëheqjes. Përsëri, kjo letër është një dokument interesant që tregon qëndrimin e kalifit, i cili ishte i mallëngjyer për të shprehur dëshirën e tij më të madhe në jetë në formën “një dhomë plot me burra si Ebu Ubejde ibn Xherrahu”, duke theksuar kështu përcaktuesin bazë të cilësisë së njeriut. Le ta lexojmë:

“O Amr! Jam shumë i habitur që ende nuk e keni çliruar Egjiptin. Ju keni luftuar me ta për një kohë të gjatë. Për mendimin tim, arsyeja pse nuk ia keni dalë mbanë është sepse ju keni filluar ta doni botën si ata dhe keni shpikur disa risi. Allahu i Madhëruar i ndihmon vetëm ata që kanë qëllim të sinqertë. Unë po të dërgoj katër persona për t'ju ndihmuar. Këta persona janë Zubejr ibn Avvami, Mikdad ibn Esved ibn Amri, Ubade ibn Thabiti dhe Mesleme ibn Muhal-ledi.



Nëse bota që i mashtron të tjerët nuk i ka mashtruar ata, secili prej këtyre personave vlen sa një mijë persona. Kur ta marrësh letrën time, mbaj një hytbe dhe inkurajoji ushtarët që të luftojnë kundër armikut me nijet të sinqertë duke shfaqur durim e rezistencë. Thuaju atyre të luftojnë si një trup i vetëm, si të ishin një njeri! Futi ndërmjet ushtarëve edhe ata katër personat! Aktivizoje ushtrinë ditën e xhuma (e premte) menjëherë pasi dielli të kalojë kupën e qiellit! Sepse në atë orë zbret mëshira hyjnore dhe lutjet pranohen. Së bashku, lutjuni Allahut me zë të lartë dhe kërkujini Atij t'ju ndihmojë kundër armiqve tuaj.”

Në këtë kohë kur një virus e ka futur jetën tonë në ngërç, a nuk jemi pikërisht ne adresuesit e deklaratave në këtë letër të cilët kemi nevojë për ndihmën e Allahut? Ne kemi filluar ta duam këtë botë si të pafetë, kemi shpikur bidate dhe kemi prishur nijetin tonë. Atëherë Allahu Teala na e ngushtoi të gjithëve këtë botë, e cila nuk ka vlerë as sa krahu i një mize te Ai. Fakti që nuk jemi në gjendje të jetojmë ashtu siç jemi mësuar, na i shtrëngoi zemrat. Kjo tokë e shtrirë me gjithë gjerësinë e saj, malet e vendosura, lumenjtë, bimët, frutat, kafshët dhe ardhja në mënyrë të vazhdueshme e natës dhe ditës, u zhdukën nga sytë tanë në një çast. Të gjitha ishin shenja nga të cilat duhej të merrnim mësim, por ne nuk morëm. Atëherë u shfaq një shenjë tjetër me gjithë madhështinë e saj: **“A nuk e shohin ata se Ne po ua zvogëlojmë tokën nga skajet e saj? Allahu gjykon, dhe askush nuk mund ta thyejë gjykimin e Tij; Ai është i shpejtë në llogari.”** (Rad, 41)

Si zvogëlohet toka? Ja, virusi na e tregoi këtë. Ai Fuqiptoti Suprem, që zgjeron dhe ngushton gjithçka, papritmas gjykoj në atë mënyrë që toka, pavarësisht

nga pafundësia e saj, filloi të na dukej e ngushtë të gjithëve. Fuqia marramendëse (e njeriut) u kthye në shtypje e poshtërim. Askush nuk mundi ta largonte atë që ndodhi, as nuk mundet. Allahu i Madhëruar e kreu punën në një çast, me një lëvizje dhe me një shpejtësi të madhe. Ai deshi dhe gjithçka ndodhi. Nëse tani nuk do të dojë Ai, kush mund të na kthejë tek gjendja jonë e mëparshme?

Ai mund të na kthejë në gjendjen tonë të mëparshme. Askush tjetër nuk mund të na bëjë dobi. Pa marrë parasysh se çfarë lloj shqetësimesh i ndodhin njeriut përgjatë jetës, të gjitha ato dhe zgjidhjet për to janë vetëm prej Tij. Është e pamundur që njeriu të jetojë pa ndihmën hyjnore. Kurse ndihma hyjnore ka disa kushte. Sipas shprehjeve të mësipërme në letrën e Omerit, (r.a.), i njohur për largpamësinë dhe mendjemprehtësinë e tij, këto zgjidhje janë: Rregullimi i nijetit, shfaqja e durimit dhe rezistencës, të qenët një dhe përgjërimi ndaj Allahut me përkushtim.

Përgjërimi ndaj Allahut (xh.xh.), ka momente të caktuara. Letra e përshkruan atë si të premtën pas zenitit. Në këtë kohë zbret mëshira dhe pranohen lutjet. Një kusht tjetër është që përgjërimi të bëhet me zë të lartë. Lutjet, tekbirot dhe dhikri me zë të lartë tërheqin mëshirën. Në veçanti, tekbirot është një mundësi e rëndësishme për të ardhur ndihma e kërkuar. Kjo mundësi nuk i është dhënë kurrë asnjë umeti më parë. Kjo është e qartë në fjalët e mëposhtme të Sad ibn Ebi Vakkasit, (r.a.), drejtuar ushtarëve të tij para një lufte:

“Mos u largoni nga vendet tuaja dhe mos lëvizni kurrë deri pas faljes së namazit të drekës. Pas faljes së namazit të drekës, do të them një tekbirot. Pastaj edhe ju thoni tekbirot pas meje. Dijeni se ky tekbirot nuk i është dhënë askujt dhe asnjë populli para jush. Ky tekbirot ju është dhënë për përforsim. Pastaj do të them një tekbirot të dytë. Pastaj edhe ju jepni tekbirot dhe përfundojini përgatitjet tuaja. Kur të them tekbirot për të tretën herë, edhe ju jepni tekbirot përsëri. Pastaj kalorësia le t'i inkurajojë të tjerët të luftojnë dhe të zbrapsin armikun. Në tekbirotin e katërt, sulmoni të gjithë së bashku dhe në të njëjtën kohë thoni: “La havle vela kuvvete il-la bi'l-lah!”

Ndihma kërkohet nga Allahu (xh.xh.). Sigurimi i kushteve të jashtme, marrja e masave paraprake dhe kryerja e asaj që e kemi për detyrë është lutje de facto, por kërkohet edhe përgjërimi. Kur Omeri i këshilloi Amrit (r.a.), nijet të pastër, zemër të dëlirë nga dynjaja e bidatet dhe përgjërimit që bëhet me zë të lartë, i tregoi gjithashtu se edhe nga kush duhet

Po jetojmë në kohë të vështira, andaj duhet t'i kthehemi neftit tonë. Morali i këtyre kohërave është të kesh një qëndrim që tërheq mëshirën hyjnore.

kërkuar ndihma në të vërtetë. Pikërisht si përgjigja e Ebu Bekrit, (r.a.), që ua dha atyre të cilëve i kërkuan ndihmë në Jermuk: “Në letërën tuaj më kërkoni t’ju dërgoj përforcime. Ju këshilloj të kërkoni ndihmë nga Allahu, i cili ka ushtarë të shumtë dhe gjithmonë të gatshëm dhe është më i fortë se kushdo. Siç e dini, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, fitoi në Ditën e Bedrit me një numër më të vogël forcash se ju.”

Omeri pati thënë: “Ju kam dërguar katër veta, secili prej tyre vlen sa një mijë veta.” Ata katër veta ishin burra të veçantë secili më i çmuar se tjetri, ishin njerëz që kishin fituar nderin e të qenët pasues të të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishin të egër kundër jobesimtarëve dhe të mëshirshëm mes tyre, njerëzit shpesh i shihnin në ruku e në sexhde dhe që jetonin duke kërkuar mirësinë e Allahut (xh.xh.). Një kusht tjetër për pranimin e lutjes është ekzistenca e këtyre “burrave”, të cilët nuk mashtrohen nga kjo botë e cila i mashtron të gjithë. Ata janë siguria e shoqërisë. Ata katër shokë të Profetit, të cilët Omeri i dërgoi me një ushtri prej 5000 vetash, ishin njerëz shembullorë me qëllimet e tyre, qëndrimin e tyre ndaj kësaj botë dhe qëndrimin e tyre larg risive (bidateve). Ja pra, burrat si këta janë burra shembuj konkretë për njetin e sinqertë, për të mos i ngjarë jobesimtarit dhe për të qëndruar larg bidateve. Siç përshkruhet nga Alparsllani, Çliruesi i Malazgirtit, “myslimanët e pastër që nuk dinë se çfarë është bidati” janë dëshmitarët e vullnetit të Allahut në tokë. Personaliteti dhe karakteri që shfaqin ata janë garancia e ekuilibrit. Mungesa e këtyre individëve, qëndrimi i të cilëve është një lutje në vetvete, ose thyerja e zemrës së tyre mund të shkaktojnë prishje të ekuilibrit.

Për ata që i kthejnë sytë nga qielli dhe pyesin: “Kur do të vijë ndihma e Allahut?”, është e qartë ajo që duhet të bëjnë: Nijeti duhet të rregullohet dhe duhet të rishikohet qëndrimi kundrejt kësaj bote. Dëlirësia e zemrës, nijeti i sinqertë dhe pastërtia në fe janë shenja dalluese të qëndrimit kundrejt kësaj bote. Bota nuk mund të kthehet në normalitet pa të devotshmit dhe të sinqertët, të cilët dynjaja nuk mund t’i mashtrojë, dhe pa lutjen e tyre të sinqertë. Ajo që duhet të bëjmë është t’i gjejmë ata njerëz, të ndreqim zhgënjimin e zemrave të tyre nëse janë zhgënjyer, dhe më e rëndësishmja, të përpiqemi të jemi njerëz me pjekurinë dhe qëndrimin e sahabëve, të cilët jetuan vazhdimisht në një gjendje lutjeje ndaj Zotit.

Po jetojmë në kohë të vështira, andaj duhet t’i kthehemi neftit tonë. Morali i këtyre kohërave është



Askush tjetër nuk mund të na bëjë dobi. Pa marrë parasysh se çfarë

lloj shqetësimesh i ndodhin njeriut përgjatë jetës, të gjitha ato dhe zgjidhjet për to janë vetëm prej Tij. Është e pamundur që njeriu të jetojë pa ndihmën hyjnore. Kurse ndihma hyjnore ka disa kushte.

të kesh një qëndrim që tërheq mëshirën hyjnore. Kur Ibrahim, alejhi’s-selam, i shkatërroi idhujt e popullit të tij dhe ia vari sëpatën në qafë idhullit më të madh, ai u tregoi me gisht atë idhullin e madh atyre që pyesnin: “Kush e bëri këtë?” Pastaj u tha: “Ndoshta këtë punë e ka bërë ky më i madhi. Hajt, pyetini ata nëse flasin!” Atëherë ata iu drejtuan ndërgjegjes së tyre dhe thanë: “Ju jeni keqbërësit!” (shik. Enbija, 64) Ne duhet të kthehemi te ndërgjegjja jonë dhe të zbulojmë se ku dhe si kemi gabuar. Ne e kemi lënë pas dore adhurimin, ndërkohë jemi dërguar me qëllimin për t’i bërë adhurim Zotit (xh. xh.). Ne paguajmë çmimin e atyre që bëjmë me ngushtimin e tokës dhe të zemrave tona.

Kur bëhet fjalë për moralin e kohëve të vështira, gjëja e parë që të vjen në mendje duhet të jetë istigfari (kërkimi i faljes nga Allahu). Meqenëse nuk kemi strehim tjetër përveç Allahut, ne kemi nevojë të pendohemi. Gjendja shpirtërore e atyre tre sahabëve, të cilët iu nënshtruan një izolimi 52-ditor pas luftës së Tebukut, përshkruhet si vijon: **“Ai ua pranoi pendimin edhe atyre të treve, që mbetën prapa atëherë, kur toka, sado e gjerë, iu duk e ngushtë dhe iu shtrënguan shpirtat, aq sa u bindën se nuk ka strehim tjetër përveç Allahut e pastaj Allahu u dha mëshirë që të pendohen. Me të vërtetë, Allahu pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë.”** (Teube, 118)

Le të krahasojmë gjendjen tonë aktuale me atë të mëparshmen: Nëse përgjërimit dhe lutjet tona janë shtuar, ka të ngjarë që shpëtimi të vijë së shpejti. Dera e pendimit, të cilën Zoti e mban gjithmonë të hapur, është pasqyrimi i mëshirës së Tij që na rrethon. Mëshira do t’i arrijë ata që mund të hyjnë nga ajo derë dhe si rrjedhojë, toka dhe zemrat tona do të zgjerohen përsëri. Së fundi, Ai është që zgjeron dhe ngushton, Ai është ai që jep jetë dhe e merr atë...

HAPJA E NJË DRITAREJE PËR ZEMRAT E TYMOSURA

— Dr. Adem Ergyl —

Sheh Sa'di Shirazi, një nga burimet ushqyese të traditës sonë të urtësisë dhe mençurisë, ka një thënë të bukur në lidhje me njeriun: “Njeriu është një qenie e përbërë nga një pikë gjaku dhe qindra mijëra shqetësime e probleme.” Po, është një derë e madhe mëshire për një rob që të arrijë të jetë i dobishëm në hapjen e dritareve të paqes dhe lumturisë në dhomat e ndërthurura të sprovës për një qenie si njeriu dhe të përpiqet t'i shpërndajë shumë re të pikëllimit dhe dëshpërimit që pushtojnë zemrën e tij.

Fjalitë e mëposhtme të Xhelaleddin Rumiut, një prej shehlerëve tanë të Anadollit, hedhin dritë mbi këtë të mirë të madhe:

“Zemrat që përpëlitën në varfëri e nevojë i ngajnë një shtëpi plot tym. Andaj hap një dritare në atë shtëpi me tym duke dëgjuar shqetësimet e tyre, në mënyrë që të dalë tymi. Kurse ty të të zbutet zemra dhe të të lartësohet shpirti.”

Ata që ua lehtësojnë robërve të Allahut, jo ata që shkaktojnë vështirësi, janë robër të pranueshëm te Ai. Nëna jonë, Aishja, (r.a.), tregon siç vijon:

Në shtëpinë time e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke thënë:

“O Allah! Kushdo që merr përsipër administrimin e umetit tim dhe i shkakton vështirësi, edhe ti nxirri vështirësi. Kushdo që merr përsipër administrimin e umetit tim dhe sillet me butësi ndaj tyre, edhe ti sillu me butësi.” (Muslim, Imare, 19.)

Sipas asaj që transmetohet nga Aidh ibn Amri, (r.a.), ai shkoi te Ubejdullah ibn Zijadi (r.a.) dhe i tha:

“Biri im! E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke thënë: *“Më të këqijtë nga udhëheqësit janë të pamëshirshmit dhe zemërgurët.”* Bëj kujdes që të mos jesh një nga ata udhëheqës!” (Muslim, Imare, 23.)

Aq sa të jetë mirëkuptues, i mëshirshëm dhe i butë kryefamiljari ndaj anëtarëve të familjes, pronari ndaj punëtorëve dhe administruesit në çdo nivel ndaj atyre që kanë në vartësi të tyre, edhe Zoti ynë, i Cili është Zoti i botëve, do t'i trajtojë ata në të njëjtën mënyrë.

Sa sjellje e mirë është këshilla e shtetit tonë për të mbrojtur të varfrit, të pastrehët dhe të papunët, madje edhe punëdhënësit sidomos në këto ditë pandemie duke u thënë (punëdhënësve): “Ju ndihmojmë ne si shtet, në mënyrë që edhe ju të mos hiqni njeri nga puna.” Kush e di, ndoshta manifestime



të tilla të mëshirës do të tërheqin mëshirën e Zotit mbi vendin tonë dhe ne do të shpëtojmë nga kjo fatkeqësi me mirësinë e Zotit (xh.xh.), pa humbje të tjera.

Transmetohet nga Hudhejfe, (r.a.), se:

Një nga robërit të cilit Allahu i kishte dhuruar pasuri u soll para Allahut të Madhëruar. Allahu Teala e pyeti:

– Çfarë ke bërë në dynja? Robi i tha:

– O Zot! Ti më pate dhënë pasuri. Kështu që unë bëja tregti me njerëzit. Ishte zakoni im të tregoja lehtësi në shitblerje. Ua lehtësoja të pasurve dhe u jepja afat të varfërve. Nisur nga kjo, Allahu i Madhëruar i tha:

“Unë jam më i denjë për këtë se ti.” Andaj (engjëjve) u tha: “Faleni robin Tim!”

Ukbe ibn Amiri dhe Ebu Mes’ud el-Ensariu, (r.a.) uma, kanë thënë:

“Ne e kemi dëgjuar këtë kështu nga goja e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të.” (Muslim, Musakat, 29.)

Po, ndihma ndaj atij që ka borxhe dhe atij që është në vështirësi, veçanërisht në kohë të tilla të vështira që po kalojmë, dhe shfaqja e lehtësisë ndaj robërve të Zotit nga ata që kanë mundësi, do të jetë e dobishme për hapjen e shumë dyerve të mëshirës dhe kush e di, ndoshta do të kthehet në një çelës për hyrjen në xhenet të tyre. Kjo për shkak se Zoti (xh. xh.), tërheq vëmendjen për këtë çështje të ndjeshme si më poshtë dhe pothuajse u tregon robërve të Tij derën për fitimin e të ardhurave të mëdha:

“Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin (e shlyerjes së borxhit) derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t’ia falni borxhin, veç sikur ta dinit.” (Bekare, 280)

Sipas asaj që transmetohet nga Ebu Hurejre, (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Ishte një njeri që u jepte para njerëzve hua. Ai i thoshte shërbëtorit të tij:

“Kur të shkosh te një i varfër në vështirësi, fale atë. Shpresojmë që edhe Allahu t’i falë mëkatet tona. Më në fund, ai njeri shkoi te Allahun (ndërroi jetë) dhe Allahu e fali atë.” (Buhari, Enbija, 54; Muslim, Musakat, 31.)

Ka periudha kur ndjeshmëria dhe brishtësia e njerëzve shtohen. Ka raste kur njeriut i ndërron jetë një i afërm, kur është në telashe të mëdha, kur bie në gjendje nevojtar i ndërkohë që ishte i pasur, kur e humbet statusin prestigjioz që kishte dhe shumë

të tjera... Në momente të tilla bota shpirtërore është jashtëzakonisht e brishtë. Është një mirësi shumë e madhe për njerëzit pranë dhe afër tij, për miqtë e tij dhe ata që janë në pushtet e që kanë mundësi që ta rrisin interesin e tyre ndaj një njeriu në situatë të tillë dhe ta ndihmojnë atë sa më shumë. Ata që kanë rënë në situata të tilla e dinë shumë mirë se sa e madhe është të ngjallësh shpresë tek të pushpresët, t’u japësh kurajë atyre që janë dekurajuar, t’i këshillosh ata për durim me fjalë të mira dhe ndoshta më e rëndësishmja, t’i dëgjosh dhe të lutesh solemnisht për ta për t’u treguar që e kuptoni gjendjen e tyre. Fakti se “një prej adhurimeve më të rëndësishme pas farzeve është t’u japësh lumturi zemrave të njerëzve” (Taberani, Kebir, XI, 71/11079), kuptohet shumë më mirë në momente të tilla.

Të shfaqësh sjellje të mira që nuk mbjellin largësi, mëri dhe armiqësi në zemra, por që marrin lutje nga shumë të tilla është shenjë e përsosmërisë (pjekurisë). Kohët e vështira janë sezona korrrjesh të frytshme për ata që kanë mundësi dhe fuqi, nëse i shndërrojnë në kapital të ahiretit të tyre.

Do të doja të flisja për një ngjarje që më vjen në mendje meqë po flasim për lutjen dhe që më ka prekur mua shumë. Haxhi Muamer Topbashi, vëllai i Sahibu’l-vefa Musa Efendiut, është një personalitet i lartë dhe bujar. Madje ai është aq shumë bujar sa që mori komplimentin e Musa Efendiut: “Muameri është më bujari në familje.” Sipas asaj që tregon zoti Ali Ulvi Kurucu, kur iu prish puna zoti Muamerit në vitin 1975, fjalët që tha për të një mik i tij nga Shoqata “Ilim Jajma”, zoti Fehmi Bilge, dëshmojnë se ai ishte një njeri i devotshëm që i ndihmonte besimtarët dhe nxitonte për të bërë bamirësi.

Zoti Fehmiu u paralizua afër vdekjes së tij. Djali i tij Mustafa Bilge tregon:

Erdha në shtëpi një mbrëmje. Babanë e gjeta duke qarë. U mërzita dhe e pyeta.

“Baba, a të janë shtuar shumë dhimbjet?” Babai më tha:

“Jo bir, nuk po qaj për veten dhe dhimbjet e mia. Zoti Muamerit i ishte prishur biznesi, andaj po qaj. Sepse nënat nuk mund të lindin më një Muamer. Ne kemi punuar me të te Ilim Jajmaja për më shumë se njëzet vjet. Ai ishte më bujari, ai që fliste më pak dhe ai që ulej më afër derës (më modesti) ndërmjet nesh. A mund të gjendet një njeri i tillë?”

Po, atyre që hapin një dritare paqeje dhe frymëmarrjeje për zemrat e dëshpëruara Zoti (xh.xh.), u hap shumë dritare.

SJELLJA E MIRË NDAJ PRINDËRVE

— Prof. dr. M. Jashar Kandemir —

Allahu Teala ka urdhëruar të sillemi mirë ndaj prindërve. Nisur nga kjo:

Të gjithë duhet të sillen mirë ndaj prindërve dhe të jenë mirënjohës kundrejt tyre.

Nëse njëri prej tyre apo që të dy plaken pranë fëmijëve të vet, fëmijët nuk duhet t'u thonë as "of!"

Nuk duhet t'i qortojnë.

Duhet t'u thonë fjalë të buta dhe të mira.

Duhet t'ua hapin krahët me dhembshuri dhe të luten ashtu siç na mëson Allahu Teala në Kurani Fisnik:

"O Zot! Mëshiroji ata siç më rritën duke u përkujdesur për mua kur isha i vogël!"

Allahu Teala njofton se dikur mori premtimin prej Beni Israilëve, se ata do të silleshin mirë ndaj prindërve.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nën dritën e këtyre ajeteve fisnike, ka bërë disa paralajmërime të rëndësishme në lidhje me çështjen e bindjes dhe mirësisë ndaj prindërve:

"Njëra prej gjërave që e gëzon shumë Allahun Teala, është mirësia dhe bindja e njeriut ndaj prindërve të tij."

"Një fëmijë nuk mund ta paguajë kurrë hakun e babait, përveçse në një rast: Nëse e gjen babanë e tij rob, e blen dhe e liron atë."

HAKU I NËNËS

Nënat i mbartin fëmijët në barqet e tyre duke hequr vuajtje të mëdha dhe i sjellin në këtë botë me shumë vështirësi. Haku i nënës është i pamundur të paguhet, ngaqë rritja dhe edukimi i fëmijës nuk është më pak i vështirë se mbartja e tij në bark.

Një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe e pyeti:

-Ndaj kujt duhet të sillem më mirë dhe t'i shërbej më shumë?

-Nënës tënde!

-Po pas saj, ndaj kujt?

-Nënës tënde!

-Po pas saj?

-Përsëri ndaj nënës tënde?

-Po pas nënës sime?

-Babait tënd!

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka treguar se haku i nënës është aq i madh, saqë nuk mund të matet me asnjë tjetër.

Edhe nëse nëna nuk është myslimane, fëmijët e kanë për detyrë ta respektojnë dhe të sillen mirë ndaj saj.

Nëna e vajzës së Ebu Bekrit, pra nëna e Esmasë, akoma nuk e kishte pranuar Islamin.

Gruaja e shkretë shkoi një ditë për të vizituar vajzën e saj. Esmaja, radijallahu anha, nuk po dinte çfarë të bënte. Nëna e saj ishte adhuese e idhujve. Vallë, a ishte e drejtë ta merrte brenda atë?

Shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe e pyeti:

"Nënën e kishte marrë malli për mua dhe ka ardhur te shtëpia ime. A mund ta nderoj atë?" I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

"Po! Sillu mirë ndaj nënës tënde!"

Sahabi i nderuar, Harithe bin Nu'mani sillej shumë mirë ndaj nënës së tij. Një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), pa një ëndërr. Ndodhej në xhenet dhe Harithe ishte aty duke lexuar Kuran.

Pasi ua tregoi sahabëve të nderuar ëndrrën, u

shpreh: “Ja, kjo është mirësia.” Pastaj tha se Harithe, radijallahu anhu, e ka fituar xhenetin, për shkak se është sjellë mirë ndaj nënës.

GJYSMA E NËNËS

Një burrë i tha të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

-O i Dërguari i Allahut! Kam bërë një mëkat të madh. A më pranohet pendimi, nëse pendohem?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti:

-A i ke prindërit?

-Jo, nuk i kam.

-A ke teze?

-Po, kam.

-Atëherë, sillu mirë ndaj saj!

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha se njeriu mund të shpëtojë nga mëkati duke u sjellë mirë ndaj tezes, e cila është “gjysma e nënës”, nëse nuk i ka prindërit.

DUHET T’I GËZOJË ATA

Prindërit janë garancia e xhenetit për fëmijët dhe shkak që ata të hyjnë në xhenet nga dera kryesore.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë tri herë: “U shkatërroftë!”, për atë pranë të cilit prindërit arrijnë ditët e pleqërisë dhe ai nuk mund të hyjë në xhenet. Po ashtu, është shprehur se fëmijët që nuk i gëzojnë prindërit në periudhën e fundit të jetës së tyre, janë në një humbje të madhe.

Një sahab erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe i kërkoi leje për xhihad. Hazreti Pejgamberi (s.a.s.), e pyeti:

-A i ke gjallë prindërit?

-Po, që të dy janë gjallë.

-Atëherë shko dhe përpiqu t’u shërbesh atyre!

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tregoi se shërbimi ndaj prindërve është më i vlefshëm se xhihad i nafille.

Dikush tjetër i tha të Dërguarit të Allahut, (a.s.), se kishte ardhur të luftonte bashkë me Të apo të shpërngulej te Ai duke i lënë prindërit me lot në sy. Pejgamberi, alejhi’s-selam, i tha:

“Menjëherë kthehu pranë prindërve dhe gëzoji, siç i ke bërë të qajnë!”

Të gjitha këto ngjarje tregojnë këtë:

Ai që i gëzon prindërit, fiton kënaqësinë e Allahut Teala. Ndërsa ai që i zemëron prindërit, tërheq zemërimin e Allahut të Madhëruar.

PRINDËRIT NUK DUHET TË KUNDËRSHTOHEN

Kundërshtimi i prindërve është një mëkat shumë i madh.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), foli rreth mëkateve më të mëdha, së pari përmendi kundërshtimin ndaj Allahut të Madhëruar dhe pastaj kundërshtimin ndaj prindërve.

Po, mëkati më i madh prej mëkateve të mëdha është adhurimi i diçkaje tjetër për zot, përveç Allahut dhe mosrespektimi i prindërve.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha se ofendimi dhe mallkimi i prindërve prej fëmijëve të tyre janë prej mëkateve të mëdha.

Sahabët u habitën nga kjo dhe i thanë:

-Si mund t’i ofendojë dikush prindërit e tij?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u përgjigj:

“Vjen dhe ofendon babain e dikujt tjetër. Edhe ai ia ofendon babanë. Ofendon nënën e dikujt. Edhe ai ia ofendon nënën e atij.” Në këtë mënyrë, ka ofenduar prindërit e tij.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e përdorte shumë pak mallkimin, por megjithkëtë, tha:

“Allahu e mallkoftë atë që mallkon prindërit e tij.”

Hazreti Pejgamberi, alejhi’s-selam, na ka mësuar:

Allahu i Madhëruar e ka ndaluar kategorikisht mosbindjen ndaj prindërve.

Ja pra, për këtë arsye nuk mund të hyjnë në xhenet ata që i kundërshtojnë prindërit e tyre.

PAS VDEKJES SË PRINDËRVE

Detyrat e fëmijëve kundrejt prindërve të tyre nuk mbarojnë edhe pas vdekjes. Kanë detyra të tjera edhe pasi ata t’i japin lamtumirën jetës së kësaj bote.

Një sahab e pyeti të Dërguarin e Allahut, (a.s.), për këtë:

-A ka ndonjë mirësi që mund ta bëj për prindërit pasi ata të ndërrojnë jetë?

Hazreti Pejgamberi, alejhi’s-selam, iu përgjigj:

-Po, duhet të lutesh për ta dhe të kërkosh (nga Allahu) që t’ua falë mëkatet e tyre,

Të zbatosh porositë e tyre,

Të mbrosh të afërmit e tyre dhe

Të nderosh miqtë e tyre.”

Fëmijët duhet të sillen mirë ndaj mikut të babait, madje edhe ndaj familjes së tij. Duhet t’i mbrojnë dhe t’i ndihmojnë ata.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka cilësuar këtë si mirësinë më të vlefshme.

SI DUHET TË LUTEMI PËR PRINDËRIT?

Kurani Fisnik na mëson se si duhet të lutet një fëmijë për prindërit e tij:

“O Zot! Mëshiroji ata siç më rritën duke u përkuqdesur për mua kur isha i vogël!”

“O Zot! Më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët ditën kur do të jepet llogari!”

Fëmija duhet të japë sadaka për prindërit e tij pasi ata të ndërrojnë jetë. Sevapet e mirësive që bëhen për ta, do t’u shkojnë shpirttrave të tyre.

SHTËPIA E BESIMTARIT ËSHTË VATRA E ISLAMIT

— Nuredin Jëlldëz —

Numri i njerëzve që nuk kanë një vend pune dhe një dyqan është shumë më tepër se i atyre që kanë. Për të qenë njeri dhe për të jetuar njerëzisht, nuk është kusht as një vend pune, as një dyqan. Kjo është e vërtetë sot, ashtu siç ishte shekuj më parë. Nga ana tjetër, nuk ka njeri pa shtëpi dhe ai që ka është si një i mbijetuar nga fatkeqësia. Sepse njeriu nuk mund të jetë i pastrehë. Mund të mos ketë dyqan, por nuk mund të mos ketë shtëpi. Njeriu lind në shtëpi, rritet në shtëpi dhe gjen identitet në shtëpi. Njeriu dhe shtëpia janë si dy të pandashme. Kështu ka qenë dje, kështu është sot, kështu do të jetë edhe nesër.

Kur bashkohet shtëpia dhe njeriu, jeta merr kuptim. Mendohet se ai që ka shtëpi, ka edhe paqe. Supozohet se ai që ka shtëpi, ka edhe sofër. Kur bashkohen shtëpia dhe njerëzit, si rezultat mund të kuptohet qetësia, rehatia dhe ushqimi i njeriut. Kur shtëpia bashkohet me besimin dhe bëhet shtëpi besimtare, rriten edhe pritshmëritë nga shtëpia. Shtëpia në të cilën njerëzit besojnë në Allah është mjedisi më i përshtatshëm për realizimin e qëllimit të Allahut në krijimin e njeriut. Para xhamive që ndriçojnë qytetet, shtëpitë ndriçojnë zemrat. Njerëzit e lindur në shtëpi shkojnë në xhami dhe studiojnë nëpër medrese. Një njeri që bën dhikër në një shtëpizë dervishësh (teqe) është një që ka lindur dhe është sjellë në jetë nga nëna në shtëpi. Prandaj themi se shtëpia është baza. Andaj themi se jeta fillon në shtëpi, përhapet nga shtëpia dhe kthehet përsëri në shtëpi.

SHTËPI BESIMTARE

Shtëpia përmendet duke iu referuar kujtdo që i përket. Shtëpia nuk ka besim apo e kundërta, por banori i saj ka besim. Shtëpia në të cilën jeton besimtari është shtëpi besimtare. Pasi që shtëpitë dëshmojnë veprat e njerëzve brenda, shtëpitë që dëshmojnë besimin dhe veprat e mira janë shtëpi besimtare bi idhnil-lah (me lejen e Allahut). Në shtëpitë besimtare mbizotëron besimi. Nënata dhe baballarët aty rritin një brez besimtarësh, me lejen e Allahut. Në këtë konkluzion na shpie fakti që ne kemi vend faljeje në shtëpitë tona dhe që kemi themeluar dhe poseduar një shtëpi me logjikën e medresesë.

Shtëpitë tona janë streha jonë, medreseja jonë, xhamia jonë dhe burimi ynë i dashurisë. Ne e ndërtojmë këtë botë dhe botën tjetër në shtëpitë tona. Ruajtja e ndërtesës dhe e identitetit të saj është në pikën e shenjtërisë për ne. Privatësia e shtëpive tona është

privatësia jonë. Niveli i shtëpive tona është edhe niveli ynë.

Ata të cilët përpiqen për udhëzimin e të tjerëve është më e arsyeshme që të fillojnë nga shtëpitë e tyre. Situata e qiririt që nuk jep dritë në fund është e papranueshme. Të gjitha llojet e sadakasë duhet të jepen fillimisht në shtëpitë tona. Sepse shtëpia jonë është një zonë e mbrojtur ku mund të qëndrojmë sa më larg hipokrizisë. Shtëpia jonë është bërthama jonë. Mbrojtja e bërthamës është mbrojtja e rrapit. Ne mund ta ndërtojmë shtetin islam në shtëpi, që është pritshmëria jonë më e lartë si mysliman. Ndërtimi dhe mbrojtja e tij është edhe thelbësore, edhe më e lehtë.

Nëse në muret e shtëpive tona varim tabela që pasqyrojnë gjërat tona të shenjta, kjo nuk mjafton për t'i bërë shtëpitë tona besimtare. Kur fëmija shikon fytyrën e babait dhe nënës dhe kur ata e shikojnë fëmijën, është më e vlefshme dhe më efektive për ne të kemi një fytyrë që na kujton Allahun. Një dëshmi e sinqertë e familjes për njëri-tjetrin është më e vlefshme se dëshmia e njerëzve të tjerë. Ne jetojmë në një botë ku askush nuk mund të njohë askënd ashtu si njerëzit në shtëpi e njohin njëri-tjetrin. Vendi ku kalojmë pothuajse tërë jetën tonë, është një vend identifikimi si për njerëzit ashtu edhe për engjëjt. Në shtëpinë tonë shfaqet vetvetja jonë e vërtetë dhe karakteri jo i shtirur. Aftësia jonë për të bërë durim në shtëpi është një tregues i vërtetë. Shtëpia jonë është vendi ku edhe buzëqeshja, edhe fytyra jonë e tensionuar lexohen më qartë. Për këtë arsye, shtëpitë tona janë vendet më ideale ku jetojmë dhe pasqyrojnë besimin tonë. Meqë jemi besimtarë, elhamdulillah-lah, shtëpitë tona duhet të jenë vende ku reflektohet ky besim. Për këtë arsye, duam një shtëpi besimtare. Drejtësi, mëshirë, detyrë, përgjegjësi, sinqeritet, pastërti... Çfarëdo që pritet nga ne duhet të jetë në shtëpinë tonë dhe burimi i saj duhet të jetë shtëpia.

FËMIJA DHE SHTËPIA

Shkollat mund t'u japin fëmijëve tanë diploma, por prindërit janë ata që do t'ua japin atyre karakterin në shtëpi. Këtë mund ta shpjegojmë me një shembull shumë të thjeshtë: Cila furrë mund të pjekë bukë të klasit të parë nga një grurë i dorës së dytë? Është kaq e qartë dhe e thjeshtë se, fëmija i një vatre ku prindërit fillojnë duke thënë < bismil-lah' kur martohen dhe vazhdojnë kështu, është ndryshe nga fëmija i një vatre që nuk është kështu. Shtëpia besimtare është vendi ku rriten njerëzit që shkojnë në xhami. Meqenëse i mbushim xhamitë nga shtëpitë, do të thotë se nuk mund t'i mbushim xhamitë nga shtëpitë boshe.

Le të përcaktojmë edhe një herë pozicionin e shtëpive tona në këtë aspekt: A është shtëpia jonë vatrë që edukon njerëz për Islam apo jo? Këtë mund ta matim edhe me veten, edhe me fëmijët tanë.

Nëse shtëpia jonë nuk ka mundur të bëhet vatrë, qoftë edhe e vogël, që i edukon njerëzit për Islam, duhet të kthehemi një çast e më parë dhe ta marrim shtëpinë tonë në mbrojtje dhe mirëmbajtje me logjikën e < kështjellës së fundit'. Sepse shtëpitë tona janë një mirësi e madhe nga Allahu. Çfarë mirësie tjetër mund të kenë të drejtë të presin nga Allahu ata që nuk e kanë shfrytëzuar këtë mirësi? Sa e sinqertë do të ishte për ata që nuk mund t'i hapin shtëpitë e tyre për Zotin, të dëshirojnë që bota të hapej ndaj Islamit? Sa tingëlluese është një kërkesë e tillë?

PIKA MË E RËNDËSISHME: USHQIMI HALLALL

Përgjigja e parë për hulumtimin se nga duhet t'ia fillojmë është: Nga ushqimi dhe fitimi në mënyrë hallall i tij. Hallalli nuk mund të merret thjesht duke mos < vjedhur'. Edhe ta "meritosh" atë që e posedon është një kriter i hallallit aq sa të mos e vjedhësh. Shtëpia ku konsumohen gjërat, ngrëshmëria dhe përdorshmëria e të cilave janë marrë nga feja, është shtëpi hallall. Ne duam një shtëpi nën mbrojtje hallall, veçanërisht ushqimi.

Dhe një nga treguesit më të rëndësishëm të hallallit është distancimi nga shpërdorimi. Sepse shpërdoruesit janë vëllezërit e shejtanit. Si ta quajmë shtëpi besimtare shtëpinë në të cilën jeton shejtani?

VATRA MË REALISTE E EDUKIMIT

Shtëpitë janë vendet ku çdo gjë mund të mësohet më sinqerisht dhe në mënyrë të përhershme, nga pastërtia e deri te sjellja e mirë. Asnjë mësues nuk mund të mendojë për fëmijën aq sa një nënë, askush nuk mund të jetë aq i sinqertë sa ajo. Po, nëna mund të mos dijë matematikë, mund të mos e dijë texhvidin e Kur'anit aq sa mësuesi, por mund ta bëjë fëmijën e saj të përshtatshëm për të dalë para mësuesit në mënyrën më të mirë të mundshme. Një nënë është nënë dhe askush tjetër nuk bëhet më nënë në këtë botë.

Në cilën medrese mund të gjenden mirësitë e hallkës së mësimi Riyazu's-Salihin të një shtëpie?

Kur nuk mund të gjejmë një Jethrib për të emigruar, shtëpitë tona le të jenë vende ku kërkojmë strehim nga dyqanet, rrugët dhe madje edhe institucionet arsimore.

Meqenëse ne jetojmë në shtëpitë tona si qenie njerëzore, mund të ketë situata që kërkojnë dis-

kutim. Kjo nuk do të thotë që shtëpia jonë është shembur. Këtë e shohim të natyrshme. Le të kemi gjithmonë një udhërrëfyes, diturisë dhe drejtësisë së të cilit i besojmë. Le të shkojmë tek ai dhe ta ftojme atë, në mënyrë që ai të bëjë plane për ne. Të na tregojë gabimet tona. Kurse ne, le t'ia dëgjojmë fjalën atij.

Paraprakisht duhet të jemi të përgatitur, sepse sidomos edukimi i fëmijëve mund të sjellë probleme. Le të jemi gati të durojmë, edhe nëse duhen shekuj, dhe le të marrim këshilla nga dikush që di. Ne jemi një umet në gjendje të dobët tani për tani, por nuk jemi të pafuqishëm. Zoti na tregon shtëpitë tona si adresa. Shtëpitë janë adresa e paqes dhe dhembshurisë.

KUSHTETUTA E BESIMTARIT NË SHTËPI

1) Besimi është ai që e mban shtëpinë në këmbë. Besimi është themeli dhe çatia jonë. Lëre më diskutimin, por neve nuk na lejohet as t'i lëmë ata që debatojnë në shtëpinë tonë.

2) Veprat e mira me në krye namazin janë shenjat e besimit në shtëpinë tonë.

3) Shtëpia besimtare është një shtëpi ku engjëjt janë mysafirë. Gjithçka projektohet sipas atyre mysafirëve të bekuar, deri në erën nga e cila mund të shqetësohen engjëjt. Për këtë arsye, shfaqet kujdes për gjithçka, nga varja e një fotoje deri te të folurit e fjalëve të këqija. Secili anëtar i shtëpisë i nderon këta mysafirë, të cilët nuk mund t'i takojmë duke u dhënë dorën.

4) Të gjithë në shtëpinë besimtare janë të kënaqur me krijimin e Allahut (xh.xh.). Kushdo që është krijuar pranohet si i tillë. Askush nuk është për t'u pasur zili. Trupat, aftësitë dhe temperamentet pranohen siç janë krijuar. Pranimi i caktimit të Zotit është në kulmin e tij.

5) Ne e konsiderojmë veten si ruajtës të mallrave dhe mundësive në shtëpi. Nuk harrojmë se jetojmë në një botë ku gjithçka i përket Allahut. Ne jemi emanetqarë, andaj jemi besnikë ndaj amanetit.

6) Një nga veçoritë më të spikatura të një shtëpie besimtare është se ajo është një shtëpi ku praktikohet suneti i konsultimit. Është një shtëpi ku të gjithë flasin atë që ndjejnë brenda tyre dhe ku kryefamiljari i respekton të gjithë.

7) Nuk ka dallim mashkull/femër në shtëpinë besimtare. Në vend të këtij, ekziston vetëdija e të qenët rob i Allahut. Në këtë shtëpi padrejtësia konsiderohet si një nga haramet dhe shmanget, për shembull, siç shmanget alkooli. Vetëdija se fëmijët nuk e shtypin njëri-tjetrin as në lojërat e tyre është

vendosur në atë shtëpi që në fillimet e saj.

8) Mbajtja e marrëdhënieve me të afërmit është e domosdoshme për atë shtëpi. Edhe fqinjësia mbahet nën mbrojtje si domosdoshmëri e besimit.

9) Njerëzit në këtë shtëpi janë të ndjeshëm ndaj vjedhjes së kohës së tyre, ashtu siç janë të kujdeshëm ndaj vjedhjes së një sendi. Në çdo gjë, nga mikpritja te argëtimi, koha e tyre nuk është më pak e vlefshme se paratë e tyre.

10) Shtëpia besimtare është shtëpia e diturisë. Kurse marrja e dijes bëhet për qëllime adhurimi. Secili përpiqet të fitojë kënaqësinë e Allahut me atë që ka mësuar.

11) Konsumi në këtë shtëpi trajtohet në tri pika: Ato që janë të domosdoshme, ato që janë të nevojshme dhe ato që janë luksoze. Meqenëse konsumohet në këtë mënyrë, mbrohet nga shpërdorimi dhe imitimi i verbër.

12) Këto shtëpi në fund të fundit janë shtëpi, jo xhami. Nuk është një vend ku nuk mund të qëndrohet pa abdest dhe nuk mund të thuhet fjalë të kësaj bote, si xhamia. Vetëm harami nuk hyn në këtë shtëpi, por hyn argëtimi, hyn gëzimi, hyn çdo gjë që nuk është haram.

PA HUMBUR KOHË

Le t'i zhvendosim shtëpitë tona në kufijtë e besimit menjëherë, pa humbur kohë. Ngado që të fillojmë, do të jetë fitore për ne, me lejen e Allahut. Në vend që të ecim një jetë me gabimet e së shkuarës, duhet ta kalojmë pjesën tjetër të jetës me shpresën për të renë. Menjëherë duhet të merret vendim për shtëpitë ku secili i del për zot gjuhës së tij, ku secili e përdor dynjanë, por dynjaja nuk mund ta përdorë atë, ku puna dhe lutja kombinohen me njëra-tjetrën, ku të moshuarit respektohen dhe për të rinjtë ka dhembshuri, ku sekretet e tyre nuk zbulohen, ku jetohet për vete dhe jo për hir të të tjerëve, ku bekohen me mysafirë dhe ku ndalohet hyrja e gjërave të shëmtuara nga përgojimi te thashethemet. Duhet të vendoset një rend i ri duke kërkuar falje për të kaluarën.

Zotëri besimtar, zonjë besimtare... Shtëpia e këtyre është shtëpi shprese. Nuk ka nevojë ta kërkojmë larg shpresën tonë. Ne kemi vite të tëra që vazhdimisht e dëmtojmë atë shpresë.



RAMAZANI NË KARANTINË

— Ali Riza Temel —

Kur kujtojmë Ramazanët e fëmijërisë dhe rinisë sonë, themi: “Ku janë ata Ramazanët e vjetër?!” Kur u dënuam me karantinë totale vitin e kaluar për shkak të koronavirusit, na mori malli edhe për Ramazanët e kaluar.

Kur, për masë paraprake, u ndalua falja me xhemat në xhami dhe falja e xhumasë, festës sonë javore, e kuptuam se nga çfarë begatish të mëdha ishim privuar dhe për të cilat nuk kishim dijeni. Bashkë me ne u karantinuan edhe namazet, agjërimet, taravitë dhe iftaret. Sepse ibadetet jetojnë me ne dhe e shfaqin veten me ne. Kur jemi të privuar ne, privohen edhe ato. Aty ku nuk mund të hyjmë e të shkojmë ne, nuk mund të hyjnë e të shkojmë as ato.

Rrjedhimisht, vitin e kaluar, xhamitë, rrugët, sheshet dhe të gjitha vendet përveç shtëpive në përgjithësi u privuan nga gëzimi dhe entuziazmi i

Ramazanit. U shndërruam në jetimë të përlulur.

Bashkë me ne u

zhytën në zi edhe agjërimi, namazi, iftari, teravia dhe bajrami. Krahas gjithë pafundësisë saj, bota na dukej e ngushtë. Ndërsa bota nuk mund të na nxinte, u detyruam të futeshim ose të strehoheshim në shtëpinë tonë, midis katër mureve. Ata që shkolin në hapësirë, nuk mund të dilnin nga shtëpia. Ata që shkonin në Mars, nuk mund të shkonin në market.

Pse e përjetuam këtë fatkeqësi të përgjithshme që nuk e kemi përjetuar gjatë jetës sonë? Cilat janë shkaqet e kësaj fatkeqësie? A do të jetë “një fatkeqësi sa një mijë këshilla”? Çfarë do ta bëjë të gjithë njerëzimin për të fituar kjo fatkeqësi e tmerrshme, në të cilën mbetën të pafuqishëm dhe kërkuan një vrimë për të shpëtuar edhe ata që sfidojnë botën, ata që mendojnë se janë të gjithëfuqishëm dhe ata që bëhen faraonë e nemrudë?

Asnjë ngjarje nuk është pa një shkak. Përveç shkaqeve materiale, ka edhe shkaqe shpirtërore. Siç kanë veprat e mira rezultate pozitive, edhe mëkatet kanë pasoja negative. Natyrisht, rezultatet e



së mirës dhe së keqes nuk janë të njëjta. **“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t’i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa keq që gjykojnë ata!”** (Xhathije, 21) Nëse rezultati do të jetë i njëjtë për të gjithë, atëherë nuk ka kuptim të jesh i mirë dhe të bësh mirë. Për të mirët ka shpërblim, kurse për të këqijtë ka dënim, si në këtë botë ashtu edhe në botën e përtejme. “Xheneti nuk është i lirë, edhe ferri nuk është i panevojshëm.”

Disa telashe janë vetëm për sprovën. Meqenëse vështirësitë e profetëve dhe njerëzve të drejtë janë pritur me durim dhe mirënjohje, ato janë të dobishme në ngritjen e gradave dhe fshirjen e mëkateve. Jeta është sprovë nga fillimi deri në fund. E gjithë çështja është të fitosh këtë sprovë të nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.). Sepse identiteti dhe vlera e vërtetë e njerëzve zbulohet nga qëndrimi që ata mbajnë përballë ngjarjeve dhe ndodhive që shkaktojnë.

Disa telashe janë gjithashtu rezultat i mëkateve të bëra. Disa mëkate kanë një faturë të rëndë sa që tronditin gjithë botën. Sigurisht që prishet rendi individual dhe shoqëror. Njeriu ndotet, mjedisi bëhet i ndotur dhe toka e deti bëhen të pabanueshëm.

“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t’i bëjë “të shijojnë” pjesë (dënim) nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).” (Rum, 41) Siç mund të kuptohet nga ajeti, Zoti (xh.xh.), nuk e dënon çdo mëkat me masën e njëjtë të tij, por e dërgon dënimin si paralajmërim. Ai i paralajmëron ata në mënyrë që ta shohin seriozitetin e çështjes, të heqin dorë nga gabimet e tyre dhe t’i kthehen të vërtetës. Kjo tregon se sa i mëshirshëm është Ai.

“Sikur Allahu t’i dënonte njerëzit për shkak të mbrapshtive të tyre, nuk do të linte asgjë të gjallë në Tokë. Por Ai i lë ata deri në një afat të caktuar dhe, kur atyre u vjen afati, ata nuk mund ta shtyjnë atë e as ta shpejtojnë, qoftë edhe për një çast.” (Nahl, 61) Mëshira e Zotit tonë është më e madhe se zemërimi i Tij. Fakti që mirësitë nuk ndërpriten plotësisht përkundër të gjitha mëkateve dhe padrejtësive dhe fakti se ne jemi ende gjallë, është një shprehje se Ai nuk ka hequr dorë nga ne. Fakti që dera e pendimit është e hapur deri në frymën e fundit tregon se ndihmat hyjnore vazhdojnë. Në fakt, fatkeqësitë duhen parë si një paralajmërim dhe një shuplakë mëshire. Varja e një tapeti ose qilimi në litar dhe goditja e tij me shkop është për heqjen



e pluhurit dhe pastrim. Kështu duhen parë edhe fatkeqësitë. Pra, duhet të vlerësohen si trajtim kirurgjik për sëmundjen progresive. Njeriu është krijimi më i çmuar i Allahut Teala. Ai është mëkëmbësi i Tij në tokë. Ai e krijoi atë vetë, i fryu nga shpirti i Tij dhe e ofroi gjithçka në shërbim të tij. Ai nuk sakrifikon menjëherë një qenie që e vlerëson aq shumë për shkak të disa gabimeve të vogla. Ai i ka dërguar profetë dhe libra për ta udhëzuar, në mënyrë që të veprojnë në drejtimin e duhur. Ai e paralajmëron me fatkeqësi të tilla si uria dhe sëmundjet kur këshillat dhe paralajmërimet verbale nuk bëjnë dobi.

Ne e kemi në dorë që të mësojmë nga fatkeqësitë individuale dhe shoqërore që na ndodhin, të nxjerrim të mirën nga e keqja, të gjejmë zgjidhjen nga problemet dhe ta kthejmë të gabuarën në të drejtë. T’i konsiderosh fatkeqësitë e rënda si pengesë për fatkeqësitë më të rënda dhe ta dish se e keqja ka të keqe edhe më të madhe, e bën njeriun rezistent. Konsiderimi i ngjarjeve si të tilla, leximi i tyre në këtë mënyrë dhe të pajisurit me durim, kujdes dhe tevekkul, na mundëson të qëndrojmë drejt në këmbë dhe të mos rrëzohemi.

Ramazani që kaluam në karantinë, iftaret që i bëmë të ndarë prej miqve, xhumatë që nuk mundëm t’i falnim, vaktet që i falëm vetëm dhe namazet e taravive që i falëm në shtëpi, na dhanë mësim të



paharrueshme. E kuptuam se çfarë begatie është të kalosh së bashku Ramazanin, të bësh iftar bashkë, të falësh xhumanë dhe teravitë së bashku. Sa vende të bekuara që ishin xhamitë të cilat na mungonin, sa bukur ishte të bënim mukabele kolektive, hatme dhe lutje kolektive, iftare, vizita nëpër xhami...

Ne pothuajse përjetuam hakmarrjen për neglizhencën, përtacinë dhe indiferencën tonë. Shpresoj se këto do të jenë një mësim për ne. Shpresoj që ta rregullojmë veten, t'i vlerësojmë begatitë, të kuptojmë se nuk ka strehë dhe strehim tjetër përveç Allahut dhe të fillojmë një jetë të re dhe të pastër me një kontratë të re adhurimi.

Ne nuk mund të vazhdojmë me jetën e vjetër si e gjithë bota. Një botëkuptim pa qëllim, i pafuqishëm dhe i pakuptimtë për jetën, e kishte bërë gjithçka të pakuptimtë. Rregullat morale dhe njerëzore ishin shkelur në masën më të madhe. Mundësitë e dhëna nga Allahu (xh.xh.), përdorëshin në duart e shtypësve për të djegur, shkatërruar, hedhur bomba mbi të shtypurit dhe për t'i shfrytëzuar ata pamëshirshëm. Ndjenjat e miqësisë, vëllazërisë, fqinjësisë, ndarjes së gjërave me të tjerët dhe marrëdhëniet e mira me njerëzit ishin kthyer në armiçësi, egoizëm dhe lakmi, dhe bota ishte shndërruar në një pyll të egër në të cilin bridhnin çakejtë dhe hienat. Mjedisi ishte shumë i ndotur, natyra ishte plaçkitur dhe bota ishte

kthyer në botën e banditëve dhe hajdutëve.

Sigurisht, nuk ka jetë të shëndetshme në një botë të ndotur me mëkate. Në një mjedis ku bredhin mikrobet fizike dhe shpirtërore, është e pashmangshme që sëmundjet fizike dhe shpirtërore të përhapen dhe të ndodhin vdekje masive.

Siç janë kushtet vaksinat dhe ilaçet për sëmundjet fizike, ashtu janë kushtet edhe vaksinat dhe ilaçet shpirtërore për sëmundjet shpirtërore. Tani të gjithë janë bërë të vetëdijshëm për sëmundjen duke jetuar me dhimbjen. E rëndësishme është të mendosh thellë për shkaqet dhe trajtimin e saj, të mësosh nga ajo që ndodhi dhe të mos kthehesh në të njëjtat gabime.

Askush nuk e mendonte se fatura do të ishte e këtij niveli dhe e kësaj rëndësie. Për ata që nuk mësuuan nga paralajmërimet e vogla, do të thotë se duhej një mësim kaq i madh. Sa mirë është shprehur Zija Pashai: “Ata që nuk marrin vesh me këshillë, meritojnë shkopin.” Ata që nuk i durojnë fjalët e hidhura janë të dënuar të përjetojnë fatkeqësi të dhimbshme.

Tashmë ndodhi ajo që ndodhi. Nuk ka kuptim të qash, të rënkosh dhe të ankolesh. Ngado që të kthehemi prej dëmit, është dobi. Bota do të vijë në vete, veçanërisht myslimanët. Ata do ta zbatojnë seriozisht dhe sinqerisht Islamit, i cili është garancia e lumturisë në këtë botë e në ahiret dhe nuk do të shtiren në këtë çështje. Ata do ta dëgjojnë thirrjen e fundit të Zotit. **“O ju që kenë besuar! Dëgjojeni thirrjen e Allahut dhe të Dërguarit të Tij kur ata t’ju thërrasin për gjëra që do t’ju japin jetë.”** (Enfal, 24)

E gjithë çështja është nëse duhet të zbatohet apo jo kjo thirrje hyjnore. Në zbatimin e saj ka jetë, kurse në moszbatimin e saj ka vdekje. Siç ka thënë Shekspiri: “Të jesh apo të mos jesh?”, kjo është e gjithë çështja.

Nëse i kthehemi titullit të artikullit, mësimin më të madh na e dha Ramazani i këtij viti, i cili kaloi në karantinë. Aty pamë se askush përveç Allahut nuk i bën dobi askujt. U kthyem te vetja. Në vend të xhamive që nuk mund të shkonim, shtëpitë tona u bënë xhami. Itikafin që i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, e bëri vullnetarisht, ne e bëmë jo në dhjetë ditët e fundit, por gjatë gjithë Ramazanit. Lus Allahun që ndëshkimi të kthehet në mëshirë, festat e trishtuara të kthehen në festa të lumtura e të përjetshme pa frikë dhe trishtim. Siç ka thënë Jakubi (a.s.): “Dhimbjen dhe brengën tonë ia paraqesim Zotit.”

SHTËPIA E PARË NË TOKË DHE ITIKAFI

— Ahmet Hamdi Jëlldërëm —

Nëna e vendbanimeve në tokë (Ummu'l-Kura) është Mekketu'l-Mukerreme. Shtëpia e parë në botë është Qabeja, edhe xhamia e parë është bejtu'll-llah/ shtëpia e Allahut (Qabeja).¹ Kur Allahu Teala flet për xhamitë, i konsideron ato si shtëpi: “(Kjo dritë) është në disa shtëpi (xhami) që Allahu ka lejuar që të ngrihet dhe të përmendet emri i Tij në to. Aty (ka besimtarë që) e madhërojnë Atë në mëngjes dhe në mbrëmje.” (Nur, 36). Ky ajet fisnik gjithashtu tregon se shtëpitë ku përmendet emri i Allahut dhe madhërohet Ai në mëngjes dhe në mbrëmje janë si xhamitë.

Kudo që gjendet myslimani, këshillohet që të kthejë drejtimin e tij drejt kibles² dhe të gjejë një vend falje për vete. Për këtë arsye, ka pasur shumë nga sahabët tanë që një qoshe të shtëpive të tyre e kanë bërë xhami.³ Transmetohet se Profeti (a.s.), kishte gjithashtu një vend faljeje në shtëpitë e tij, megjithëse shtëpitë e tij ishin ngjitur me xhaminë.⁴ Transmetohet se Bilali (r.a.), e ka parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke ngrënë syfyf te vendi i faljes në shtëpinë e tij.⁵

Gjëja kryesore është të bësh ibadet. Xhamitë janë


1. Buhari, “Enbija”, 40; Muslim, “Mesaxhid”, 1-2.

2. “... (O ju që keni besuar! Tani) kudo që të jeni, kthejeni fytyrën nga ajo (Mesxhidu'l-Haram/Qabeja)...” (Bekare, 144).

3. Për transmetimet në lidhje me këtë temë, mund t'i referoheni “kreat të xhamive në shtëpi” të Imam Buhariut: Shihabuddin Ahmed ibn Ali ibn Muhamed ibn Haxher el-Askalani, Fet'hu'l-bari bi-sherhi Sahihi'l-Buhari; korrektoi Muhammed Fuad Abdulbaki, Muhibbuddin el-Hatib, Bejrut: Daru'l-Ma'rifë, 1/519.

4. Zejnuddin Abdurrahman ibn Ahmed ibn Rexheb, Fet'hu'l-bari she - hu Sahihi'l-Buhari; korrektoi Mexhdi ibn Abdulhalik Shafii... Medine: Mektebetu'l-Gurabai'l-Eserijje, 1996/1417. 2/193.

5. Vepra e Lartpërmendur, 3/169.



shtëpitë e Allahut. Natyrisht, forma më e pranueshme e adhurimit është kryerja e tij në mënyrë kolektive në shtëpinë e Allahut. Mirëpo, në rastet kur xhamitë dhe xhemati nuk mund të frekuentohen për ndonjë arsye, shtëpitë tona bëhen vend lutjesh.

Prandaj, ata që nuk mund të shkojnë në xhami, mund ta bëjnë një cep të shtëpisë së tyre si vend faljeje. Në fakt, rekomandohet që një cep i shtëpisë të bëhet vend faljeje.⁶

Vend për falje në shtëpi do të thotë të ndash një nga dhomat e shtëpisë ose një qoshe të dhomës si vend faljeje. Aty preokupohemi me namaz, dhikër dhe këndim të Kuranit. Edhe pse ky kënd, i cili tashmë është ndarë si vend falje, quhet xhami, xhamitë e shtëpive nuk kanë një status të veçantë.

Xhamitë e shtëpive nuk u nënshtrohen dispozitave të xhamive të vakëfeve/lagejeve. Sepse kur një vend ndahet si xhami në përgjithësi, ai bëhet vakëf dhe nuk është më në pronësi të njerëzve. Në fakt, në ajetin fisnik thuhet: “**Me të vërtetë, xhamitë janë të Allahut.**” (Xhin, 18) Kurse blerja dhe shitja e

6. Muhammed Emin ibn Omer ibn Abdalaziz ed-Dimashki ibn Abidin, Reddu'l-muhtar ale'd-Durri'l-muhtar: sherhi Tenviri'l-ebzar\ Hashijetu ibn Abidin, Bejrut: Daru'l-Fikr, 1412, 2/441.

shtëpive, një cep i të cilave përdoret si vend për falje, është e lejuar.

Një nga detyrat më të rëndësishme të xhamive tona është të jenë vend për itikaf, veçanërisht në muajin e Ramazanit. Që nga koha kur agjërimi u bë i detyrueshëm e deri në fund të jetës së tij, Profeti (a.s.), praktikoi itikafin në dhjetë ditët e fundit të çdo muaji të Ramazanit.⁷ Itikafi është një sunet kifai, domethënë, është sunet që në çdo xhami së paku një person duhet të bëjë itikaf. Nëse dikush nga çdo xhema xhamie e përmbush këtë sunet, kjo detyrë bie nga të tjerët.

Itikaf do të thotë të mbyllësh veten në një vend me qëllim për të bërë adhurim. Me shprehjen "... në itikaf në xhami..." që përmendet në ajet, vendet e tjera nuk konsiderohen më vende itikafi pasi xhamitë janë specifikuar për adhurim.

Edhe pse sipas pikëpamjes së përgjithshme, vendi i itikafit është xhamia, një nga juristët e shquar maliki, Muhamed ibn Omer ibn Lubabe (v. 314) është shprehur se mund të hyhet në itikaf edhe në vende të tjera përveç xhamisë. Sipas një shprehjeje të medhhebit Shafi, vendi i itikafit mund të jenë xhamitë e shtëpisë (vendet e faljes në shtëpi), nuk është kusht të jetë një xhami e lagjes. Sipas një mendimi tjetër të Shafive dhe Malikive: Meqenëse është më e virtytshme të falen namazet jo të detyrueshme në shtëpi, xhamitë e shtëpisë mund të jenë vend itikafi si për burrat ashtu edhe për gratë.⁸ Edhe hanefitë duke e krahasuar itikafin me namazin, kanë gjykuar gjithashtu se itikafi për gratë është më i saktë në xhaminë e shtëpisë.⁹

Sipas pikëpamjes kryesore të të gjitha medhhebeve, vendi i itikafit për burrat janë xhamitë. Për meshkujt nuk ka mundësi itikafi jashtë xhamisë në kohë normale.

Çfarë do të bëjmë në kushte të jashtëzakonshme si sot, kur jemi të privuar nga xhamitë? A do të ndjekim mendimin e shumicës që thotë se itikafi i burrave nuk vlen veçse në xhami dhe ta neglizhojmë këtë sunet? Apo do ta praktikojmë në vendfajlet në shtëpitë tona?

Natyrisht, një burrë që bën një xhami (vendfalje) në shtëpinë e tij për të mos prishur rehatinë e tij, nuk mund të përfitojë asnjë shpërblim nga itikafi që bën aty. Mirëpo, nëse ai nuk mund të shkojë në xhami për shkak të ndonjë arsytimi, do të marrë

7. Shik. Buhari, "I'tikaf", 1-18; "Edhan", 12, 135; "Hajz", 10; Muslim, "I'tikaf", 1-6; Ebu Davud, "Ramazan", 3; "Savm", 77.

8. Ibn Haxher el-Askalani, vepra e lartpërmendur, 4/235 dhe të tjerët.

9. Ibn Abidin, vepra e lartpërmendur, 2/441.

shpërblim si për namazin që e fal me xhema në xhaminë e shtëpisë së tij, ashtu edhe për itikafin. Në fakt, ky itikaf për burrat nuk konsiderohet si itikafi në xhami. Por do të jetë i dobishëm në fitimin e shpërblimeve të itikafit.¹⁰ Për më tepër, arsyeja që dijetarët thonë se itikafi i burrave vlen vetëm në xhami është se namazi me xhema falet në xhami.¹¹ Duke qenë se sot nuk është e mundur falja e namazit me xhema në xhami, ka rënë edhe urtësia e përdorimit të xhamive për itikaf.

Përkatësisht itikafi më i virtytshëm kryhet në Mesxhidu'l-Haram (Qabe), Mesxhidu'n-Nebi (Xhamia e Pejgamberit) dhe Mesxhidu'l-Aksa (Xhamia Aksa). Më pas janë xhamitë e xhumasë, ku falen pesë namazet e ditës dhe në fund xhamitë e lagjes. Në këto të fundit, xhamia me xhematin më të madh konsiderohet më e virtytshme.¹²

Itikafi ofron mundësinë për të arritur manifestimin e shfaqjeve hyjnore në kohë dhe hapësirë. Nisur nga ky aspekt, besimtari në itikaf i drejtohet botës së tij të brendshme.

Ai fillon të kërkojë qenien një-rëzore të përsosur në zemrën e tij që është vendi ku shikon Zoti. Ai lirohet nga preokupimet e kësaj bote dhe i lë mënjanë përkohësisht punët për sigurimin e jetesës. Ai i kthehet plotësisht Zotit të tij duke u shkëputur nga krijesat. Zemra e tij, e cila tashmë ka fituar butësi nëpërmjet agjërimit, është bërë e përshtatshme për pranimin e sekreteve hyjnore. Tashmë është bërë e mundur të ngulitet urtësia e agjërimit në të.

Tashmë janë hapur dyert e horizontit të arritjes së të vërtetës së adhurimit përmes namazit, dhikrit, këndimit të Kuranit dhe meditimit. Për këtë arsye, është e nevojshme të largohemi nga njerëzit dhe të vetmohemi. Atmosfera më e përshtatshme që njeriu të largohet nga të tjerët dhe t'i kthehet vetes është në itikaf. Kjo nuk është vetmi, por është vetë-zbulim.

Nevoja e myslimanit për itikaf është shumë e madhe. Itikafi nuk është vetëm mbyllja e trupit në një xhami. Po, kjo është ndoshta e nevojshme si një

10. Shik. Ibn Rexheb, vepra e lartpërmendur, 3/172.

11. Shik. Ebu'l-Hasan Alaeddin Ali ibn Sulejman ibn Ahmed Merdavi, el-Insaf fi ma'rifeti'r-raxhilih mine'l-hilaf; korrektoi Muhammed Hamid el-Fiki, Bejrut: Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabi, 1958/1377, 3/364.

12. Ibn Abidin, vepra e lartpërmendur, 2/441.



kusht i jashtëm. Mirëpo, ajo që nënkuptohet me itikaf është itikafi i zemrës, e cila është vendi ku sheh Zoti (xh.xh.).

Është e nevojshme t'u kushtojmë vëmendje pikave të mëposhtme për ta kryer itikafin me zemër, jo me trup, për të shijuar ibadetin, për të kryer bindjen siç duhet, për të gjetur paqen shpirti dhe për të ndjerë kuptimin e nënshtimit ndaj Zotit në këtë adhurim:

1) Le t'i përgatisim xhamitë tona në shtëpitë tona sa më shpejt të jetë e mundur me ndjeshmërinë e xhamisë së parë të botës në Mekë/shtëpinë e Allahut. Ashtu si Ademi (a.s.) dhe Ibrahim (a.s.), e ndërtuan Qabenë, shtëpinë e Allahut, le ta bëjmë një cep të shtëpisë sonë të duket ndryshe nga qoshet e tjera të shtëpisë me sixhadenë, rahlenë dhe tesbihet.

2) Të fillojmë faljen me xhemat dhe leximin e Kuranit Fisnik sa më shpejt në xhamitë e shtëpive tona. Le të mbjellim te bashkëshortet dhe fëmijët tanë vetëdijen se ky vend është xhami. Le të ndihemi këtu sikur jemi në një xhami.

3) Urtësia dhe qëllimi i itikafit është shkëputja nga njerëzit dhe lidhja me Krijuesin (xh.xh.). Njerëzit që hyjnë në itikaf duhet të përqendrohen në adhurime dhe të lodhen. Ata duhet ta pastrojnë zemrën e tyre nga çdo gjë e kësaj bote, ta lidhin atë me Allahun dhe t'i kthehen plotësisht Zotit. Ata duhet ta shfaqin dobësinë e tyre dhe të këmbëngulin për të fituar kënaqësinë dhe faljen e Zotit (xh.xh.).

Ata ibn Ebi Rebahu (v. 114), i cili ishte prej dijetarëve të mëdhenj të fikhut, hadithit dhe tefsirit të periudhës së tabiinëve, transmetohet të ketë thënë për itikafin: "Njeriu që hyn në itikaf është si ai që ulet në derën e një njeriu të madh për shkak të nevojës së tij dhe i lutet duke i thënë se "nuk do të largohet derisa të marrë atë që ka nevojë". Andaj ai ka hyrë në një faltore të Allahut dhe thotë: "Unë nuk do të largohem nga këtu pa më falur Zoti."¹³

Itikafi është vendi i lutjeve dhe përgjërimeve ndaj Zotit (xh.xh.). Ai nuk është një vend për t'u ulur e për të biseduar me njerëz, për të dhënë mësim dhe për të treguar veten. Aty duhet t'i kërkohet strehim Allahut të Madhëruar me plot modesti.

4) Itikafi është atmosfera e të jetuarit me Kuranin Fisnik. Zemra e besimtarit gjallërohet duke e lexuar Kuranin me përsiatje. Një rob që ka arritur kënaqësinë e leximit të Kuranit me përsiatje përjeton kënaqësinë e bisedës me Zotin e tij. Ai zhytet në

horizontet e gjera të ajeteve hyjnore që depërtojnë në thellësi të zemrës së tij. Muaji i Ramazanit, me shprehjen e tij më të dukshme, është muaji i Kuranit Fisnik. Zemra, e cila ka fituar butësi materiale dhe shpirtërore në atmosferën e Ramazanit, fiton një vitalitet tjetër dhe fillon të marrë një shije hyjnore që gjuha nuk do të jetë në gjendje ta përshkruajë dhe stilolapsat ta shkruajnë. Kjo është madhështia e fjalës hyjnore...

Jo çdo person që lexon Kuranin Fisnik mund të zhytet në oqeanin e kuptimeve sublime. Sa herë që një njeri, i cili e arrin këtë thellësi, merr Kuranin Fisnik në dorë dhe fillon të lexojë ajetet, shqetësohet duke menduar: "Çfarë më thotë Zoti mua? Çfarë kërkon nga unë?" Ai nuk duhet të shqetësohet se kur do të mbarojë hatmja. Sepse qëllimi i leximit të Kuranit Fisnik është për të kuptuar fjalën e Zotit të botëve, për të përmbushur urdhrat e Tij, për të shmangur ndalesat e Tij dhe për të marrë një mësim. Leximi i Kuranit Fisnik është një adhurim dhe adhurimi nuk mund të bëhet me shkujdesje.¹⁴

Leximi i Kuranit shpreh një vlerë nëse bëhet për ta zbatuar dhe për t'u mundësuar të tjerëve ta zbatojnë. Një nga shembujt më të mrekullueshëm të kësaj është që Omeri, radijall-llahu anh, e përfundoi suren (kaptinën) Bekare për dymbëdhjetë vjet dhe bëri kurban një deve në shenjë mirënjohjeje ndaj Zotit (xh.xh.).

Shkurtimisht, dinjiteti dhe nderi i vërtetë i një njeriu është në përpjesëtim me faktin se sa ai është kompetent me rregullat e Kuranit dhe i përsosur me moralin e tij.¹⁵

5) Qëllimi dhe synimi i itikafit është që zemra të fitojë drejtimin fetar. Zemra duhet t'i kthehet plotësisht Zotit të saj, në mënyrë që të jetë e udhëzuar drejt në siratu'l-mustekim. Nëse njeriu është i shkujdesur ndaj Allahut dhe preokupohet me gjëra të tjera, kuptimi i itikafit humbet edhe nëse ka itikaf fizik. Për këtë arsye, njeriu duhet ta mbledhë veten dhe të lidhet me Allahun Teala, në mënyrë që zemra të rregullohet dhe t'i drejtohet Zotit (xh.xh.). Në itikaf, veprimet si ngrënia, pirja, të folurit dhe gjumi duhet të minimizohen. Sepse punë të tilla, që janë investime fizike për njeriun, e dobësojnë aspektin shpirtëror i cili është baza në këtë çështje. Në këtë kontekst, agjërimin duhet të përpiqemi ta mbajmë si sahabët dhe duke ngrënë iftar e syfyri si ata.

14. Ebu Bekr Muhammed b. Husejin b. Abdullah el-Bagdadi Axh - rri, Ahlaku hameleti'l-Kur'an; korrektioi Fevvez Ahmed Zemerli. Bejrut: Daru'l-Kitabi'l-Arabi, 1987/1407. fq. 18.

15. Për informacion më të detajuar në lidhje me këtë çështje shih. Osman Nuri Topbash, Faziletler Medeniyeti - Qytetërimi i Viryteve, Stamboll: Botimet Erkam, 1432-2011, 1/156 dhe të tjerë.

13. Shik. Ebu'l-Ihlas Hasan b. Ammar b. Ali el-Vefai Shyrynbylali, Nuru'l-izah; Korrektioi Said Bekdag, 2. Bejrut: Daru'l-Beshairi'l-Islamijje; Medine: Daru's-Siraxh, 2015/1436. fq. 299.

6) Nuk duhet të harrojmë se Zoti (xh.xh.), është gjithmonë me ne. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ai i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulen në sexhde.”** (Shuara, 218-219). Zoti na sheh në çdo situatë, por gjithashtu dëshiron të na shohë duke e adhuruar Atë si pjesë e një tërësie në xhemat, me qëndrim në këmbë, përkulje në ruku dhe sexhde në namaz. Atëherë është e nevojshme të jemi të vetëdijshëm se jemi në audiencën e Zotit (xh.sh.), veçanërisht përgjatë namazit. Kur robi e kupton se Zoti është gjithmonë me të dhe përfshihet në këtë bashkim, ndryshku në zemër zhduket gradualisht dhe elementet e dëmshme të botës zhduken një nga një. Robi kthehet plotësisht drejt fitimit të pëlqimit të Zotit, fiton sinqeritet dhe nuk kërkon asgjë tjetër përveç shpërblimit të botës së përtejme.

7) Edhe pse jemi në një qoshe të shtëpisë sonë, tani jemi në një xhami. Domethënë, jemi mysafirë në shtëpinë e Allahut (xh.xh.). Andaj nuk duhet harruar se jemi mysafirë. Ne duhet të gjendemi të përlulur dhe nevojtarë në praninë e Zotit të Plotfuqishëm, i Cili është poseduesi i gjithçkaje. Nënshtrim ndaj Zotit do të thotë përlulje dhe dorëzim. Më të pranueshëm nga robërit janë ata që nënshtrohen, dorëzohen dhe binden më së shumti në praninë e Zotit të tyre. Ndërsa robi përulet në praninë e Krijuesit, ai afrohet më shumë me Zotin dhe arrin mëshirën, ndihmën dhe mirësinë e Tij. Zoti (xh.sh.), merr përsipër gjithë punën e atij që i dorëzohet Zotit. Andaj robi duhet të jetë i vetëdijshëm se ne duhet të strehohemi në shtëpinë e Allahut në itikaf dhe të kërkojmë mëshirë në derën e tij.

8) Robi duhet të jetë mirënjohës ngaqë është pranuar si mysafir në shtëpinë e Allahut Teala. Ai nuk duhet t'i shohë mirësitë sikur i ka nga vetja, por duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin se ai mund të hyjë në audiencën e Zotit plotësisht si një mirësi nga Ai: **“...Po të mos ishte mirësia dhe mëshira e Allahut ndaj jush, askush prej jush nuk do të mund të pastrohej përgjithmonë. Por Allahu e pastron kë të dojë. Sepse Allahu është Semi’** (dëgjues), **Alim** (i Cili di gjithçka).” (Nur, 21)

Robi duhet t'i dijë dhe t'i rrëfejë mëkatet e gabimet e tij dhe gjithmonë duhet të kërkojë falje nga Zoti i Madhëruar. Nuk duhet harruar se shumë profetë të mëdhenj ishin gjithmonë në gjendje pendimi dhe kërkim faljeje. Paraardhësi i njerëzimit, profeti i parë Hz. Ademi dhe bashkëshortja e tij, Havaja, alejhima's-selam, u penduan dhe kërkuan falje siç vijon: **“Ata u lutën menjëherë: “Zoti ynë! Ne i kemi bërë padrejtësi vetes. Nëse nuk na fal dhe nuk na mëshiron, me siguri do të jemi prej të humburve**

të përjetshëm.” (A'raf, 23)

Përgjatë adhurimit të itikafit robi duhet të jetë gjithmonë në gjendje dhikri dhe lutjeje. Sa lumturi e madhe është që robi të përkujtojë emrin e Zotit të tij, të flasë për Të dhe ta kujtojë Atë! Për më tepër, Zoti (xh.xh.), thotë: **“Atëherë më kujtoni mua dhe Unë do t'ju kujtoj ju.”** (Bekare, 152). Natyrisht, përkujtimi i robit nga Zoti është më i larti, më i përsosuri, më i lartësuar. Në ajetin fisnik thuhet: **“Përkujtimi i Allahut është më i madhi.”** (Ankebut, 45)

Në një ajet tjetër, thuhet: **“Thuaj: Pse Zoti t'ju vlerësojë nëse nuk do të ishte lutja juaj?”** (Furkan, 77) Sipas këtij ajeti, vlera e një robi te Zoti i tij është sa lutja e tij. Qëndrimi larg lutjes tregon largësinë e robit nga Zoti. Në fakt, baza e të gjitha mëkateve dhe rebelimeve është privimi nga marifetullahu, domethënë, është dobësia në njohjen e duhur të Allahut të Madhëruar.

Hadithet rreth lutjes më poshtë janë si thesare për ne. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka thënë:

“Lutja është adhurim. Ajo është palca dhe thelbi i adhurimit.” (Tirmidhi, “Da'avat”, 1.)

“Kujt i janë hapur dyert e lutjes, atij i janë hapur dyert e mëshirës. Ajo që Allahu e do më shumë është t'i kërkohet falje. Lutja është e dobishme kundër çdo fatkeqësie që ka ardhur dhe nuk ka ardhur ende. Është vetëm lutja ajo që mund ta ndryshojë caktimin. Atëherë, përmbajuni lutjes.” (Tirmidhi, “Da'avat”, 112.)

Robi duhet të strehohet te Zoti nga të gjitha llojet e të këqijave materiale dhe shpirtërore dhe duhet të lutet si për veten ashtu edhe për gjithë umetin e Muhamedit (a.s.).

Robi, i cili ka arritur mirësinë për ta plotësuar itikafin e tij me këto ndjenja, e arrin festën e Bajramit me fytyrë të bardhë. Me këtë itikaf shpirtëror, ai konsiderohet se ka përparuar në rrugën për të pasur një zemër të delirë. Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë se festa më e madhe është gjallërimi i një suneti të Pejgamberit tonë të Nderuar.

Allahu u dhëntë zemrave tona pjesë nga zemrat e robërve të Tij të devotshëm, të cilët kanë mundur t'i kthejnë zemrat e tyre në një vend ku shfaqen sekretet dhe urtësitë hyjnore.

Na e mundësoftë t'i pastrojmë zemrat tona dhe të dalim në audiencën e Tij me një zemër të pastër atë ditë kur pasuria dhe fëmijët nuk bëjnë dobi! Vendostë në zemrat tona dashurinë për veprat e mira që do të na afrojnë me këtë të vërtetë!

Amin!..

GJATË PERIUDHAVE TË SËMUNDJES

— M. Sami Ramazanollu —

Të kërkosh shërimin hyjnor

Sipas transmetimit nga Ebu Hurejra (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Allahu i Madhëruar nuk ka dhënë asnjë sëmundje që nuk i ka zbritur shërimin.”* (Buhari). Dhe përsëri, Imam Ahmedi transmeton nga Enesi (r.a.): *“Vërtet, Allahu i Lartësuar e ka krijuar edhe shërimin në atë vend ku ka dhënë sëmundjen.”* (Ebu Davud) Andaj është urdhëruar: *“Atëherë, mjekohuni!”* Me fjalë të tjera, do të thotë kërkoni dhe gjeni ilaçe.

Nga Xhabiri (r.a.), është transmetuar: *“Për çdo sëmundje ka një shërim. Nëse sëmundja kurohet me ndonjë ilaç, Allahu i shëron njerëzit nga ajo sëmundje.”* (Muslim) Ardhja dhe ikja (shërimi) e çdo sëmundjeje në fakt është me urdhër të Allahut Teala. Veprimi i lidhjes vetëm ndaj shkakut nuk është i përshtatshëm me tevekkulin (mbështetjen ndaj Zotit). Siç nuk është e drejtë të kapemi vetëm pas shkaqeve për të shuar urinë dhe etjen.

E pyetën Harith el-Muhasibun: *“O Harith, a përdorin ilaçe njerëzit që mbështeten te Zoti?”*

“Po.”, tha ai. Atij i thanë: *“Cili është argumenti yt për këtë?”* Ai iu përgjigj: *“I Dërguari i Allahut, Muhamed Mustafai (a.s.), që askush nuk ka gjasa ta arrijë atë në tevekkul, ai e përdori ilaçin derisa ishte në këtë gjendje (i sëmurë). Ky është argumenti.”*

Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, tregon se Ibrahim, alejhi's-selam, i tha Zotit:

“O Zot! Nga kush vjen sëmundja?” Zoti i Plotfuqishëm i tha:

“Vjen nga unë.” Ibrahim, alejhi's-selam, e pyeti:

“Po shërimi nga kush vjen?” Allahu i Lartësuar i tha:

“Vjen nga Unë.” Ibrahim, alejhi's-selam, i tha:

“Sëmundja vjen nga Ti. Edhe ilaçi vjen nga Ti. Atëherë, cila është puna e mjekut në mes?” Allahu Teala i tha: *“Mjeku është personi që, nëse ia dërgoj shërimin atij, shërimi vjen.”*

Profeti (a.s.), përdorte tri lloje ilaçesh: Lloji i parë ishin ilaçet hyjnore, lloji i dytë ishin ilaçet e mje-



kësisë. Kurse lloji tjetër (lloji i tretë) përbëhej nga dy të parët.

Siç dihet, Allahu i Madhëruar nuk ka zbritur një ilaç më të dobishëm se Kurani në eliminimin e sëmundjes.

Kurani Fisnik është shërim për të sëmurët dhe dëlirje për zemrën. Kështu, Allahu i Madhëruar thotë: ***“Ne po e zbresim atë gradualisht nga Kurani, i cili është shërim dhe mëshirë për besimtarët.”*** (Isra, 82)

Sipas imam Fahu'r-Razit, Kurani është shërim në mënyrë absolute për sëmundjet shpirtërore dhe fizike.

Sëmundjet shpirtërore janë dy pjesë: Disa prej tyre janë besime supersticioze që kanë të bëjnë me uluhjetin, profecinë, këtë botë, botën tjetër, kadanë dhe kaderin. Kurani Fisnik përmban argumentet e rrugës së vërtetë të Zotit (xh.xh.). Ai i ka anuluar një numër besimesh supersticioze dhe sektesh të rreme. Një njeri që i njuh dispozitat e Kuranit është i sigurt nga këto besime supersticioze.

Disa nga sëmundjet shpirtërore përbëhen nga moral i ulët. Kurani Fisnik i ka shpallur përshkrimet dhe detajet e moralit të ulët, të këqijat dhe ligësitë e tij dhe ka inkurajuar moralin e lartë.

Shkurtimisht, Kurani Fisnik është shërim për të dyja pjesët e sëmundjeve shpirtërore.

Po kështu, nëse Kurani Fisnik lexohet me nijetin e teberrukut (begatisë) për eliminimin e sëmundjeve fizike, me lejen e Allahut është shërim për shumë sëmundje.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Allahu nuk e shëroi atë që nuk kërkoi shërim me Kuranin Fisnik.”* Ose, ka të ngjarë të nënkuptojë siç vijon: *“Domethënë, ai që nuk kërkon shërim me të, Allahu i Madhëruar mos e shëroftë!”*

“Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli, i kujtojnë (urdhrat e Tij), e atëherë e shohin rrugën e drejtë. Ndërsa vëllezërit e vet (prej njerëzve), ata i shpien edhe më tej në humbje pa pushuar.”

(A'raf, 201-202)



VENDOSMËRIA NË FE

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik thotë: **“Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo është humbja e qartë.”** (Haxh, 11)

Disa prej njerëzve që e kanë zakon ta harrojnë dhe ta kundërshtojnë Krijuesin dhe Furnizuesin e vërtetë, Allahun Teala, e adhurojnë Atë duke dyshuar. Si rezultat, nuk kanë vendosmëri në adhurimet që kryejnë kundrejt Zotit (xh.xh.). Ata nuk e përvetësojnë Islamin me gjithë zemër dhe sinqeritet, në mënyrë që ta kenë të lehtë të kthehen në anën tjetër kur të mos u leverdisë apo kur t’u shkaktohet ndonjë dëm në këtë botë. Për këtë arsye, shkojnë rreth e rrotull saj, por nuk hyjnë në të. Ja, njerëzve të tillë u qetësohet zemra kur kanë ndonjë interes apo kur Zoti u dhuron ndonjë mirësi dhe këtë e konsiderojnë të ardhur nga feja. Por nëse i gjen ndonjë fatkeqësi, menjëherë largohen nga feja, e lënë atë dhe kthehen në anën që e mohon Zotin (xh.sh.).

Sipas mendimit të Fahri Razit, Kadiut dhe Hazinit, ky ajet fisnik ka zbritur në lidhje me një grup që po bënte hixhret për në Medine. Kur disave prej tyre u lindën gratë fëmijë, pelat u pollën mëza dhe iu shtua pasuria, e konsideruan këtë si mirësi të fesë islame, iu qetësuan zemrat dhe qëndruan të vendosur në fenë islame në Medine të kënaqur. Sikundër kësaj, atyre që gratë nuk u lindën fëmijë, pelat nuk u pollën, u sëmurën dhe përjetuan vështirësi në sigurimin e jetesës, e komentuan këtë sikur të ishte një e keqe që u vinte nga feja islame dhe thanë: “Punët nuk na kanë ecur mirë që kur jemi bërë myslimanë.” Për këtë arsye, e lanë fenë islame dhe

u kthyen përsëri në mohim të Zotit (xh.sh.).

Shkaku që Allahu Teala i ka dhënë leje shejtanit për fitne, vesvese dhe përçarje shprehet në këtë ajet fisnik në të cilin thuhet: **“Kjo ndodh që Ai ta bëjë ndërhyrjen e djallit sprovë për njerëzit që i kanë zemrat të sëmura (nga dyshimi) dhe të ngurtësuar - prandaj keqbërësit janë në përçarje të madhe - dhe që ata, të cilëve u është dhënë dituria, ta kuptojnë se ai (Kurani) është e Vërteta nga Zoti yt, ta besojnë atë dhe zemrat e tyre të binden e të qetësohen me të. Nuk ka dyshim se Allahu i udhëzon në rrugën e drejtë ata që besojnë.”** (Haxh, 53-54)

“(O i Dashuri Im!) Nëse djalli përpiket të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (A'raf, 200)

Domethënë se djalli i mallkuar pret mundësinë për ta shtyrë njeriun drejt së keqes. Andaj, nëse fillon ndonjë vesvese apo cytje përgjatë zemërimit, njeriu duhet t’i përgjërohet menjëherë Allahut të Madhëruar që ta marrë nën mbrojtjen hyjnore, në mënyrë që të ruhet nga e keqja e shejtanit.

Puna e shejtanit, sipas Fahri Razit, Fet’hu’l-Bejan dhe Hazinit, është futja e vesveseve te njeriu, cytja e tij, inkurajimi për të bërë vepra të këqija, preokupimi i mendjes së njeriut dhe hedhja e tij në sa më shumë dyshime.

Allahu Teala thotë:

“Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli, i kujtojnë (urdhrat e Tij), e atëherë e shohin rrugën e drejtë. Ndërsa vëllezërit e vet (prej njerëzve), ata i shpien edhe më tej në humbje pa pushuar.” (A'raf, 201-202)



GARA PËR NË XHENET

— Ali Riza Temel —

Parë nga një këndvështrim, jeta është një garë. Në përgjithësi, gara bëhet në vepra të mira ose në të këqija. Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë: **Thuaj: “Çdokush sillet sipas mënyrës së vet, por Zoti juaj e di më së miri se kush është në rrugën më të drejtë.”** (Isra, 84.)

Ka prej atyre që e shikojnë të shëmtuarën të bukur dhe të bukurën të shëmtuar. Ata që garojnë në të këqija dhe në të mira, pandehin se po bëjnë punë të mira dhe të bukura. Për këtë arsye, caktimi i së mirës, së keqes, së bukurës dhe së shëmtuarës, nuk mund t’i lihet vetëm dëshirës dhe mendjes së njeriut. Dëshira dhe mendja e shëndoshë mund të formohen vetëm nën edukimin e shpalljes hyjnore.

Edhe pse virtyti më i bukur i femrës është turpi, ata të cilët e zhveshin atë nga kjo bukuri dhe e ulin deri në bukurinë fizike, nuk po garojnë në diçka të bukur, por në diçka të shëmtuar. Bukuria e përhershme nuk është në trup, por në shpirt. Siç ka thënë edhe Mevlana, parfumin duhet t’ia hedhim shpirtit dhe jo trupit. Sidoqoftë, trupi në fund do të kalbet dhe do të bëhet dhe. Asgjë nuk ka ngelur prej trupave të atyre që janë zgjedhur të bukurat e vendit apo të botës. Atëherë, ne duhet të garojmë për të stolisur gjërat e përhershme. Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë:

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt ...” (Kehf, 46.)

Lojërat dhe sporti në përgjithësi janë objekt i garës. Në fund të këtyre lojërave, fitohen shpërblime simbolike ose shpërblime që kanë vlerë materiale.

Shpërblimi i garës lidhet me vështirësinë e saj. Shpeshherë, këto gara janë gara për jetë a vdekje.

Garat që bëhen për një çështje dhe shpërblim të vlefshëm, janë garat që bëhen në dije, kulturë, në fushën e mirësisë dhe atë të shërbimit (hyzmetit), prej të cilave kanë dobi individët dhe shoqëritë. Frytet e këtyre garave janë të përhershme. Ndërkohë që gara e një loje futbollit jep vetëm një emocion të çastit, dobia e një zbulimi shkencor, e një vakëfi apo e një veprë letrare zgjat për shekuj të tërë.

Allahu i Madhëruar na lajmëron se në cilën fushë duhet të garojmë:

“Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t’ju mbledhë të gjithëve; Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.” (Bakara, 148.)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë se smira nuk mund të gjendet në kërkimin e dijes dhe në shpenzimin e pasurisë në mirësi, por që më e shumta mund të të kihet zili.

Së pari, shpërblimi më i madh për të cilin ia vlen të garosh, është kënaqësia e Allahut Teala, pastaj xheneti dhe xhemalullah (shikimi i Allahut), të cilat janë rezultat i kësaj. Allahu Teala thotë:

“Prandaj garoni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është i përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij. Ajo është mirësia e Allahut që ia jep kujt të dojë. Allahu ka mirësi të pafund.” (Hadid, 21.)

“Me të vërtetë, të mirët do të gjenden në xhenet

duke shikuar nga fronet mirësitë që u janë dhënë. Ata do t'i njohësh prej fytyrave të tyre, që shkëlqejnë nga lumturia. Atyre do t'u jepet të pinë musht të pastër të ruajtur mirë, fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të garojnë ata që përpiqen.” (Mutaffifin, 22-26.)

Nëse dikush nuk e ka fituar dot lumturinë e përhershme, xhenetin, do të thotë se nuk ka fituar asgjë, sepse fitimet e përkohshme marrin fund. Çdo gjë e kufizuar konsumohet. E rëndësishme është që të përkohshmen ta kthejmë në të përhershme. Hazreti Isai (a.s.) ka thënë:

“Çfarëdo që të keni, shiteni dhe jepeni sadaka! Bëni për vete torba që nuk vjetrohen dhe thesare që nuk shterohen në qiej. Atyre nuk mund t'u afrohet hajduti dhe nuk mundet t'i prishë mola.” (Luka, 12/33.)

Xheneti është i përhershëm. Aty nuk ka frikë dhe as pikëllim. Në shumë ajete të Kuranit Fisnik, përshkruhet xheneti, por këto përshkrime në lidhje me xhenetin janë vetëm për të formuar një tablo dhe një përfytyrim në mendjen tonë, sepse xhenetin e vërtetë është e pamundur ta perceptojmë me përmasat e kësaj bote. Xheneti, siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka një bukuri që *“asnjë sy se ka parë, asnjë vesh nuk e ka dëgjuar dhe asnjë mendje s'e ka perceptuar”*. Për shkak se xheneti, që nuk mund ta shohim, nuk mund të përkufizohet me të panjohurën, mund të përfytyrohet duke e përngjasuar vetëm me ato që shohim.

Sipas përshkrimit të Kuranit Fisnik dhe haditheve të sakta, jeta e xhenetit mbart këto veçori kryesore:

- 1- Bukuri të përhershme dhe rehati
- 2- Paqe dhe qetësi të vazhdueshme
- 3- Forcë dhe shëndet shpirtëror dhe fizik
- 4- Ngopje shpirtërore
- 5- Shikimin e Allahut Teala
- 6- Përjetësinë

Kur të hyjnë në xhenet, të gjithë besimtarët do të mirëprehen nga engjëjt dhe do t'u thuhet:

“Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në xhenet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: ‘Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, ndaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!’” (Zumer, 73.)

Besimtarët do të hyjnë në xhenet duke përhapur dritë si hëna e plotë ose si yjet ndriçuese. Aty do të hanë dhe do të pinë si të dëshirojnë. Tretja e ushqimeve që do të hanë, nuk do t'u sjellë ndonjë

vështirësi tjetër, përveçse gromësirë dhe djersë me erë të mirë. Banorët e xhenetit nuk do të kenë nevojë për gjumë, ngaqë nuk do të ndjejnë lodhje dhe mërzë.

Gjithmonë do të jenë të shëndetshëm dhe kurrë nuk do të sëmuren. Do të jetojnë përgjithmonë dhe nuk do të vdesin. Rinia dhe gjallëria e tyre nuk do të prishet. Do ta arrijnë lehtë çdo gjë që e dëshirojnë. Do të shikojnë çdo gjë që dëshirojnë. Në zemrat e tyre nuk do të ketë urrejtje dhe smirë. Përfundimisht, do të jetojnë në një lumturi të përhershme larg çdo gjëje që mund të bëhet shkak për frikë dhe pikëllim.

Dëshirat e kënaqësisë së pakët në këtë botë, atje do të realizohen në kuptimin ideal të tyre. Aty do të ketë gra të pastra, që nuk do të kenë mangësi fizike dhe shpirtërore. Lehonja, menstruacionet dhe dobësimi nuk do të ekzistojnë. Ato do të jenë në kulmin e bukurisë dhe përsosmërisë. Përtej të gjitha këtyre mirësive, banorët e xhenetit do të shohin Zotin e Lartësuar që e kanë besuar dhe nuk e kanë parë në këtë botë. Kjo lumturi do t'i lërë në hije të gjitha mirësitë e tjera.

Ne duhet të garojmë për ta fituar këtë garë dhe për ta arritur këtë shpërblim madhështor e të pafund si xheneti dhe Bukuria e Allahut. Humbjet e disa garave të tjera mund të kompensohen. Ai që humb në një lojë futboll, mund të fitojë në një tjetër, por edhe nëse nuk fiton, nuk ndodh ndonjë tragjedi. Ndërsa, mospjesëmarrja në garën e adhurimit ndaj Allahut Teala, apo mosmarrja në mënyrë serioze e kësaj gare, nënvlerësimi i këtij shpërblimi që do të jepet në fund dhe mashtrimi i vetes me garat që janë lojëra të thjeshta, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, **“është një humbje e qartë”**. Tragjedia e madhe si privimi nga ky shpërblim madhështor dhe futja në xhehnen, i cili është vend ndëshkimi, nuk mund të imagjinohet.

Besimtari ecën në rrugën e cila e ka fundin në xhenet. Garon në mirësi që e afrojnë te xheneti dhe e largojnë nga xhehenemi. Së fundi, me mirësinë e Allahut Teala, arrin shpërblimin e përhershëm që i është premtuar. Sa bukur ka thënë Mevlana:

“Nëse do të ecësh, ec drejt Atij që të ka dhënë këmbët!” Kjo është siratu'l-mustekim- rruga e drejtë. Fundi i kësaj rruge është kënaqësia e Allahut të Madhëruar dhe xheneti, i cili është vendi i lumturisë së përhershme. Allahu Teala na bëftë prej atyre që gjithmonë ecin dhe përparojnë në këtë rrugë!

Amin!



STACIONI SHPIRTËROR I KËNAQËSISË NDAJ ZOTIT

— Ibn Kajim El-Xheuzije —

Ndër vendndalesat e “Ty të adhurojmë dhe ndihmë Ty të kërkojmë” është vendndalesa e kënaqësisë së ëndshme (Rida).

Dijetarët bien në një mendje se kënaqësia është tejet e pëlqyer, por nuk pajtohen sa i përket asaj në qoftë se ajo është obligim, apo jo. Kam dëgjuar Shehun e Islamit, Ibn Tejmije, Allahu e nderoftë shpirtin e tij, që të përçonte të dyja opinionet nga ndjekësit e Imam Hanbelit, por ai kishte prirjen që ta cilësonte kënaqësinë ndaj Zotit të dashur, por jo të detyrueshme. Ai ka thënë: “Asnjë urdhër nuk është dhënë në këtë drejtim, ndryshe nga durimi - i cili është një obligim - (megjithatë), ata që e zotërojnë atë janë të lëvduar.”

Sa i përket transmetimit, apo hadithit, se “[Zoti thotë] cilido që nuk e bart me durim sprovën që Unë i jap dhe nuk është i kënaqur me urdhërin Tim, ai duhet të gjejë një Zot tjetër pos Meje” ai ka vërejtur: “Kjo është me origjinë izraelite dhe nuk është transmetuar në mënyrë autentike nga Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë!”

Unë shtoj se veçanërisht për ata të cilët thonë se ajo është dhunti dhe jo një tipar i përftuar; si mund të jetë ajo vallë e obliguar kur ajo nuk është brenda aftësive të një njeriu?

Zotërinjtë e udhës [së drejtë] janë të ndarë në tre opinione sa i përket kësaj çështjeje:

Horasanët thonë se kënaqësia e ëndshme (rida) përfshihet në kategorinë e stacioneve shpirtërore (mekamat), duke qenë se ajo është etapa e mbrame e teuekulit (të mbështeturit me mirëbesim tek

Zoti), dhe mbi këtë pikëpamje, është e mundur që ajo të përftohet.

Irakianët pohojnë se ajo është një nga gjendjet shpirtërore (hal) dhe, prandaj, nuk mund të fitohet, por më saktë ajo zbret mbi zemrën pikërisht sikundër të gjitha gjendjet e tjera. Dallimi midis vendstacioneve dhe gjendjeve është se të parat janë të fituara ndërkohë që të dytat jepen nga Allahu si dhunti.

Një grup i tretë gjykon ndërmjet dy qendrimeve [të lartpërmendura], ndër to autori i *al-Risala* [gjegjësisht, Kushejri], i cili thotë, sikundër thonë edhe disa të tjerë, se fillesa e kënaqësisë fitohet nga robi, dhe mund të cilësohet ndër vendstacionet, por plotësimi i saj është një gjendje, dhe prandaj nuk mund të përftohet. Për rrjedhë, ajo zë fill si një vendstacion dhe përsoset si gjendje.

Ata që e vendosin atë në mesin e stacioneve shpirtërore japin si argument faktin se Zoti ka lëvduar njerëzit që e zotërojnë këtë cilësi dhe i ka nxitur ata drejt saj, gjë që sugjeron se është brenda kapacitetit të tyre për ta arritur atë. Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë) ka thënë: “Shijen e fesë e ka shijuar në të vërtetë ai që është i kënaqur me Allahun si Zot, Islamit si fe, dhe Muhamedin si pejgamber.” (Muslim # 34.) Ai gjithashtu ka thënë: “Cilido që, me të dëgjuar ezanin, thotë: “Jam i kënaqur me Allahun si Zot, Islamit si fe, dhe Muhamedin si pejgamber,” i janë falur atij gjynahet!” (Muslim # 386).

Këto dy hadithe janë boshti i fesë, dhe ata për-

mbledhin të gjithë fenë. Ata përfshijnë të qenit i mbushur me kënaqësi dhe të qenit i kënaqur me Rububijen dhe Uluhijen, të qenit i kënaqur me Pejgamberin e Tij dhe të qenit i bindur ndaj tij, të qenit i kënaqur me fenë e Tij dhe i nënshtuar ndaj saj. Cilido që i ka të gjitha këto të katra, ai është përnjëmend besimtari më i sinqertë. Një pretendim i tillë është i lehtë [për t'u bërë] me gjuhë, por në realitet [është] më e vështira nga të gjitha gjërat mbarë kur një njeri vihet në sprovë. Veçanërisht kur një njeri përballet me atë që i kundërvihet dëshirës dhe kërkimit të tij, bëhet e qartë se kënaqësia ka qenë e kufizuar në fjalët e atij njeriu dhe jo një realitet.

Të qenit i mbushur me kënaqësi dhe i kënaqur me hyjnishtësinë e Allahut përfshin të qenit i kënaqur me dashurinë, frikën, shpresën, pendimin, dhe devotshmërinë ekskluzive ndaj Tij, duke e bërë Atë objektin unik të kërkimit dhe dashurisë tënde, njëlloj si ai që është krejtësisht i kënaqur me të Dashurin e tij. E gjitha kjo përbëhet nga adhurimi i Tij dhe devotshmëria e papërlyer ndaj Tij.

Të qenit i kënaqur me rububijen e Allahut është të jesh i kënaqur me planin e Tij për robin e tij, si dhe ta besh vetëm Atë objekt të mbështetjes. Kërkimi i ndihmës, dhe burimi i përkrahjes dhe besës nuk është askush tjetër përpos Allahut.

E para e këtyre përbën të qenit i kënaqur me urdhëresat [fetare] të Allahut dhe e dyta është të qenit i kënaqur me dekretet [ekzistenciale] të Zotit.

Të qenurit i kënaqur me Muhamedin (a.s.) si Pejgamber i Tij nënkupton bindje dhe nënshttrim të plotë ndaj tij, ashtu që ai bëhet i parapëlqyer përpara vetes së një njeriu, të mos kërkohet udhëzim përpos në fjalët e tij, të mos kërkohet një gjykatës përpos tij, as të bëhet dikush tjetër një gjykatës mbi mësimet e tij, as të qenit i kënaqur me gjykimin e dikujt pos tij, as në çështjen e Emrave dhe Cilësive të Allahut, as në çështjen e realiteteve të fesë dhe

vendstacioneve të saj të ndryshme të përshpirtshme, as në çështjen e gjykimeve të tij, qofshin ato të ndërlidhura me çështjet e jashtme apo ato të brendshme. Në qoftë se një njeri është i pazoti që të gjejë gjykimin e tij, të kthyerit e tij drejt ndonjë burimi tjetër mund të jetë si ai i cili nuk mund të gjejë ndonjë ushqim dhe i kthehet cofëtines dhe gjakut vetëm si pasojë e nevojës së skajshme, dhe rasti më i mirë do të ishte që ai ta trajtonte atë si dheu për tejmum kur ai e ka të pamundur të gjejë ujë purifikues.

Të qenit i kënaqur me Islamin si fe do të thotë të jesh i kënaqur me atë që feja urdhëron, ndalon, gjykon dhe informon, dhe të mos lejohet që në zemër të ekzistojë parehatia apo dyshimi më i vogël në lidhje me të, por t'i nënshtrohet plotësisht asaj, madje edhe në qoftë se kjo është kundër dëshirave apo planeve të dikujt ose kundër mësimave të shejhut të dikujt, autoritetit apo *taklidit* (imitimit) të njeriut, apo shkollës së tij.

Në qoftë se arrin ndonjëherë këtë vendstacion, ti do ta glesh veten tënde të vetmuar në mesin e njerëzve, por jo në gjirin e atyre që janë të huaj në këtë botë. Kështu që të jesh i paralajmëruar dhe mos e lër kurrë veten tënde të ndihesh i vetmuar madje edhe në qoftë se ti liresh i vetëm në këtë kauzë - sepse kjo, pasha Allahun, është nderi dhe fuqia e vërtetë, dhe ky është çmimi për shoqërinë e Zotit dhe të dërguarit të Tij - kjo është një puhizë e afërsisë së Tij përfundimtare. Kjo është domethënia e të qenit i kënaqur me Atë si Zoti yt, me Muhamedin, mbi të qofshin paqja dhe mëshira, si i Dërguari yt, dhe me Islamin si feja jote.

Në të vërtetë, sa herë që një rob i sinqertë gjen një grimë të ndarjes dhe tëhuajësimit [nga të tjerët] për hir të Zotit dhe shijon shoqërinë ekskluzive të Allahut, ai është i etur për më shumë prej saj, e i lutet Allahut: "O Allah, shtoje tek unë veçimin nga njerëzit, dhe vetminë në dynja, dhe afërsinë

me Ty!” Sa më tepër që ai shijon ëmbëlsinë e këtij tëhuajësimi dhe veçimi, aq më tepër fillon të kuptojë se afërsia me njerëzit [e kësaj bote] është vetmia e vërtetë, të qenit i nderuar nga të tillët është poshtërimi i vërtetë, të pajtuarit me opinionet e tyre dhe ndytësinë e mendjeve të tyre është vetë thelbi i injorancës, dhe të ndjekurit e zakoneve dhe konvencioneve të tyre është të qenit vërtet i huaj. Ai nuk ka parapëlqyer ndokënd nga gjërat e krijuara në hisen e tij nga Allahu, as nuk e ka shitur pjesën e tij nga Allahu në këmbim për pajtimin e tyre [njerëzve] në atë që nuk do të shkaktojë asgjë pos humbjes, dhe dobia fundore e të cilit është të fitojë dashamirësinë e tyre në këtë vendbanim tokësor. Kur zinxhiri i shkakësisë merr fund, realitetet kuptohen dhe ajo që është në varre ringjallet dhe ajo që është në kraharore nxirret jashtë, kur të fshehtat zbulohen dhe një njeri nuk gjen asnjë fuqi apo ndihmë përpos në Mbrojtësin [*Valiun*] e Vërtetë, fitimi do të bëhet atëbotë i ndarë nga humbja, dhe ajo që do të ketë vlerë në Peshore do të bëhet e qartë, dhe vetëm Zotit i kërkohet ndihmë dhe mbështetje.

Zgjidhja e çështjes, pra, është se stacioni shpirtëror i kënaqësisë së ëndshme fitohet në lidhje me shkaqet e saj dhe dhurohet në lidhje me thelbin e saj. Sapo një njeri ka fituar shkaqet e saj dhe ka mbjellur farat e saj, ai e vjelë frytin e kënaqësisë prej saj. Sepse kënaqësia është fundi i të teuekullit (mbështetje me mirëbesim) tek Allahu, dhe sapo një njeri zë rrënjë mirë në mbështetje, dorëzim, dhe delegim, kënaqësia do të vijë pashmangshmërisht tek ai. Megjithatë, për shkak të statusit të saj të fuqishëm dhe paaftësisë së pjesës më të madhe të egove për të qenë të prirur drejt saj dhe vështirësisë për ta ruajtur atë, Allahu, në mëshirën dhe prirjen për t’ja lehtësuar robërve të Tij, nuk e ka bërë atë një obligim mbi krijimin. Më saktë, Ai e ka bërë atë të rekomandueshme dhe të lëvdueshme, duke premtuar se shpërblimi i kënaqësisë së tyre me Atë në të gjitha gjërat nuk është asgjë më pak sesa kënaqësia e Tij me ata, që është më e madhe dhe më e lartë se Kopshtet (Xhënetet) dhe gjithçka që gjendet në to.

Cilido që është i kënaqur me Zotin e tij, Allahu është i kënaqur me atë; më saktë, kënaqësia e një robi karshi Allahut është një pasojë e kënaqësisë së Allahut me atë. Në të vërtetë, kënaqësia e Allahut me një rob rrethon kënaqësinë e robit nga çdo anë. Sepse është në sajë të kënaqësisë dhe mëshirës së Allahut që robi arrin kënaqësinë. Sapo robi e ka arritur atë, Allahu i përgjigjet duke qenë gjithnjë e më tepër i kënaqur me atë. Kjo është arsyeja për-

se kënaqësia është më e madhja nga portat drejt Allahut, parajsja e tokës, një shtyrje pa ngut e afatit për të diturit, jeta e të dashuruarve, një begati për adhuruesit, dhe freskia e syve të të devotshmëve.

Më i madhi i shkaqeve lehtësuese të kënaqësisë është që të kapesh pas atyre gjërave që Allahu ka karakterizuar se janë burimi i kënaqësisë së tij, sepse kjo pa dyshim shpie në shtegun e mbushjes me kënaqësi dhe ëndje.

E pyetën Jahja ibn Muadhin: “Kur e arrin një rob stacionin shpirtëror të kënaqësisë?” Ai tha: “Kur ai e ka ngritur veten e tij mbi katër parime në marrëdhënien me Zotin e tij, ai thotë: “[O Zot] Në qoftë se Ti më jep mua, unë pranoj; në qoftë se Ti më privon mua [nga diçka], unë jam i kënaqur; në qoftë se Ti më lë mua [duke më dhënë kohë të lirë], unë të adhuroj Ty; dhe në qoftë se Ti më thërret mua, unë të përgjigjem.”

Xhunejdi ka thënë: “Kënaqësia është saktësia e diturisë që arrin në zemër, sepse kur zemra ndeshet me realitetin e diturisë, ajo arrin kënaqësinë.”

Kënaqësia dhe dashuria nuk janë si stacionet shpirtërore të shpresës dhe frikës. Sepse kënaqësia dhe dashuria janë dy prej gjendjeve të banorëve të Parajsës, e megjithatë ato nuk ndahen nga kërkimtari në këtë dynja, në gjendjen e ndërmjetme [ndërmjet vdekjes dhe Ditës së Gjykimit], dhe në amshim [*ahiret*]. Frika dhe shpresa, në kontrast, nuk i shoqërojnë punëdrejtët në Parajsë, pasi tani ata e dijnë se e kanë arritur atë që kishin shpresuar dhe e kanë shmangur atë së cilës i frikësoheshin. Ata sërish mund të shpresojnë përjetësisht në bujarinë madhështore të Tij, por një shpresë që nuk ka asnjë fije pasiguri të bashkangjitur në të, por një shpresë pararendëse në një premtim që është i vërtetë nga një i Dashur që është i Gjithëpushtetshëm. Kjo shpresë është e një rendi krejtësisht të ndryshëm në krahasim me shpresën në jetën tokësore.

Ibn ‘Ata’i, Allahu pastë rahmet për të, ka thënë: “Kënaqësia është të gjeturit e qetësisë së zemrës në atë që Zoti ka përzgjedhur përjetësisht për robin si zgjedhja më e mirë e mundshme, dhe kështu ai është i kënaqur me atë.”

Unë shtoj se kjo kënaqësi i përket asaj që është nga Allahu; sa për kënaqësinë me Atë, ajo është edhe më e lartë dhe më fisnike se sa ajo; dallimi ndërmjet një njeriu i cili është i kënaqur me të Dashurin e tij, dhe një njeriu që është i kënaqur me atë që ai merr nga i Dashuri, është pjesa e vetë vetes së tij.

* Artikulli është marrë nga erasmusi.org

RINIA DHE XHAMIA



— Prof. dr. Mehmet Gërmez —

Allahu çdo njeriu i ka dhënë një afat të caktuar jete në këtë botë. Në gjuhën arabe fjala “jetë” dhe “ndërtim” vijnë prej së njëjtës rrënjë. Prandaj një jetë e cila nuk është e mbushur me ndërtim nuk konsiderohet jetë. Allahu e ka krijuar njeriun prej toke dhe i ka dhënë atij detyrën e ndërtimit në tokë. Në këtë proces ndërtimi, parësor është ndërtimi i zemrës dhe shpirtit, sepse njeriu pa ndërtuar shpirtin dhe zemrën nuk mund të ndërtojë qytete, fshatra, kulturë dhe qytetërim. Çdo njeri për të ndërtuar vetveten ka nevojë për besim dhe për një faltore. Në Ditën e Gjykimit njeriu, pasi të pyetet se ku dhe si e ka kaluar jetën e tij, do të pyetet veçanërisht për periudhën e rinisë e cila në vetvete është pjesa më e rëndësishme e gjithë jetës së tij. (Trimidhi, Sifatu'l Kijame, 1.) Pejgamberi (a.s.), të riun ideal e ka përkufizuar si personin i cili e kërkon lumturinë dhe gëzimin në ibadetin ndaj Allahut. Nga ana tjetër, ka lajmëruar se i riu që mbron nderin dhe zemrën e ka të lidhur me xhaminë në Ditën e Gjykimit do të jetë nën hijen e Allahut. (Buhari, Ezan, 36.) Pejgamberi (a.s.), të riun në rrugë të drejtë dhe të vetëdijshëm për përgjegjësinë që mbart e ka konsideruar si një pengesë të fortë përballë dënimit hyjnor. Sipas Pejgamberit (a.s.), për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë është i një rëndësie jetësore kalimi i periudhës së rinisë në ibadet dhe larg ndalesave hyjnore. Në jetën e Profetit (a.s.), të rinjtë kanë pasur një vend të veçantë. Pejgamberi (a.s.), ndërtonte një komunikim shumë të sigurt dhe të sigurt me të rinjtë dhe interesohej personalisht për edukimin dhe arsimimin e tyre. Të gjithë të rinjtë që kaluan përmes edukimit të Pejgamberit (a.s.), u bënë gjithsecili nga një pishtar i cili ndriçonte njerëzimin. Ishte ky besim që kishte Pejgamberi (a.s.), tek rinia që e shtyu atë t'u jepte atyre detyra të rëndësishme, duke filluar nga drejtimi tek komandant ushtrie, nga mësimdhënia në tregti. Sahabët e rinj, të edukuar nga Pejgamberi (a.s.), si Ebu Hurejre, Abdullah ibn Omer, Abdullah ibn Mesud,

Abdullah ibn Abbas, Muadh ibn Xhebel, Enes ibn Malik etj., të cilët kanë kontribute të veçanta në ndërtimin e qytetërimin islam. Në qytetërimin islam janë dalluar shumë të rinj të cilët me diturinë, urtësinë, shkencën, poezinë, letërsinë, kulturën, artin, dashurinë i kanë dhënë tonin qytetërimin islam. Në qytetërimin islam të rinjtë gjithmonë janë konsideruar si personalitetet e së ardhmes.

Natyrisht që periudha e rinisë ka edhe vështirësitë e veta. Së pari periudha e rinisë është periudha ku forca, fuqia, entuziazmi dhe dëshira janë në kulmin e tyre. Të rinjtë janë të gatshëm të përqafojnë kulturë të ndryshme, pa i situar vlerat e tyre dhe kanë aftësi t'u përshtaten menjëherë gjendjeve të reja. Kjo sjell tëhuajzimin e tyre me shoqërinë, përplasjen e brezave dhe krizë identiteti. Dhe si përfundim, një rini e shkëputur nga familja, nga vlerat fetaroshpirtërore, një rini e cila vrapon mbas përmbushjes së dëshirave momentale krejtësisht larg idealeve, normalisht që e ka shumë të vështirë për të përballuar dhe luftuar sëmundjet e kohës.

Rinia e sotme e konsideron botën e paraardhësve të ngushtë dhe të papranueshme. Prandaj është e rëndësishme që në komunikim me rininë të ndërtojmë një mënyrë të re. Rinia e sotme i jep rëndësi të madhe individualitetit, prandaj ne nuk duhet të ndërhyjmë në çështjet individuale të tyre, por duhet të krijojmë ura komunikimi me zemrën dhe botën e tyre të mendimeve, të bisedojmë dhe t'u paraqesim atyre një model përmes të cilit të zbulojnë veten e tyre. Është e vërtetë që të rriturit kanë probleme të theksuara në krijimin e një komunikimi normal me brezin e ri, por kjo vjen edhe nga fakti që ne jemi mësuar vetëm t'u flasim atyre, por në të vërtetë ne më tepër se t'u flasim duhet t'i dëgjojmë ata. Kjo është një domosdoshmëri për t'i kuptuar dhe hyrë në botën e zemrës së tyre.

Lutja jonë është rritja e një rinie e cila mbron vlerat shpirtërore dhe merr përsipër përgjegjësitë për të ardhmen!



RRAPI QË QUHET MËSHIRË

— Mehmet Dinç —

Siç thotë Kurani Fisnik, Allahu është i Mëshirshëm, kurse njeriu është mizor. Mëshira është dritë e pafundme, kurse mizoria është errësirë e plotë. Njeriu, i cili është krijesa më e përsosur, mund të arrijë dritën e mëshirës duke eliminuar errësirën e padrejtësisë. Dhe një pikë e vogël mëshire mjafton për të shqyer katranin e zi të padrejtësisë. Mjafton që njeriu ta tërheqë atë pikë duke përvetësuar moralin hyjnor. Cili është hapi i parë i përvetësimit të moralit hyjnor?

Libri ynë, Kurani Fisnik fillon me “Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, Ai është Mëshiruesi”. Pra, hapi i parë duhet të jetë përvetësimi i mëshirës. Mëshirë do të thotë që njeriu të ketë ndjeshmëri ndaj vuajtjeve të veta apo të dikujt tjetër dhe t’i japë një vend të madh në zemrën e tij vëmendjes që do t’i vërë re ato dhe përpjekjes që do t’i lehtësojë. Kur themi dhimbje, a kemi parasysh vetëm dhimbjen e trupit? Sigurisht që jo. Edhe zemra e njeriut mund të

ketë dhimbje, edhe mendja e tij. Edhe ato kërkojnë mëshirë si “zogu me krahë të thyer”.

Jeta është një provë dhe për shkak të natyrës së çdo prove, ajo ka vështirësi. Mëshira është eliksiri që do të lehtësojë vështirësitë e provës së jetës. Këtë na e tregojnë numri në rritje i studimeve psikologjike mbi mëshirën këto vitet e fundit. Hulumtimet tregojnë se mëshira ushqen shëndetin fizik, rrit mirëqenien emocionale dhe forcon marrëdhëniet tona shoqërore. Ne themi se kemi gjenin e mëshirës sot dhe se mëshira është gjëja e pashmangshme që njerëzimi të mbijetojë, si kundër evolucionistëve që bëjnë moton bazë se më i forti do të mbijetojë.

Sot ka shumë kërkime që tregojnë se si e përmirëson mëshira humorin, se sa e rrit efikasitetin në jetën e biznesit, se sa e ndryshon zhvillimin e trurit tonë dhe se sa është e dobishme, se si i bën njerëzit shpresëdhënës e pozitivë, se si e redukton tendencën për të dëmtuar dhe për të

bërë krime, se si forcon imunitetin dhe madje, se si zvogëlon rrezikun e sulmit në zemër. Ndërsa fusha të ndryshme të psikologjisë përqendrohen në studimet e orientuara nga mëshira, thelbi i të gjitha studimeve mund të shprehet me fjalinë e mëposhtme: «Nëse dëshiron t'i bësh të tjerët të lumtur, ji i mëshirshëm. Nëse dëshiron ta bësh veten të lumtur, ji i mëshirshëm.»

Me gjithë këtë, të qenët i dhembshur nuk është një njohuri që mësohet për t'u marrë parasysh dhe më pas për t'u konsideruar, vendosur dhe shndërruar në sjellje kur haset në një situatë. Përkundrazi, mëshira është një unitet emocioni dhe sjelljeje që shfaqet si instinkt për njeriun, kafshën, natyrën dhe sendet, me pak fjalë, për të gjitha llojet e qenieve. Atëherë, le ta mendojmë mëshirën si një rrap që e mbjellim, i shërbejmë dhe e rritim në zemrat tona, të frymëzuar nga poeti i cili ka thënë: “Nuk e shkëpus shpresën prej teje, sepse në zemrën tënde është një rrap që quhet mëshirë.”

Pema e rrapit rritet në të gjitha llojet e dherave. Atëherë le ta dimë se nuk kemi nevojë të jemi në një vend të veçantë dhe në një qytet të caktuar për të pasur një rrap që quhet mëshirë. Kudo që të jemi ai fidan do të rritet nëse e mbjellim me sinqeritet dhe zell.

Rrapi mund të mbillet në të katër stinët. Atëherë, le të mos presim kohë dhe momente të veçanta për të mbjellë në zemrat tona apo për t'i ushqyer ato. Pa humbur kohë, le të preokupohemi se si t'i mbjellim apo se si t'i ushqejmë ato sot.

Rrënjët e rrapit janë të forta, ndaj le të shohim se si mund t'i forcojmë rrënjët e pemës sonë të mëshirës. Le ta thellojmë dhe forcojmë besimin dhe imanin në rrënjët e rrapit tonë.

Rrapi rritet shumë shpejt. Atëherë, nëse nuk kemi në zemër një rrap që quhet mëshirë, le të veprojmë tani dhe ai do të rritet në një kohë të shkurtër. Nëse ka, le ta ushqejmë më shumë, që të bëhet një rrap më i madh, në mënyrë që të përfitohet më shumë nga hija e tij...

Duke qenë se trangu i rrapit është i lagësht, ai tërheq rrufetë. Sytë e një njeriu që rrit në zemrën

e tij një rrap të quajtur mëshirë janë gjithashtu të lagur dhe tërheqin rrufe. Prandaj, le të përiqemi të qëndrojmë të vendosur, duke e ditur se do të na godasë rrufeja, por duke u zotuar se nuk do të shembemi.

Degët e rrapit janë të shpërndara, nuk arrijnë në një vend të vetëm, por arrijnë në vende të ndryshme. Në këtë rast, pema jonë e mëshirës nuk duhet të arrijë gjithmonë në të njëjtat vende dhe te të njëjtët njerëz, por duhet të arrijë te të gjitha llojet e vendeve ku mundet.

Gjethja e rrapit është si një dorë me pesë gishta. Nëse e mbajmë atë dorë, do të na çojë drejt paqes në të dy botët. Kërkimet moderne të psikologjisë garantojnë se paqja e kësaj bote arrihet me mëshirë. Edhe paqen në botën tjetër që vjen me mëshirë, zaten e dimë nga Libri ynë, Kurani Fisnik.

Rrapi nuk preket shumë nga pluhuri dhe gazrat. Kjo është arsyeja pse ata mund të mbijetojnë dhe të qëndrojnë në këmbë edhe në qytetet e mëdha industriale. Pra, edhe sikur pluhurat dhe gazrat e kulturës popullore, të cilave nuk mund t'u shpëtojmë, të arrijnë dhe të na infektojnë disi, le ta dimë se përkundër gjithë kësaj, pema jonë e mëshirës mund të mbetet e gjallë dhe e shëndetshme dhe mund të mos preket. Të mos gjejmë justifikim për të ikur apo dorëzuar përballë pluhurit dhe gazit të qyteteve që janë kthyer në gurë nga pamëshirësia.

Rrapi ka hije të madhe dhe nga hija e tij përfitojnë lloj-lloj njerëzish. Atëherë, nëse kemi një pemë të mëshirës në zemrat tona, njerëzit që përfitojnë nga mëshira jonë, le të mos na bëjnë të pakënaqur e të mos na shqetësojnë. Gjithashtu ne nuk duhet të presim asgjë në këmbim.

Rrapi është jetëgjatë. Atëherë, le të dimë se rrapit i quajtur mëshirë, të cilin e kemi mbjellë në zemrat tona, mund të vazhdojë të ekzistojë edhe nëse trupi ynë largohet nga kjo botë dhe mund të vazhdojë të jetë i dobishëm për të gjitha llojet e qenieve. Mjafton që përderisa të ekzistojmë, ta mbrojmë atë, ta ushqejmë dhe ta rritim.

“Një rrap ngrihet para nesh”, thotë Zarifogllu. Edhe ne kemi rrape që ngrihen para nesh, zemra që i mbartin ato rrape dhe të mëdhenj që posedojnë zemra të tilla. Andaj le t'i shohim dhe t'i njohim ata dhe le të shkojmë pas tyre, në mënyrë që edhe ne të rritim rrape që do t'i ndjekin brezat e tjerë.

Rrapi rritet shumë shpejt. Atëherë, nëse nuk kemi në zemër një rrap që quhet mëshirë, le të veprojmë tani dhe ai do të rritet në një kohë të shkurtër. Nëse ka, le ta ushqejmë më shumë, që të bëhet një rrap më i madh, në mënyrë që të përfitohet më shumë nga hija e tij...

POPULLSIA E BOTËS DHE SIGURIA USHQIMORE

— Dr. Halil Kurt —

Në mijëra vjet nga Ademi (a.s.), deri në dy shekujt e fundit, popullsia në glob nuk u rrit shumë për shkak të vdekjeve masive për arsye të ndryshme si lufta, sëmundjet epidemike, thatësira dhe uria. Popullsia e botës arriti në 1 miliard për herë të parë në 1804. Si rezultat i revolucionit industrial në shekullin e 19-të dhe zhvillimeve në fushën e mjekësisë, popullsia u rrit me shpejtësi, duke arritur në 2 miliardë në vitin 1927, 3 miliardë në 1960, 4 miliardë në 1974, 5 miliardë në 1987, 6 miliardë në 1999 dhe 7 miliardë në 2011. U deshën 123 vjet që popullsia të arrinte në 2 miliardë. Vdekja e miliona njerëzve nga Lufta e Parë Botërore (1914-1918) dhe sëmundjet epidemike si gripi spanjoll (1918-1920) ishin efektive në këtë periudhë relativisht të gjatë. Ndërkohë, popullsia arriti në 3 miliardë për 33 vjet edhe pse ishte Lufta e Dytë Botërore (1939-1945). Pas vitit 1960, 1 miliardë më shumë iu shtuan popullsisë së botës në një periudhë të shkurtër prej 13 vjetësh mesatarisht. Popullsia e botës, e cila është 7 miliardë 770 milionë që nga viti 2020, po rritet me më shumë se 80 milionë çdo vit.

Edhe pse sasia e tokës së punueshme, burimet ujore dhe kushtet klimatike nuk kanë ndryshuar

shumë në 60 vitet e fundit, është prodhuar më shumë ushqim sesa nevoja e popullsisë që po rritet me shpejtësi. Teknika të reja si përdorimi i makinerive në aktivitetet bujqësore, përmirësimi i farës, ujitja dhe plehrat kimike ishin efektive në këtë rritje. Kompanitë shumëkombëshe që operojnë në një shkallë globale ishin pioniere të këtyre risive dhe rritën prodhimin. Falë farave hibride që këto kompani manipuluan në mjedisin laboratorik, rendimenti i kulturave tokësore dhe produkteve shtazore u rrit në mënyrë eksponenciale. Megjithatë, përhapja e këtyre farave dëmtoi strukturën natyrore si të tokës ashtu edhe të qenies njerëzore. Kompanitë ushqimore dhe farmaceutike me origjinë perëndimore, të cilat përshkruhen si «ata që bëjnë të keqen në botë» në ajet, nga njëra anë, dëmtuan shëndetin e njerëzve me farat e egra të modifikuara gjenetiki, nga ana tjetër, shkaktuan dobësimin e imunitetit të trupit duke i inkurajuar njerëzit që sëmuren që të konsumojnë ilaçe. Natyrisht, ndërkohë që ushqimi tashmë përfshihet në klasën e produkteve organike luksoze, medikamentet antibiotike të konsumuara si ushqimet e lehta kanë fituar gjithashtu mbizotërim. Cilësia e ushqimit të konsumuar luan një rol të rëndësishëm në humbjen e jetëve në epideminë e virusit Corona, përgjithësisht te njerëzit me sistem





të dobët imunitar. Në lidhje me këtë, ajeti kuranor në të cilin thuhet: **“Kur merr detyrën, ai punon për të shkaktuar ngatërresa në tokë dhe për të shkatërruar të korrat dhe brezat. Allahu nuk e do shkatërrimin.”** (Bekare, 205), është një paralajmërim i qartë hyjnor për njerëzit.

Ndërsa Islami deklaron se «ai që ka të drejtë është i fortë», vendet perëndimore me rrënjë në Greqinë e Lashtë vendosën një rend botëror ku «i forti ka të drejtë». Sipas të dhënave statistikore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), rreth 820 milionë njerëz, që korrespondon me 11% të popullsisë së botës, kryesisht në vendet e Afrikës Sub-Sahariene, janë të uritur ose të kequshqyer. Ndërsa një pjesë e botës është e uritur, të tjerët vuajnë nga pesha e tyre e tepërt. Në të vërtetë, popullsia mbipeshë dhe obeze është trefishuar në mbarë botën që nga viti 1975. 40% (afërsisht 2 miliardë) e popullsisë së rritur mbi moshën 18 vjeç janë mbipeshë dhe 13% (rreth 700 milionë) janë obezë. Çdo vit, numri i vdekjeve për shkak të mbipeshës rritet në mënyrë eksponenciale në mbarë botën. Në ajetin fisnik thuhet: **“O njerëz! Hani nga të gjitha begatitë e mia në tokë, me kusht që ato të jenë hallall dhe të pastra. Por mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është armik i hapur për ju.”** (Bekare, 168). Ajeti u thotë të gjithë njerëzve “të hanë me kusht që të jetë hallall dhe i pastër”. Ngrënia e tepërt dhe grykësia janë shpërdorim, e Allahu nuk i do ata që shpërdorojnë.

Pandemia e shkaktuar nga virusi i quajtur Covid-19 bëri që në shumë vende të shpallet karantinë dhe të mbyllet kufijtë. Nëse kjo situatë vazhdon për një kohë të gjatë, ka të ngjarë që zinxhiri i furnizimit dhe tregtisë globale të ndërpritet. Në shkallë globale, drithërat si gruri, orizi dhe misri janë produkte bujqësore me rëndësi strategjike. Në raste të tilla, zakonisht vendosen kufizime në shitjen e produkteve ushqimore në vendet e huaja. Dihet se ka pasur periudha në histori ku ushqimet bazë, veçanërisht mielli, ishin të shtrenjta deri në 40 herë, por ende

nuk mund të gjendeshin gjatë periudhave të zisë së bukës dhe luftërave të lidhura me thatësinë. Rusia tashmë ka kufizuar përkohësisht eksportin e disa produkteve të grurit. Vendime të ngjashme ka të ngjarë të ndiqen nga vendet eksportuese të drithërave dhe farave vajore si SHBA-të, Kanadaja, Ukraina dhe Argjentina.

Kushtet klimatike dhe potencialet bujqësore të Anadollit, Iranit, Turkistanit, Indisë dhe vendeve të Azisë Juglindore, ku popullsia myslimane përbën shumicën, janë relativisht në një nivel për të plotësuar nevojat e tyre bazë ushqimore. Nga ana tjetër, duke qenë se Gadishulli Arabik dhe shumica e vendeve të Afrikës Veriore janë të mbuluara me shkretëtira, ato varen nga burimet e huaja për furnizimin e shumicës së produkteve ushqimore, me përjashtim të hurmave. Sa më të pasura që janë vendet arabe për sa u përket rezervave të naftës dhe gazit natyror, aq më të varfra janë për sa u përket burimeve ujore dhe ushqimeve bazë. Edhe pse Sudani, një nga vendet arabe, ka rezerva të konsiderueshme tokësore dhe ujore, potenciali i tij ende nuk është vlerësuar, pasi aktivitetet bujqësore në vend kryhen me metoda shumë primitive. Në fakt, kur ofrohet infrastruktura dhe mbështetja teknike për disa vende afrikane si Tanzania dhe Kameruni, është e mundur të rritet disa herë prodhimi bujqësor në një kohë të shkurtër.

Nëse vendet e Gjirit (Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajti, Katari, Omani dhe Bahrejni) popullsia e të cilave është rritur më shumë se katër herë në 60 vitet e fundit, shumë mbi mesataren botërore, do të kishin investuar një pjesë të parave që paguajnë për armë dhe konsum luksoz në zhvillimin bujqësor të vendeve të varfra islame në kontinentin afrikan, të paktën nuk do të kishin problem në furnizimin e produkteve ushqimore bazë në të cilat mund të bien në të ardhmen. Kur vendet furnizuese globale të ushqimit në botë të ndalojnë eksportin e produkteve bazë ushqimore, a do t'i ushqejnë këto vende dollarët e naftës?



SHOQËRI QË KISHTE ARRITUR PREHJEN

Sa më shumë që të shtohen besimtarët e përsosur, zemrat e të cilëve e kanë arritur istigfarin dhe besimin e palëkundur me falënderim, lavdërim dhe dhikër ndaj Zotit, sa më shumë që të shpërthejë mëshirë prej shpirtrave të tyre, po aq edhe shoqëria do të arrijë prehjen dhe lumturinë.

UMETI MESATAR

Umeti i kohës së fundit ka arritur njërën nga mirësitë më të mëdha të Allahut (xh.xh.). Jemi bërë umet i Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.). Zoti (xh.xh.), në ajetin fisnik i shpreh si më poshtë cilësitë me të cilat na ka pajisur dhe mënyrën e adhurimit që kërkon prej nesh:

“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë (mesatare), që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit (të përfaqësoni Islamin) dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...” (Bekare, 143)

Një personalitet dhe moral i lartë që do të jetë dëshmitar i Zotit për njerëzimin, adhurimet, veprat dhe jeta sociale e këtij niveli... Përveç të tjerash, një jetë me anë të të cilës mund të fitojmë pëlqimin dhe kënaqësinë e Pejgamberit i cili do të jetë dëshmitar për ne. Një jetë me anë të të cilës do ta bëjmë të buzëqeshë atë fytyrën e bekuar...

Allahu Teala pothuajse po kërkon prej nesh, si nxënësit e edukuesit më të madh dhe mësuesit më të lartë që ka dërguar më në fund, që të jemi shembull ndaj të gjithë nxënësve me sjelljet tona shembullore që do të shfaqim dhe të mos e turpërojmë mësuesin tonë të veçantë. Në ajetin fisnik thuhet:

“Thuaju (o i Dërguar!): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.” (Al Imran, 31)

“Sahabët e nderuar e arritën kënaqësinë e Allahut Teala dhe pëlqimin e Pejgamberit duke jetuar me vëllazërinë ensarë-muhaxhirë, me garën e infakut dhe me vendosmërinë e entuziazmin për ta përhapur në çdo anë të botës fjalën e Zotit (xh.xh.).”

Detyrat tona nuk janë të njëanshme. Ato janë edhe të dukshme, edhe të padukshme... Edhe në thellësitë e jetës sonë individuale e shpirtërore, edhe në të gjitha fazat e jetës shoqërore e ekonomike... Kryerja e detyrës në njërën anë të jetës kurrë nuk do të thotë që ta neglizhojmë anën tjetër. Të gjitha si tërësi janë të domosdoshme dhe secila ka llogarinë e saj.

Le të meditojmë Luftën e Tebukut si një shembull nga Epoka e Lumturisë.





NGA NJË FRONT NË NJË TJETËR

Sahabët që kishin përjetuar shumë vështirësi dhe luftëra të tmerrshme për vite me radhë, u sprovuan edhe me një sprovë tjetër. Të marrësh një rrugë qindra kilometra në të nxehtin përvëlues dhe në kohën e mbledhjes së prodhimeve për të luftuar kundër shtetit më të fuqishëm të periudhës...

“Sa’d ibn Hejseme dhe babai i tij ditën e Bedrit hodhën short se kush do të shkonte në luftë. Shorti i ra Sa’dit. Babai i tha: “Bir i dashur! Ji altruist sot. Më jep përparësi mua, në mënyrë që të shkoj unë në luftë në vendin tënd.” Sa’di i tha: “Do ta bëja atë që thua nëse në fund të kësaj do të kishte diçka tjetër përveç xhenetit.”

Ata e kaluan edhe këtë sprovë. Në këtë udhëtim të mundimshëm i cili u quajt “Udhëtimi i Vështirësisë”, lëkura iu ngjit për kockash.

Domethënë se e kemi kusht që të sakrifikojmë çdo gjë në përpjekjet tona fizike dhe aparente. Andaj është e domosdoshme që t’ua vëmë kraharorin vështirësive dhe të heqim dorë nga interesat vetjake... Sahabët po ktheheshin nga Tebuku në Medine si njerëz që e kishin marrë këtë mësim të



madh dhe që e kishin kryer një detyrë madhështore në rrugën e xhihadit dhe predikimit. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), ka thënë:

“Tani po kthehemi nga xhihadi i vogël për te xhihadi i madh.”

Sahabët e nderuar u çuditën dhe e pyetën:

“A ka xhihad më të madh se ky, o i Dërguari i Allahut?”

Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.), e shpjegoi kështu:

“Po! Tani po kthehemi nga xhihadi i vogël për te xhihadi i madh; xhihadi me nefsin!” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, II, 73.)

Domethënë se një luftë më e madhe dhe më e rëndësishme sesa përpjekjet më të mëdha në jetën sociale, përjetohet në botën e brendshme. Ajo është lufta me nefsin.

Çfarë është lufta me nefsin?

Formimi i miqësisë ndërmjet Allahut Teala dhe njeriut. Marrja pjesë nga miqësia me Allahun e Madhëruar duke arritur dëlirësinë shpirtërore dhe pastërtinë e zemrës në botën e brendshme siç shprehet në ajetet fisnike:

“*(Pejgamberi me lejen e Allahut) i pastron ata, i edukon dhe ua dëlir botën e brendshme.*” Arritja e prehjes shpirtërore dhe e bindjes së plotë.

Bindja e plotë e zemrës është një zhvillim i pafund. Kjo ngjarje që tregohet në ajetet fisnike reflekton përpjekjen e madhe të Ibrahimit për ta bërë zemrën të bindet plotësisht.

“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë (mesatare), që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit (domethënë të përfaqësoni Islamin) dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...” (Bekare, 143)”

BINDJA E PLOTË E NJË ZEMRE QË U BË HALILULL-LLAH (MIKJA E ALLAHUT)

“Kur Ibrahim i tha:

“O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!”

Zoti i tha:

“A nuk beson?”

“*(Sigurisht) që të besoj.*” - *iu përgjigj Ibrahim, “por dëshiroj të më qetësohet zemra.”*

(Nisur nga kjo) *Allahu i tha:*

“*Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.*”” (Bekare, 260)

“*Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”* (Al Imran, 31)

Ibrahimi arriti gradën halilull-llahu (mik i Allahut). Ai kaloi çdo lloj sprove me jetën, pasurinë, fëmijët, përpjekjet për udhëzimin e popullit të vet, hixhretin dhe nënshtrimin ndaj Zotit (xh. xh.), arriti prehjen shpirtërore dhe u bë mik i Allahut Teala. Por për ta bindur zemrën nëse e kishte arritur apo jo gradën e marifetull-llahut (njohjes së Allahut) në atë fushën e pafundme të zhvillimit dhe nëse ishte bërë apo jo mik i Zotit, i drejtoi Allahut këtë pyetje.

Ai u besonte esmave (emrave) të Allahut Teala “Muhji/Rigjallëruesi” dhe “Muid/Rikrijuesi”. I njihnte me një dije të plotë (Ilmul Jakin) këto cilësi të Zotit (xh.sh.), por dëshironte të arrinte gradën “ajnel jakin/dijen e palëkundur” duke i parë me sytë e tij këto shfaqje të mirësisë së Allahut të Madhëruar.

Ibrahimi pothuajse po thoshte:

“O Zot! Dëshirova ta shikoja këtë, në mënyrë që zemra ime të bindej plotësisht nëse e kisha arritur apo jo gradën e miqësisë me ty. O Zot! A e kam arritur gradën e miqësisë në një pozitë të veçantë te Ti?”

Ndërsa Allahu i Lartësuar e bëri halilin/mikun e Tij t’i përjetonte këto cilësi në gradën hakkal jakin. Nëse e shohim me kujdes metodën e përdorur në ajet, kërkesa e Ibrahimit ishte:

“Të shikonte se si ringjallte Allahu.” Përgjigja nuk ishte në formën:

“Shiko se si do të të vijnë kur t’i thërrasësh.”, por në formën:

“Ti thirri dhe (shihe) se si do të të vijnë.” Ibrahim i arriti atë gradë me bindjen e plotë shpirtërore dhe me cilësinë halilall-llah. Ai arriti shfaqjet hakkal jakin në esmatë e Zotit (xh.xh.).

“Detyrat tona nuk janë të njëanshme. Ato janë edhe të dukshme, edhe të padukshme... Edhe në thellësitë e jetës sonë individuale e shpirtërore, edhe në të gjitha fazat e jetës shoqërore e ekonomike...”

Muhjiddin ibn Arabiu thotë:

“Ibrahimi (a.s.), ishte “halilull-llah”, domethënë në miku i Allahut. Ndërmjet dy miqve duhet të shtohen cilësitë e përbashkëta, në mënyrë që miqësia të jetë e përsosur. Te Ai duhet të qëndrojnë cilësitë e madhësisë dhe prej kësaj nuk duhet të kalojë gjë te rob. Këto cilësi duhet të jenë të fshehta. Por prej thellësisë së këtyre cilësive duhet të përfitojë edhe miku i Zotit. Ndërsa cilësitë e mirësisë (mëshira, mirësia, falja, butësia, dhembshuria, mbulimi i gabimeve, etj.), duhet të jenë aktive. Këtu Allahu i Lartësuar e shfaqti cilësinë e Tij “muhji: ringjallësi i të vdekurve” në dorën e mikut të Vet, Ibrahimit (a.s.). Në këtë mënyrë e ngriti atë në “ajnel jakin” para se ta ngrinte në “ilmel jakin”. Pastaj e ngriti në gradën “hakkal jakin”. Në këtë formë u plotësua dije rreth emrave hyjnorë. Ibrahimit, alejhi’s-selam, iu dha një thellësi e veçantë kundrejt madhësisë hyjnore, rrymave të fuqisë dhe artit hyjnor. Falë kësaj thellësie arriti dhikrin e vërtetë dhe të qenët bashkë me Zotin shpirtërisht. Ai u lartësua në një gjendje gatishmërie që nuk e lejonte asnjë herë të harronte se në çdo momente Allahu ishte bashkë me të. I mori nën kontroll edhe mendimet që i vinin nga brenda duke e ndjerë Allahun më afër se damarët e qafës. Kështu arriti një devotshmëri deri në atë gradë sa që të mos i vinte në zemër qoftë edhe mendimi më i vogël prej të cilit nuk është i kënaqur Allahu Teala. Në këtë mënyrë arriti një pjekuri shpirtërore me anë të së cilës mund t’i flijonte me një sinqeritet të plotë në rrugë të Allahut pasurinë, jetën, fëmijët dhe çdo gjë tjetër që posedonte duke ardhur në gjendjen e nefsi mutmainne (nefsi i qetë), domethënë, nefsi që ka arritur bindjen e plotë kundrejt Allahut (xh.xh.), në kuptim të vërtetë të fjalës. Ai nuk e konsideroi të mjaftueshme edhe këtë sakrificë. Andaj e mbrojti veten kundrejt çdo lloj vështirësie që sjellin baticat-zbaticat e jetës dhe vazhdimisht jetoi në një gjendje që ishte i kënaqur prej Zotit. Në këtë gradë u shfaqën gjendjet radije dhe mardijje.”

“Kryerja e detyrës në njëherë anë të jetës kurrë

nuk do të thotë që ta neglizhojmë anën tjetër. Të gjitha si tërësi janë të domosdoshme dhe secila ka llogarinë e saj.”

Domethënë se në botën tonë të brendshme ka një mungesë të pafundme për prehje shpirtërore. Allahu i Lartësuar kërkon prej nesh nefs dhe zemër që kanë arritur bindjen e plotë dhe prehjen shpirtërore. Në ajetin fisnik thuhet:

“...dijeni se zemrat gjejnë prehje vetëm me përmendjen e Allahut.” (Ra’d, 28)

Miqësia me Allahun Teala nuk është si miqësia me një të përkohshëm. Miqësia me Zotin është përpjekja për të përvetësuar moralin që na ka dhënë Ai.

Itmi’nan do të thotë të bindesh plotësisht, të shpëtosh nga lëkundjet dhe të arrish prehjen. Andaj është e domosdoshme që ta arrijmë këtë prehje shpirtërore, në mënyrë që të bëjmë një adhurim të sinqertë dhe të shfaqim sakrifica të vërteta.

Dhikri që i qetëson zemrat është përmendja e shehadeetit dhe e emrave të bukur të Allahut të Madhëruar. Është leximi i Kuranit Fisnik duke ia dhënë hakun dhe duke e kuptuar.

Kjo realizohet me meditim mbi argumentet që na kujtojnë në Allahun (xh.sh.) dhe që na tregojnë njësimin e Tij. Në këtë mënyrë, zemrat gjejnë prehje duke meditar rreth fuqisë dhe madhësisë së pafundme të Tij.

Kur njeriu thotë me zemër “Allah!” dhe kur mediton fuqinë e madhëstisë e Tij të pafundme, të gjitha mendimet arrijnë pikën e fundit të fushës së funksionimit, logjikat boshe (llogaritë mentale) ndalojnë dhe të gjitha ndjenjat, të gjitha frikërat e të gjitha shpresat marrin një gjendje shpirtërore dhe arrijnë në fazën e fundit të tyre. Kështu zemrës nuk i mbetet mundësi që të orientohet në drejtime të tjera.

“Kur Habib en-Nexhxhari u martirizua nga populli i vet, nuk u ankua për gjendjen e tij. Për-

kundrazi tha: “...Ah, sikur ta dinte populli im, se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!””

Si shembull për këtë Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik jep magjistarët e Faraonit. Ndërkohë që ata po debatonin me Musanë, arritën një udhëzim dhe bindje të plotë shpirtërore me një reformim të befasishëm kundrejt mrekullisë që shfaqti ai dhe i besuan atij. Ata e dinin se kjo që bënë do ta zemëronte atë që i sundonte dhe udhëhiqte deri në atë moment, Faraonin. Por për shkak të bindjes së plotë që arritën, nuk ndjenë nevojën për t’i bërë llogaritë e kësaj dhe nuk hezituan aspak. Madje edhe kur Faraoni dha urdhër për t’i vrarë duke i kryqëzuar dhe duke ua prerë krahët e këmbët tërthorazi, ata nuk menduan asgjë tjetër

përveç mbrojtjes së gjendjes së bindjes së plotë dhe përsosmërisë së besimit që kishin arritur dhe iu lutën Zotit duke u shprehur:

“...O Zoti ynë! Na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!” (A’raf, 126)

“Kur po ekzekutoheshin me tortura magjistarët e Faraonit të cilët besuan, u lutën për të mos e humbur besimin: **“...O Zoti ynë! Na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!”** (A’raf, 126)”

Domethënë, asgjë nuk u erdhi në mendje përveç frikës dhe shqetësimit për ta dhënë frymën e fundit me besim. Madje nuk u erdhi në mendje

as për ta mallkuar Faraonin... Allahu Teala thotë në ajetin fisnik të mëposhtëm për ata që arrijnë në këtë gjendje:

“Ne do ta shkulim urrejtjen (smirën, paragjykimin dhe çdo gjë tjetër që u ngjan këtyre) **nga kraharori i tyre** (besimtarëve). **Te këmbët e tyre** (në xhenetin që do të hyjnë) **do të rrjedhin lumenj dhe ata do të thonë:**

“Qoftë lavdëruar Allahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte Allahu. Pa dyshim, të dërguarit e Zotit tonë kanë sjellë të vërtetën”.

Dhe një zë do t’i thërrasë:



“Ja, ky është Xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar (në dynja)!” (A’raf, 43)

Ky ajet është një shembull i bukur:

Kur Habib en-Nexhxhari u martirizua nga populli i vet, nuk u ankua për gjendjen e tij dhe nuk e mallkoi popullin e vet. Përkundrazi tha: “...Ah, sikur ta dinte populli im, se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar, në mënyrë që edhe ata të mos privoheshin nga mirësia e besimit. Ah sikur edhe ata të dëshironin me gjithë shpirt për ta dhënë jetën në rrugë të Allahut!”

Te nefsi “Mardijje”, që është një nefsi prej të cilit Allahu Teala është i kënaqur, cilësitë e këqija janë shkaktëruar dhe janë shfaqur cilësitë e bukura dhe etike. Ky nefsi ka arritur deri në atë gjendje sa që dashuria, butësia, mëshira, bujaria, **falja dhe ndjeshmëria kundrejt krijesave për hir të Krijuesit është një kënaqësi për të. Një besimtar në këtë gradë, e merr në llogari dhe nën kontroll nefsin e vet në formën më efikase.** Ky nefsi e mban nën kontroll egonin në çdo frymëmarrje dhe bën kujdes nga rënia në shkujdesje ndaj dredhëve të shejtanit. Ky nefsi gjithmonë ndjehet si një hiç/asgjë kundrejt madhështisë hyjnore, sepse Ibrahim (a.s.), Pejgamberi i lartë dhe mik i Zotit, gjithmonë shqetësohej për ditën e kiametit. Andaj lutej:

“O Zot! Mos më poshtëro ditën kur do t’i ringjallësh njerëzit!”

“Imam Gazaliu ishte mësuesi i 300 nxënësve. Edhe ai i kërkoi vetes llogari nëpërmjet ndërhyrjes: “Vallë, a po kërkoj kënaqësinë e Allahut, apo po kërkoj famë?” E dhuroi të gjithë pasurinë. Për një kohë u largua nga njerëzit dhe tha: “Më erdhën në ndihmë orientimet e Resulullahut. Kështu që gjeta prehje dhe shpëtovë.”

Edhe as’habu’l-uhdudi pranuan të hidheshin

nëpër gropat e zjarrit për të mos e humbur përsosmërinë e gjendjes së bindjes së plotë dhe prehjes shpirtërore që e arritën në besim.

Të krishterët e parë u përpoqën për ta mbrojtur besimin e tyre ndërmjet dhëmbëve të tigrave dhe luanëve nëpër vendet e shfaqjeve (arenave) të Romës.

Edhe muhaxhirët që ishin myslimanët e parë duruan çdo lloj torture dhe shfaqën çdo lloj sakrifice me shfaqjen e kësaj gjendjeje.

Babai i Xhabirit (r.a.), Abdullahu (r.a.), shkoi në Uhud për të rënë dëshmor sikur po shkonte në dasmë. Madje të birit i tha:

“Bir! Do desha shumë që edhe ti të merrje pjesë në luftë dhe të bije dëshmor, por pas ke motrat që kanë nevojë për mbrojtje. Më lejo që unë të bie dëshmor, ndërsa ti t’i mbrosh ato!”

“Ibrahim ibn Ed’hemi: “Po ta dinin mbretërit dhe të fuqishmit kënaqësinë (e besimit) që kemi ne dhe po të pandehnin se ajo është diçka konkrete, do të donin të na e merrnin atë kënaqësi duke përdorur fuqinë.”

Ja pra, entuziazmi i besimit dhe bindja e plotë e zemrës e inkurajojnë kështu njeriun për ta sakrifikuar pasurinë dhe jetën me plot dëshirë për hir të Allahut Teala.

Sa’d ibn Hejseme dhe babai i tij ditën e Bedrit hodhën short se kush do të shkonte në luftë.

Shorti i ra Sa’dit. Babai i tha:

“Bir i dashur! Ji altruist sot. Më jep përparësi mua, në mënyrë që të shkoj unë në luftë në vendin tënd.”

Sa’di (r.a.), i tha: “Do ta bëja atë që thua nëse në fund të kësaj do të kishte diçka tjetër përveç xhenetit.”

Së fundi Sa’di (r.a.), shkoi në Bedër dhe aty ra dëshmor. Edhe babai i tij, Hejseme (r.a.), ra dëshmor ditën e Uhudit.

“O Zot! Fali ata para meje, sepse ata po më gjuajnë me gur për hatrin Tënd. Ata nuk i dinë gjendjet që janë shfaqur prej meje. Po t’i dinin, nuk do të më gjuanin me gurë. Ata janë të pafajshëm ndërkohë që e bëjnë këtë. Prandaj fali ata para meje!”

Edhe “evlijauill-llah / evilatë e Allahut” që i kanë ndjekur ata me mirësi, kanë pasur gjendje të ngjashme me ato të atyre. Shembujt janë të shumtë për këtë. Qëllimi i atyre ishte kërkimi i bindjes së plotë shpirtërore dhe mbajtja nën kontroll e njetit dhe sinqeritetit.

Për shembull, Imam Gazaliu ishte mësuesi i 300 nxënësve. Edhe ai i kërkoi vetes llogari nëpërmjet ndërgjegjes:

“Vallë, a po kërkoj kënaqësinë e Allahut, apo po kërkoj famë?”

E dhuroi të gjithë pasurinë. Për një kohë u largua nga njerëzit dhe tha:

“Më erdhën në ndihmë orientimet e Resulullahut. Kështu që gjeta prehje dhe shpëtova.”

Hydaji edhe pse ishte kryegjykatës, u shqetësua për shkak të frikës prej mendjemadhësisë dhe mburrjes që mund t’ia shaktonte fama. Andaj filloi të shiste mëlçi nëpër rrugët e Bursës për t’i pastruar nga vetja këto ndjenja negative. Pas këtyre iniciativave të vështira shpirtërore arriti shfaqje të mëdha. Ai u bë shembull duke e orientuar umetin dhe sulltanët e mëdhenj që sundonin botën.

Ata ishin të kënaqur dhe të qetë edhe për të shfaqur durim ndaj vështirësive, edhe për të vepëruar me mëshirë ndaj krijesave:

Halaxh el-Mansuri lutej për ata që i gjuanin me gurë:

“O Zot! Fali ata para meje, sepse ata po më gjuajnë me gur për hatrin Tënd. Ata nuk i dinë gjendjet që janë shfaqur prej meje. Po t’i dinin, nuk do të më gjuanin me gurë. Ata janë të pafajshëm ndërkohë që e bëjnë këtë. Prandaj fali ata para meje!”

“Hydaji edhe pse ishte kryegjykatës, u shqetësua për shkak të frikës prej mendjemadhësisë dhe mburrjes që mund t’ia shaktonte fama. Andaj filloi të shiste mëlçi nëpër rrugët e Bursës për t’i pastruar nga vetja këto ndjenja negative.”

Ndërsa Ibrahim ibn Ed’hemi e shprehte si më poshtë këtë kënaqësi që i vinte nga kjo bindje e plotë e zemrës:

“Po ta dinin mbretërit dhe të fuqishmit kënaqësinë (e besimit) që kemi ne dhe po të pandehnin se ajo është diçka konkrete, do të donin të na e merrnin atë kënaqësi duke përdorur fuqinë.”

Ja pra, atyre që e arrijnë këtë pjekuri u drejtohet kjo fjalë hyjnore:

“O njeri që e ke arritur prehjen! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai i kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi (të zgjedhur) dhe hyr në Xhenetin Tim!” (Fexhr, 27)

“Hydaji pas këtyre iniciativave të vështira shpirtërore arriti shfaqje të mëdha. Ai u bë shembull duke e orientuar umetin dhe sulltanët e mëdhenj që sundonin botën.”

Arritja e zemrës së pastër dhe arritja e gradës së bindjes së plotë në zemër nuk realizohen vetëm me përpjekje individuale dhe me luftën që përjetohet në botën e brendshme. Rruga më e volitshme për të përfituar nga cilësitë e mirësisë së Zotit (xh.xh.) është që njeriu ta harxhojë të gjithë energjinë e tij për t’i kënaqur robërit e Allahut Teala. Ai duhet të fitojë ndjenjën për t’u kujdesur ndaj krijesave siç dëshiron Krijuesi. Ai duhet t’i marrë në krahët e dhembshurisë dhe mëshirës nënën dhe babanë, familjen, fqinj, të afërmit, vëllain në fe dhe të gjithë njerëzimin, madje të gjitha krijesat.

Allahu i Lartësuar kënaqet nga robi vetëm në këto pesë mënyra:

Sahabët e nderuar e arritën kënaqësinë e Zotit (xh.xh.) dhe pëlqimin e Pejgamberit duke jetuar me vëllazërinë ensarë-muhaxhirë, me garën në infak (dhurimit për hir të Zotit) dhe me vendosmërinë e entuziazmin për ta përhapur fjalën e Zotit në të katër anët e botës.

Përderisa të shtohen besimtarët e përsosur që kanë arritur bindjen e plotë shpirtërore me falënderim, lavdërim, dhikër dhe istigfar ndaj Zotit (xh.xh.) dhe përderisa të shpërthejë mëshirë nga shpirtrat e tyre, edhe shoqëria do të gjejë paqe dhe lumturi.

O Zot! Jepu zemrave tona ndjesi dhe frikërespekt! Na bëj udhëtarë të udhës së bindjes së plotë e të pafundme me njohjen dhe dashurinë ndaj Teje!

O Zot! Ndihmoje dhe mëshiroje umetin e Muhamedit, fale dhe përmirësoje umetin e Muhamedit! Na jep prej prehjes së pafundme, ja Rabbe’l-alemin!

Amin!..

MBI NATYRËN E VËRTETË TË LUMTURISË

— Shah Vali Allah El-Dehlevi —

Ti duhet ta dish se njeriu ka një përsosmëri nga forma specifike, dhe një përsosmëri nga pozita e llojit njerëzor, në terma të gjinisë së afërt dhe të largët. Lumturia (fundore), mungesa e së cilës është e dëmshme për njerëzit, dhe për të cilën njerëzit me arsye të shëndoshë përpiqen fort, është njëra prej këtyre dy përsosmërive.

Është kështu për shkak se një person zakonisht mund të çmohet për cilësi që ai i ka të njëjta me trupat minerarë, siç është gjatësia dhe lartësia e madhe, dhe në qoftë se “lumturia” (*se'ade*) do të përbëhej nga këto, atëherë vargmalet do të iëshin më të përmbushur në mirëqenie. Ose një person mund të çmohet për cilësi që ai i ka të njëjta me bimët, siç janë rritja e duhur dhe dukja me konture të bukura dhe trajta rrezatuese, kështu që nëse mirëqenia do të përbëhej nga këto, atëherë zambaku dhe trëndafili do të kishin një përsosmëri më të plotë. Ose një person mund të çmohet për cilësi që ai i ka të njëjta me kafshët, si forca e madhe, zëri i lartë, të qenit epsharak, të ngrënit dhe të pirit pa kufi, dhe të pasurit me bollëk të zemërimit dhe zilisë; dhe sikur lumturia të përbëhej nga këto gjëra, atëherë gomari do të kishte lumni më të plotë.

Veçoritë që janë karakteristike për njeriun, sikurse janë vrytytet e kultivuara, mbështetjet e shëndosha për qytetërim (*irtifakat*), aftësitë prodhuese/artizanale të larta, dhe pozita e lartë - menjëherë krijohet përshtypja se këto janë lumturia e mbrame e njerëzve. Kështu, ti do të shohësh se në çdo komb

të njerëzimit ata të cilët kanë përshquajtësi më të madhe, si dhe gjykim më të shëndoshë, dëshirojnë t'i shtiejnë ato në dorë; dhe se ata i cilësojnë sitribute jo të lëvdueshme gjërat që janë të ndryshme prej tyre. Mirëpo, problemi në fjalë sërish nuk është formuluar me saktësi, për shkak se baza e këtyre (cilësive të lëvdueshme) gjendet edhe në mesin e kafshëve individuale. Kështu, guximi bazohet mbi zemërimin, mbi dashurinë për hakmarrje, mbi palëkundshmërinë në fatkeqësi, dhe mbi përparimin në situata të rrezikshme, dhe të gjitha këto gjenden me tepri te shtazët e gjinisë mashkullore. Megjithatë, ai nuk quhet “guxim” deri sa rrezatimi i nefsit racional t'i rafinojë ato, kështu që ato të bëhen të udhëhequra nga qëllimi universal dobiprurës dhe të shfaqen në sajë të një motivimi të arsyetuar. Në mënyrë të ngjashme, baza për aftësitë prodhuese/artizanale të gjymtyrëve gjendet te kafshët, si trumcaku që ndërton foleza. Dhe përnjëmend, shumë gjëra që kafshët i bëjnë natyrshëm, njeriu nuk mund t'i bëjë as me mundimin më të madh. E vërteta, përkundrazi, është se kjo lumturi është e rastësishme, dhe se lumturia e vërtetë është udhëzimi i kafshërores nga fryma racionale, bindja e pasioneve ndaj arsyes, ku fryma racionale nënshtron kafshëroren, dhe arsyeja bëhet dominante mbi pasionet. Të gjitha karakteristikat e tjera janë të papërfillshme.

Ti duhet ta dish se çështjet që përfshihen në lumturinë e vërtetë ndahen në dy kategori.

1) Njëra kategori përfshihet nën temën e shfaqjes së rrezatimit të nefsit (frymë/vete) racionale në jetën e përditshme nëpërmjet dekretit të prirjes së lindur (*xhibbile*). Është e pamundur që virtyti i dëshiruar të përftohet nëpërmjet kësaj kategorie, por ndonjëherë një kredhje në këto akte mund të ndodhë për shkak të të qenit të tyre joshëse, sidomos nëpërmjet një koncepti fragmentar, si në rastin e personit të mangët; kjo në kundërdallim me përsosurinë e dëshiruar. Një shembull do të ishte personi i cili dëshiron të përftojë guxim nëpërmjet provokimit të zemërimit, konfliktit, dhe kështu me radhë; apo ai që dëshiron të përftojë gojëtarinë nëpërmjet njohjes së poezisë dhe oratorisë arabe. Virtytet (*akhlak*) shfaqen vetëm nëpërmjet kontaktit me pjesëtarë të tjerë të llojit, dhe mbështetjet për qytetërimin fabrikohen vetëm në kundërpërgjigje ndaj nevojave të rastit, dhe aftësitë prodhuese/artizanale të gjymtyrëve realizohen vetëm nëpërmjet veglave dhe materialeve; dhe të gjitha këtyre gjërave u vjen fundi me shuarjen e jetës së kësaj bote. Kësisoj, në qoftë se personi i mangët vdes në këtë konditë, duke qenë ai i urryer, ai mbetet pa përsosmëri. Në qoftë se imazhet e këtyre lidhjeve (dynjasore) kapen fort pas nefsit së tij, atëherë dëmi që i bëhet atij është më i madh se sa dobia.

2) Kategoria e dytë ka në shpirtin e saj pozitën e nënshtrimit nga ana e kafshërores ndaj forcës ëngjëlllore, kështu që e para sillet në përputhje me frymëzimin e ëngjëlllores dhe bojatiset nga ngjyresa e saj, ndërkohë që ëngjëllorja e pengon atë që të marrë ngjyrat e botës, dhe e pengon që mbi të të vulojnë shenjat e saj si shenja e unazës-vulë mbi dyll. Kjo nuk mund të ndodhë kurrsesi nëse ëngjëllorja (forca) nuk kërkon diçka nëpërmjet natyrës së saj thelbësore dhe nëse nuk dërgon te kafshërorja një frymëzim lidhur me të, dhe ia sugjeron këtë asaj, kështu që (nga ana tjetër) kafshërorja t'i bindet asaj dhe të mos rebelohet apo ta frenojë veten nga ajo. Kështu, ajo (ëngjëllorja) nuk resht së urdhëruari dhe kafshërorja (nuk resht) së binduri, dhe gjërat vijoje në këtë mënyrë derisa forca kafshërore bëhet e mësuar dhe stërvitet me këtë. Ato gjëra që ëngjëllorja i dekreton nëpërmjet natyrës së saj thelbësore, dhe që kafshërorja është e shtrënguar t'i bëjë pavarësisht nga ngurrimi i saj, janë të atij lloji që të parën e bëjnë të lumtur dhe të dytën të brengosur, siç është imitimi i Melekutit dhe përpjekja për Xheberutin, sepse ato janë një veçanësi e ëngjëlllores, dhe kafshërorja është në distancën më të largët prej tyre. Ose (kjo vazhdon derisa) braktiset çfarëdolloj gjëje që kafshërorja dekreton, që gjen kënaqësi në të, dhe që ka neaps për të në teprimet e saj.

Kjo kategori e dytë quhet aktet e adhurimit dhe ushtrimeve fetare, dhe këto marrin pjesë në përfitim të virtyteve të dëshiruara të cilat mungojnë. Hulumentimi i kësaj pike kthehet në faktin se lumturia e vërtetë nuk ngërthehet përveçse nëpërmjet akteve të adhurimit. Si rrjedhojë, qëllimi universal e dobiprurës u bën thirrje individëve njerëzorë nga kamarja e formës specifike dhe i urdhëron ata këmbëngulurazi që të kryejnë përmirësimin e cilësive që janë një përsosmëri e dytë për të, në masën në të cilin ato janë të nevojshme. Ai po ashtu i urdhëron njerëzit që qëllim fundor të vëmendjes së tyre të përqendruar dhe shënjestër të vështirimeve të tyre të bëjnë rafinimin e nefsit, dhe stolisjen e saj me qëndrime që e bëjnë atë t'i përngajë asaj çka është sipër saj në gjirin e Kuvendit më të Naltë, dhe ta përgatisë atë për shpalljen e realiteteve të Xheberutit dhe Melekutit. (E urdhëron atë) që kafshëroren ta bëjë të nënshtruar ndaj ëngjëlllores, si dhe të bindur ndaj saj, dhe ta bëjnë atë një vitrinë për manifestimin e urdhërave të saj.

Kur individët njerëzorë janë të shëndetshëm në përputhje me llojin e tyre, dhe lënda e tyre është në gjendje që të manifestojë cilësitë e llojit, krejtësisht dhe plotësisht, ata e gjakojnë me zjarr këtë lumturi (fundore) dhe tërhiqen prej saj siç tërhiqet hekuri nga magneti. Ky është karakteri i lindur (*khalk*) sipas të cilit Zoti, qoftë Ai i Lartësuar, krijoi njeriun, dhe natyra fillestare, në përputhje me të cilën Ai, qoftë i Lartësuar, i strukturoi njerëzit. Rrjedhimisht, nuk ka pasur asnjë komb në gjirin e njerëzimit që të ketë zotëruar temperamente të ekuilibruara dhe që në gjirin e tij të mos ketë një grup të njerëzve të mëdhenj të cilët u japin rëndësi përsosmërisë së këtij karakteri të lindur dhe e cilësojnë atë si lumturia e mbrame. Mbretërit dhe burrat e mencur, dhe ata poshtë tyre, i shohin ata sikur kanë arritur atë çka është e lartësuar përmbi të gjitha lumturitë e kësaj bote, dhe se atyre u janë bashkuar ëngjëjt dhe iu janë bashkuar rrethet e tyre kështu që ata (këta njerëz, pra) kërkojnë bekimin e tyre dhe u puthin atyre duar e këmbë. Pra, si mund të ndodhë vallë që arabët dhe jo-arabët, megjithë dallimet e tyre në zakone dhe fe dhe në distanca ndërmjet qyteteve e trojeve të tyre, të pajtohen në një gjë me një unitet të llojit - përpos për shkak të afinitetit të natyrës fillestare? E si mund të mos ishte kështu, kur ti ke pranuar se forca ëngjëlllore është e pranishme në natyrën themeltare fillestare njerëzore, dhe kur ti ke pranuar njerëzit sipërorë dhe ata më të mëdhenjtë ndër ta, dhe Zoti e di më së miri.



STRESI DO TË JETË GJITHMONË AI QË E PËRBALLON DO TË FITOJË

— Doç. dr. Fërat Erdoan —

Stresi është një koncept i keqkuptuar që ka hyrë në bisedat tona të përditshme, veçanërisht në dy dekadat e fundit.

Në fakt situata që krijon tension në organizëm dhe i bën presion trupit quhet stres. Situata që ndodh kur shkak i stresit nuk mund të përballohet është ankthi ose shqetësimi.

Situatat stresuese mund të jenë me origjinë fizike ose psikologjike. Çështja e sotme është stresi më i dukshëm dhe më e rëndësishmja reagimi i trupit ndaj tij.

Më i thjeshti, keni një thua që ju ka hyrë në këmbë. Kur shkoni në punë, ju duhet të vishni këpucë zyrtare, por, pas pak kohe filloni të ndjeni dhimbje. Mbledhja zgjatet dhe dhimbja sa vjen e shtohet. Stresi bëhet shkak për shqetësim dhe vështirësi. Më në fund thoni «mjaf!», nuk mund ta shpjegoni plotësisht problemin tuaj dhe largoheni nga mbledhja pa marrë atë që dëshironit.

Faktori që ushtronte presion... Luftuat për një kohë... Nuk duruat dot presionin fizik dhe/psikologjik... Dhe u larguat nga mejdani... Humbët.

E kemi thjeshtuar shumë, por kështu është çështja. Stresi është gjithmonë aty, ama fitojnë ata që mund ta përballojnë.

Zhurma nga fqinjët gjithashtu shkakton stres, edhe operacioni në zemër gjithashtu...

Le të supozojmë se shkak i stresit është një aksident trafiku.

Rajoni blu më në majtë; Periudha kur gjërat ecin mirë ngaqë jemi në ekuilibër.

Në atë moment keni pasur një aksident trafiku. Goditja ishte shumë e fuqishme, mekanizmat tuaja të adaptimit nuk janë të mjaftueshme dhe të shpejta dhe nëse nuk mund të merrni mbështetje (ilaçe etj.) nga jashtë, kjo situatë mund t'ju çojë drejt vdekjes. Përveç kësaj, mekanizmat e përshtatjes hyjnë në funksion në streset e përditshme.

Kemi ardhur në pjesën e dytë të fushës së blertë. Këtu hyn në lojë sistemi autonom. Çfarë do të thotë sistem autonom?

Është një sistem nervor paralel i vendosur në mënyrë që të mos humbim kohë duke i bërë trurit pyetje dhe duke pritur një përgjigje, por që të përgjigjemi menjëherë në situata të tilla jetike.

«Sistemi nervor simpatik» i sistemit autonom aktivizohet dhe «adrenalina» sekretohet nga gjëndra mbiveshkore. Përgjigja «luftoni ose ikni» zhvillohet në trup. Organi ekzekutiv është gjëndra mbiveshkore.

Veshkat dihen, të gjithë i njohin pak a shumë, por është edhe një organ që është i artikuluar mbi ta, pa një emër të veçantë për të... Po t'i bashkosh, nuk peshojnë as 10 gramë. Por në vijën jetë-vdekje,

manifestimi i fatit është në duart e tyre. Me efektin e adrenalines rrisin punën e të gjitha organeve vitale dhe prodhimin e energjisë.

Një ndryshim i përgjigjes së adrenalines është se ajo fillon shumë shpejt dhe efekti i saj është shumë jetëshkurtër. Sasia e adrenalines përgjysmohet çdo 10 sekonda. Kjo është një tjetër mirësi, përndryshe rritja e vazhdueshme e sheqerit apo presionit të gjakut do të kishte vrarë spontanisht të plagosurin që i mbijetoi aksidentit të trafikut.

Nëse shkak i stresit është një prerje e thjeshtë nga një thikë frutash në shtëpi, ngjarja zgjidhet me ndërhyrjen e shpejtë të adrenalines. Kur shkak është aksidenti i trafikut dhe nëse çështja do të zgjatet, fillon reagimi i zgjatur ndaj stresit. Lajmet shkojnë deri në qendrat e nivelit më të lartë në tru. Në skenë del protagonist i tjetër, që është hormoni kortizon.

Për disa arsye, kortizoni, i cili i frikëson njerëzit kur futet në një ilaç, është në fakt një hormon shpëtimtar i prodhuar nga vetë trupi.

Me përgjigjen që fillon brenda 30 minutave, niveli i kortizonit në gjak rritet 20 herë dhe kapacitetet e trurit, mëlçisë dhe zembrës rriten në nivelin maksimal.

Le të lëvizim në zonën më të djathtë (pjesa rozë) në grafik.

Nëse i jepet përgjigja e nevojshme lëndimit, frakturës, gjakderdhjes etj., dhe ofrohet mbështetja e duhur mjekësore, kurba në grafik tenton të normalizohet dhe vendoset një gjendje ekuilibri si në fillim.

Ndonjëherë kur shkak i stresit bëhet kronik ose përgjigja e trupit është e pamjaftueshme, ndodh pamjaftueshmëria dhe rraskapitja. Kjo zakonisht nënkupton shfaqjen e një tabloje të sëmundjes. Në rastin më të thjeshtë, damarët e veshkave të organizmit, të cilët duhet të përballojnë vazhdimisht tensionin e lartë, dëmtohen dhe njeriu bëhet pacient me dializë.

Deri këtu kemi folur gjithmonë për stresin fizik dhe pasojat e tij. Këto reagime vazhdojnë si mirësi e Zotit tonë, pavarësisht nëse jemi të vetëdijshëm apo jo. Arsyeja jonë për të shkruar është qëllimi për t'u bërë një burim mirënjohjeje ndaj Zotit (xh. xh.). A keni menduar ndonjëherë të falënderoni osteocitet tona, të cilat riparojnë kockën e thyer në krahun tonë, dhe gjëdrën mbiveshkore, burimin e adrenalines, që na shpëton jetën (!) duke tkurrur enët në gishtin të prerë dhe të gjakosur?..

Ka edhe strese psikologjike.

Presioni nga mbikëqyrësi ynë në punë, moskuptimi nga shokët në shkollë dhe pamundësia për të kënaqur anëtarët e familjes, krijojnë tension në shpirtin tonë. Çrregullimet e gjumit shkaktojnë nervozizëm dhe ankth. Efikasiteti bie. A nuk na ndodh të gjithëve, nëse jemi nervozë ose të shqetësuar për ndonjë arsye, nuk mund t'i përgjigjemi pyetjes që dimë, funksionet e kujtesës dobësohen.

Kemi pleq që u rritet presioni i gjakut kur shohin lajmet e koronavirusit deri në mbrëmje.

Shoferi i minibusit, i cili është i mbingarkuar, në një moment të caktuar të trafikut bën shpejtësi të pakuptimtë dhe shkakton një aksident. Le ta lëmë këtë temë, e cila mund të plotësojë një artikull më vete, për numrin tjetër.

Megjithëse shkaqet dhe ndërmjetësit janë të ndryshëm, pika kryesore e përbashkët në stresin fizik dhe psikologjik është: Nëse nuk mund të shmanget dhe nëse nuk mund të trajtohet siç duhet, konsumimi fillon në trup dhe ndonjëherë marrim fund me të vërtetë (rraskapitemi).

Pas kaq informacioneve të përgjithshme, a të japim mesazhin pozitiv të artikullit tonë?

Shpesh nuk është e mundur të shmangësh faktorët që shkaktojnë stresin. Vetë jeta në fakt është shkak i stresit. Si mund ta përballojmë këtë stres, si mund ta ndryshojmë drejtimin e grafikut në tabelën lart dhe ta mbajmë tabelën të gjelbër?

Për t'u mbrojtur nga stresi fizik ka rreth një mijë rekomandime, ato gjenden kudo.

Në të njëjtën mënyrë mund të mbrohem edhe nga stresi psikologjik...

Të mos ju marrim kohën me këshilla të tilla si të pini shumë ujë, të merrni frymë thellë, të pini vaj peshku dhe «të përdorni fjalën ti në vend të fjalës unë».

Le të vendosim kapelën përpara dhe të mendojmë se ku gabuam?

Pavarësisht se sa të zgjuar janë të tjerët, ata nuk janë aq të zgjuar sa ju për punën tuaj.

Meqenëse nuk ka një botë të rehatshme dhe nuk do të ketë një ditë pa stres, le t'i vlerësojmë dhe të jemi mirënjohës për ditët tona të mira. Le të marrim masat e të besojmë dhe kur të vijë koha të bëjmë durim. Kështu shpresoj të fitojmë në të gjitha kushtet, inshallah.

Zoti ynë, thesari i të Cilit është i madh, na dhuroftë ditë pa stres!



DËSHMORËT NUK VDESIN

— Osman Ersan —

Shehid / dëshmor quhet myslimani i cili vritet prej armikut gjatë luftës në rrugë të Allahut Teala. Rënia dëshmor, edhe pse i vjen shumë rëndë nefsit, është kalim në një botë të përhershme dhe të lumtur. Dëshmorët shkojnë në jetën e përhershme duke flijuar për hir të Allahut gjënë më të vlefshme që kanë, pra jetën e tyre.

Rënia dëshmor është një gradë shumë sublime dhe e nderuar sipas fesë sonë. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni!”** (Bakara, 154)

Dëshmorët jetojnë te Allahu Teala dhe furnizohen me mirësi shpirtërore në pozita të larta të specifikuar për ta. Në ajetin fisnik thuhet:

“Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas). Ata gëzohen me dhuntitë dhe mirësinë e Allahut, sepse Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve.” (Al Imran, 169-171)

Edhe në hadithin fisnik thuhet:

“Shpirtat e dëshmorëve janë brenda zogjve të gjelbër. Ata pinë nga lumenjtë dhe hanë nga frutat e xhenetit. Ata lëvizin lirisht në xhenet. Strehohen te kandilat prej floriri që ndodhen nën Arsh. Kur të shohin se sa të bukura janë ushqimet, vendbanimet dhe pijet e tyre, thonë kështu, në mënyrë që edhe vëllezërit e tyre ta admirojnë xhihadin:

“Ah sikur populli ynë ta dinte se çfarë mirësish na ka dhënë Allahu!”

Allahu Teala u thotë dëshmorëve: *“Unë do t’i njoftoj ata në vendin tuaj për gjendjen në të cilën ndodhni. Në këtë mënyrë, ata do të gëzohen për këtë përgëzim dhe do të jenë të lumtur.”* Pastaj zbrit këtë ajet fisnik.” (Ajetin e mësipërm. Shënim i përkth.) (Muslim, Imare, 121.)

Ata që luftojnë në rrugë të Allahut Teala, do të kenë gradën më të lartë në xhenet. Në hadithin fisnik, thuhet:

“Allahu Teala ka përgatitur njëqind grada në xhenet për ata që luftojnë në rrugë të tij. Largësia e një grade nga grada tjetër është sa largësia e tokës me qiellin.” (Buhari, Xhihad, 4.)

Grada e rënies dëshmor është njëra prej gradave më të larta në xhenet. Kur dëshmori ta shikojë këtë,

do dëshirojë të kthehet përsëri në këtë botë, në mënyrë që të bjerë dëshmor sa më shumë herë që të jetë e mundur. Në hadithin fisnik thuhet:

“Çdo njeri që do hyjë në xhenet, nuk do dëshirojë të kthehet pas në këtë botë, edhe sikur çdo gjë e kësaj botë të ketë qenë e tij. Përveç dëshmorit, sepse kur të shikojë vlerësimin dhe nderimin e madh që do t’i bëhet, do të dëshirojë të kthehet përsëri në këtë botë dhe të bjerë dhjetë herë dëshmor.” (Buhari, Xhihad, 21.)

Xhiahadi në rrugë të Allahut Teala është prej ibadeteve më të virtytshme. Ebu Hurejra, (r.a.), transmeton:

“Të Dërguarin e Allahut, (a.s.), e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Cila vepër është e barabartë me xhiahadin në rrugë të Allahut?” Ai u përgjigj:

“Asnjë vepër nuk është e barabartë me atë.” Të njëjtën pyetje ia përsëritën dy ose tri herë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), në çdo herë dha këtë përgjigje: *“Asnjë vepër nuk është e barabartë me atë.”*

Xhenazet e atyre që bien dëshmorë gjatë luftës në rrugë të Allahut Teala, varrosen pa u larë dhe me rrobat e gjakosura që kanë. Kjo konsiderohet si një shenjë se ata janë të pastër.

Dëshmorët do të vijnë në vendin e mahsherit / tubimit në Ditën e Gjykimit duke u rrjedhur gjaku si në ditën kur kanë rënë dëshmor apo janë plagosur. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë në një hadith fisnik:

“Ai që plagoset në rrugë të Allahut, Ditën e Gjykimit do të dalë në audiencën e Allahut Teala duke u rrjedhur gjak nga plaga e tij. Gjaku do të ketë ngjyrën e vet, ndërsa era do të jetë erë misku.” (Buhari, Xhihad, 10.)

Allahu Teala ua lehtëson dëshmorëve dhimbjet dhe vuajtjet e vdekjes. Kjo e vërtetë shpjegohet kështu në hadithin fisnik:

“Aq sa ndjen dhimbje ndonjëri prej jush kur e pikon milingona, aq dhimbjen ndjen nga vdekja edhe ai që bie dëshmor.” (Muslim, Imare, 156.)

Dëshmorëve u falen të gjitha mëkatet, përveç borxheve që mund t’u kenë njerëzve. Edhe këto borxhe, Allahu Teala do t’ua falë në Ditën e Kiametit pasi të zotëve të borxheve t’u japë prej mirësive të xhenetit dhe ata t’ua bëjnë hallall (dëshmorëve).

Mirësitë që fitojnë dëshmorët janë të pafundme. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Kur dëshmori të vritet, ndjen dhimbje nga vdekja aq sa ndjen dhimbje ndonjëri prej jush kur përkohet. Dëshmori ka shtatë cilësi: Falet që në pikën e parë të gjakut që i rrjedh. E shikon vendin e tij në xhenet. Shpëton nga ndëshkimi i varrit. Është i sigurt prej frikës më të madhe (frika prej kiametit). Në kokë i vendoset një kurorë aq e mrekullueshme, saqë një rubin i vetëm i kësaj kurore është më i vlefshëm se dynjaja dhe nga çdo gjë e dynjasë. Ai martohet më shtatëdhjetë e tri gra prej hyrive. I jepet leje të ndërmjetësojë për shtatëdhjetë vetë prej të afërmeve të tij.” (Tirmidhi, Fedailu’l-Xhihad, 26.)

Grada e dëshmorëve është grada e tretë, e cila vjen pas asaj të pejgamberëve dhe të sinqertëve. Në ajetin fisnik shprehet kështu:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69)

Në fenë tonë, qëllimi dhe sinqeriteti janë të vlefshëm po aq sa vetë veprat. Ata që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në luftë për hir të Allahut të Lartësuar, këtë qëllim duhet ta mbartin në zemrat e tyre, sepse në hadithin fisnik thuhet:

“Atë që dëshiron me gjithë zemër të bjerë dëshmor, Allahu do ta lartësojë në gradën e dëshmorëve edhe nëse vdes në shtratin e tij.” (Muslim, Imare, 157.)

Edhe në një hadith tjetër fisnik thuhet:

“Kushdo që ndërron jete pa luftuar dhe pa mbartur në zemër dëshirën për të luftuar, ndërron jetë mbi një lloj hipokrizie.” (Muslim, Imare, 158.)

Ata që vriten në rrugë të Allahut Teala, janë dy llojesh: Lloji i parë janë ata që vriten në luftën e vogël duke e flijuar jetën e tyre me qëllim që të arrijnë pëlqimin e Allahut. Ndërsa lloji i dytë janë ata që vriten në luftë të madhe duke e shkatërruar nefsin me shpatën e dashurisë ndaj Allahut. Ky lloj është më i lartë se lloji i parë. Të gjithë ata që vriten në këto dy luftëra jetojnë në një formë jete të vërtetë të Zoti i tyre. Ata furnizohen në xhenet me mirësi shpirtërore. (Mahmud Sami Ramazanogllu, Uhd Gazvesi, fq. 105.)

Dëshira e vetme që i ka bërë myslimanët shekull pas shekulli të vrapojnë nga një front në një front tjetër dhe nga një fitore në një fitore tjetër, gjithmonë ka qenë ky besim dhe entuziazëm.

VETËLLOGARIA SOCIALE

PËRSE JEMI NË KËTË GJENDJE

— Sami Byjkkajnak —

Popujt myslimanë po përjetojnë një përçarje të madhe. Nën një rrethim madhështor shekullarist, pothuajse po lajnë hesapet me fenë e tyre. Zemra bëhet copë-copë kur vihet re se myslimanët janë pala që humb në këtë larje hesapesh. Ndërkohë që myslimanët nuk duhet të ishin pala që humbet.

Përse kanë humbur myslimanët?

Përgjigja e kësaj pyetjeje është kjo:

Vjetërsimi i pjekurisë së përfaqësimit...

Pasi myslimanët u larguan nga pjekuria e përfaqësimit, arritën në një gjendje saqë humbën edhe fenë e tyre, sepse, nëse te popujt që njihen si myslimanë ka probleme të ndarjes sociale dhe si rezultat i kësaj ka vëllezër që shtypen, nëse i pasuri është tepër i pasur dhe i varfri është tepër i varfër, nëse morali merret nëpër këmbë dhe njerëzit nuk janë të sigurt nga njëri-tjetri, nëse faqet e treta të gazetave, të cilat japin lajmet e tragjedi-ve sociale, janë të mbushura me lajme që zemra nuk i përballon dhe mendja e ka të vështirë për t'i pranuar, nëse njerëzit janë hipokritë, domethënë, e brendshmjia e tyre nuk përputhet me të jashtmen e tyre, nëse ata që pohojnë se punojnë për Islamin nuk janë të sigurt nga njëri-tjetri, nëse familjet janë të ndara nga njëra-tjetra dhe individët nuk mund ta ndajnë të njëjtën jetë etj., do të

thotë se është humbur profili i myslimanit që është formuar në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Do të thotë se pjekuria e përfaqësimit është çuar dëm.

Mirë, por si kemi ardhur në këtë pikë?

Në këtë pikë kemi ardhur kur fenë tonë ua kemi dorëzuar jomyslimanëve...

Po, kaq e qartë është përgjigja e kësaj pyetjeje!

Koha kur myslimanët hynë nën administrimin e jomyslimanëve, është koha kur feja e tyre është ekzekutuar. Është koha kur nacionalizmi kaloi para bashkimit të umetit. Është koha kur myslimanët janë individualizuar dhe ndarë në xhемate. Është koha kur myslimanët janë dhënë pas kësaj bote dhe e kanë harruar botën tjetër. Është koha kur është ekzekutuar Islami.

Synimi i këtij ndryshimi historik, faktikisht ishte ky:

Myslimanizmi le të ngelet si një emër paraprak, kjo është e mjaftueshme. Ndërsa përmbajtja, përshtirshmëria, veprat dhe ndëshkimet ligjore lërinë në një anë...

Ja, kjo është koha kur jemi shkatërruar. Kjo është koha kur janë nëpërkëmbur vlerat. Kjo është koha kur pjekuria e përfaqësimit të myslimanizmit ka rënë përtokë. Kjo është koha kur myslimanët janë përçarë dhe po mbyten në dallgët e kësaj përçarjeje.

Mirë, po përse myslimanët e toleruan këtë projekt të ndryshimit të historisë?

Myslimanët e ngrinë trashëgiminë e tyre. Një fe plot aksion dhe dinamizëm në jetë si Islami, e sollën në gjendje të palëvizshme dhe statike. Shembujt më të bukur në trashëgiminë historike i ngrinë dhe i panë si vepra historike. Si rezultat, një sëmundje që e shfaq fenë islame sikur ajo të mos kishte një

vizion si studimin, zhvillimin dhe përparimin, e ka rrethuar organizmin nga të gjitha anët. Në vend që myslimanët ta mjekonin vetë këtë sëmundje, ia dorëzuan mjekëve jomyslimanë. Ndërsa mjekët jomyslimanë, në vend që ta mjekonin këtë sëmundje, bënë çdo gjë që kishin mundësi, në mënyrë që kjo sëmundje të mos shërohej asnjëherë. Për shkak të kësaj, myslimanizmi i lënë në duart e mjekëve jomyslimanë, erdhi në ditët e sotshme në këtë gjendje që e shohim të gjithë.

Jomyslimanët u sollën përpara myslimanëve projekte që i joshin epsheet e pasionet dhe që e tërbojnë nefsën. Myslimani i sotëm, që ka ngelur ndërmjet nefsit dhe myslimanizmit, nuk heq dorë as nga nefsia dhe as nga myslimanizmi. Në këtë mënyrë, në pah del një myslimanizëm që lë shumë për të dëshiruar.

Myslmanizmi i sotëm është një myslimanizëm i shndërruar në një gjendje të mjeruar.

Pak ibadet, pak vepra dhe pak besim...

Përderisa gjendja të vazhdojë me këtë ecuri, për brezat e mbërthyer ndërmjet vetes dhe myslimanizmit dhe që po rriten me teknologjinë e re, do të jetë shumë e vështirë arritja e një përmirësimi me frymë islame, i cili mund t'ua shërojë zemrat.

A mund të dalë në pah një brez i fortë mysliman nga një lojë, programin e së cilës nuk e keni bërë ju, nga një film që skenarin nuk ia keni shkruar ju dhe nga një sistem jete të cilin nuk e keni formuar ju?

Kësaj pyetjeje nuk mund t'i jepet përgjigja "po". Nën këtë lloj rrethimi, për shembull, në një ambient në të cilin vazhdimisht njerëzit flirtojnë me njëri-tjetrin dhe në të cilin flirtimi tregohet si joshës, nuk mund ta shpjegoni se përzierja e vajzave me djemtë nuk është e lejuar. Madje, mund të shikoni edhe djem të rinj që i njihni për fetarë duke ndarë të njëjtin mjedis me vajzat dhe duke u argëtuar me to.

Madje, është e vështirë të gjeni një djalë të ri fetar që nuk ka të dashur. Madje, mund të përballeni edhe me një përgjigje vetëmbrojtëse dhe të palogjikshme si: "Çfarë të keqeje ka? Po bisedojmë për Islam!"

Ju u thoni: "Meqë keni për të bërë mbledhje apo shëtitje, i organizoni burrat veçmas dhe gratë veçmas." Ata menjëherë u kthejnë këtë përgjigje:

"Në cilin shekull ke ngelur?" Edhe një herë duhet ta nënvizojmë se ata që japin këtë përgjigje janë të rinjtë që pohojnë se janë myslimanë dhe fetarë.

Të moshuarve me abdest, namaz dhe mjekër u thoni:

"Mos bashkëpunoni me bankat që japin kredi

me kamatë. Ka edhe institucione alternativë. Ka institucione që thonë se bashkëpunojnë pa kamatë. Prandaj shkoni te ata!" Por ata e bëjnë të ligjshëm bashkëpunimin me ata që japin kredi me kamatë duke thënë:

"Edhe ajo është bankë edhe kjo është bankë. Çfarë ndryshimi ka?"

Edhe këta dy shembuj të thjeshtë mjaftojnë për ta shtruar para syve se në ç'gjendje të keqe është lëshuar myslimanizmi...

Imazh

Myslmanët janë shumë të qetë... Zoti na ruajtë, por po përjetohet një ambient "rehatie" që myslimanit shqetësohet për të zgjedhur anën e besimit, kur Allahu e sprovon me besimin. Nëse mund ta shprehim kështu, nuk ia di vlerën besimit. Për këtë arsye, sundon mendimi "ç'më duhet mua?" Të thuash se e ardhmja do të jetë e mirë në një periudhë kohe kur po i humbim dhe po i çojmë dëm mirësitë tona, është një lloj mashtrimi i vetvetes. Për këtë arsye, duhet t'i rikthehemi besimit. Allahu Teala ka bërë një thirrje për ata që besojnë. Kur ta lexojmë këtë thirrje, duhet të pyesin: "Përse po na thërret Allahu?" Në këto ditët e sotme, kjo ftesë apo ky urdhër ka një kuptim të madh. Allahu i Lartësuar i fton ata që kanë besuar për të besuar:

"O ju që keni besuar! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë."
(Nisa, 136)

Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), kërkon ta rinovojmë besimin. (Ahmed b. Hanbel, Musned, 2/359.)

Domethënë se kur myslimani është në gjendje të vështirë, ka ardhur koha për ta rinovuar besimin e tij. Edhe kjo periudhë kohe në të cilën po jetojmë, është njëra prej këtyre kohëve të tilla. Nisur nga kjo, ne duhet ta rinovojmë besimin tonë dhe ta kontrollojmë. Ne duhet ta kontrollojmë besimin që kemi ndaj Allahut (xh.sh.), besimin që kemi ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe besimin që kemi ndaj Kuranit Fisnik. Ne duhet t'i sjellim në rendin e ditës vlerat prej të cilave jemi larguar, që i kemi humbur dhe që ua kemi humbur të tjerëve dhe të përpiqemi e të luftojmë për t'u shkruar te Zoti prej "garibëve", të cilët i ka përgëzuar i Dërguari i Allahut (a.s.).

"Përgëzime për "garibët"! Ata janë njerëz të cilët i rregullojnë gjërat që i prishin njerëzit e tjerë." (Ahmed b. Hanbel, Musned, 4/73.)



LLOGARIA E NAMAZIT

— Xhafer Durmush —

Si thoni, nëse një ditë uleni dhe flisni përsëri rreth namazit?.. Të mendoni rreth marrëdhënies suaj me namazin si shtyllën më të rëndësishme të Islamit pas Formulës së Teuhidit...

Për shembull, kur e vendosim dorën mbi fisnikërinë e ujit, a e ndjejmë entuziazmin e përgatitjes së shpirtit bashkë me gjymtyrët e tjera që marrin abdest? Sa jemi të vetëdijshëm për faktin se qëndrimi në audiencën hyjnore me një adhurim gjithëpërfshirës si namazi, është një sukses dhe fat i madh? A jemi të vetëdijshëm për urtësinë e namazit, i cili na tërheq dhe na nxjerr nga angazhimi me punët e kësaj bote në mënyrë periodike dhe të shpeshtë?

Kur qëndrojmë (në namaz), sikur e kemi Qabënë madhështore përballë dhe jemi duke lexuar ajetet e Kuranit, a e ndjejmë se jemi duke bashkëbiseduar me Allahun? Çfarë bëjmë që pesë vaktet e namazit, të cilat i falim përditë të mos na kthehen në rutinë?

A përipiqemi t'i zbukurojmë më tepër me namaz ditët dhe netët duke përjetuar miraxhin thellë brenda vetes... Dhe që për arsye të ndryshme t'i bëjmë pjesë të jetës sonë namazet vullnetare? Çfarë vendi zë në jetën tonë ky adhurim, i cili përkufizohet si "shtylla e fesë"? A ka çaste kur na merr malli për namazin dhe shkojmë në sexhde të mallëngjyer?

Në Kuran, namazi përmendet si "element i bashkimit të besimtarëve në një vend" (shih. el-Haxh, 41.) Gjithashtu, besimtarët këshillohen ta falin namazin të përqendruar dhe me frikë-respekt ndaj Allahut Teala. (el-Muminun, 2.)

I Dërguari i Allahut (s.a.u.s.), e urdhëron më parë njeriun e udhëzuar me islam me faljen e pesë namazeve. Më vonë, faljen e rregullt të namazeve

vullnetare në kohë të caktuara të ditës, e tregon si një qëllim të lartë i cili duhet arritur. Ai na mëson që, pothuajse të gjitha gjendjet e ndryshme njerëzore si frikën, shpresën, gëzimin, hidhërimin, etj., t'i përballojmë me namaz. Dhe ç'është më e rëndësishmja, ai e vendos namazin në qendër të jetës së myslimanit dhe urdhëron që të tregojmë kujdes ndaj namazit edhe në frymën e fundit, sepse kërkon që ne të kuptojmë se namazi është një mekanizëm kontrolli i vazhdueshëm, i cili e mban njeriun brenda kufijve të islamit. Ai kërkon që ne të kuptojmë, se namazi disiplinon mënyrën e veshjes, ngrënies e pirjes, madje edhe mënyrën e mendimit të një myslimani. Ai dëshiron që ne të kuptojmë se namazi është siguria dhe paqja e jetës individuale dhe sociale.

Në një hadith fisnik Profeti (a.s.), thotë: *"Allahu e ndihmon këtë popull për shkak të duave, namazeve dhe sinqeritetit të të dobëtve."* (Nesai, Xhihad, 43.) Me këto fjalë, Ai kërkon që ne të kuptojmë se namazet dhe duatë tona do ta tërheqin mbi ne mëshirën hyjnore... Po ne, çfarë familjariteti kemi me namazin që ka treguar Profeti ynë (a.s.)?

Në Kuranin Kerim shohim se namazi ka qenë urdhëruar edhe për profetët e mëparshëm. (shih. Bekare, 83; Junus, 87; Hud, 87; Ibrahim, 37.) Dhe kjo tregon se namazi ka një funksion të rëndësishëm në përbalimin e vështirësive. Atëherë, sa të vetëdijshëm jemi në lidhje me mënyrën e kërkimit të ndihmës, në përputhje me ajetin: **"O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten me durim dhe namaz!.."** (el-Bekare, 153.)

Sa e kemi mësuar neftin tonë të përballojë me namaz çdo gjë që na gëzon apo na hidhëron? Sa

kemi mësuar që me anë të namazit më parë t'i drejtojmë mendimet tona dhe t'ia paraqesim qëllimet tona kënaqësisë hyjnore?

Nëse mësohemi t'i peshojmë në mënyrë të shpesh-të veprimet tona në peshoren e namazit, patjetër që ai (namazi) do të na pastrojë, sepse ashtu siç bëhet shkak për pastrimin fizik, bëhet shkak edhe për shpëtimin e të zotit nga batakuri gjynaheve. (shih. el-Ankebut, 45.) Në një hadith fisnik, Profeti ynë (a.s.), na ka dhënë myzhdënë, se: *“Besimtari që fal namaz pesë herë në ditë, pastrohet nga gjynahet ashtu siç pastrohet një njeri pesë herë në ditë në lumin që i rrjedh para shtëpisë.”* (shih. Buhari, Meuakit, 6.) Pra, sa e dëshirojmë në një pastrim të tillë apo edhe më shumë?

Megjithëse nga ana e jashtme namazi përbëhet nga disa lëvizje, lutje dhe dhikre, në thelb ka qëndrimin në audiencën e Allahut duke u shkëputur nga çdo lloj interesi me këtë botë dhe kërkimin e rrugës së afrimit me paqen shpirtërore të Allahut me anë të frikë-respektit në sexhde. (shih. el-Alak, 19.) Sa jemi të vetëdijshëm për këtë?

Për myslimanin, namazi është një mbajtëse e sigurt, e cila i forcon lidhjet e tij me islamin, një burim mëshire, i cili ndriçon gjymtyrët dhe zemrën duke i pastruar nga gjynahet dhe një shkollë ku bukuritë e moralit islam mësohen duke u jetuar. Është një vendstrehim ku njeriu mund t'ia paraqesë Allahut Teala çdo problem dhe gjendje me të cilën përballet...

Disa nga pyetjet që duhet t'i drejtojmë nefsit tonë në lidhje me namazin, duhet të jenë edhe këto:

- Cilat janë qëllimet tona që përpiqemi t'i realizojmë në jetën e cila është si një udhëtim, që fillon me një ezan pa namaz dhe përfundon me një namaz pa ezan?

- Sa përpiqemi të arrijmë përqendrimin në namaz, me qëllim që namazi ynë t'i ngjajë atij të Profetit tonë të dashur (a.s.)?

- Sa mundohemi t'i zbukurojmë ditët dhe netët tona me namaze vullnetare?

- A e qëndisim dashurinë për namazin në zemrat tona dhe sa mundohemi ta përçojmë atë dashuri tek zemrat e tjera?

Shoqërinë me namazin, e cila fillon që prej moshës shtatë vjeç e deri në frymën e fundit, duhet ta marrim më seriozisht, në mënyrë që ajo të ëmbëlsohet me kalimin e kohës. Prandaj, duke kontrolluar gjendjen në kohë të caktuara, duhen bërë veprimtari të ndryshme me qëllim që të rinovohet entuziazmi dhe emocion i namazit.

LAJMI I UDHËTIMIT NË HAPËSIRË

“O xhinde dhe njerëz, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkojini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe!” (er-Rrahman, 33.)

Fjala “sulltan” që kalon në këtë ajet dhe është përkthyer me fjalën “fuqi”, në shkencën e tefsirit theksohet se mund të kuptohet edhe si “kompetencë”. Duke marrë për bazë këtë fakt, ajeti i lartpërmendur mund të shpjegohet edhe në këtë mënyrë: “Përshkrimi i kufijve të qiejve dhe tokës, mund të realizohet vetëm me anë të një lloj kompetence apo aftësie të dhënë prej Allahut”. Dhe pas kësaj, vjen ky lloj koment:

“Këtu kërkohet të tregohet një lloj fuqie, e cila do të arrihet si rezultat i përpjekjeve që do të bëjnë ata të cilëve u drejtohet ky ajet, brenda kuadrit të ligjeve të Allahut, të cilat janë të mundshme në gjithësi. Dëshira e birit të njeriut për të njohur edhe pikat më të largëta të gjithësisë nuk është për t'u habitur dhe kjo mund të realizohet nëse arrihet të gjendet një fuqi e madhe.

Në ajetin fisnik, xhindeve dhe njerëzve u tërhiqet vëmendja të mos mashtrohen pas mundësive që u janë dhënë dhe u kujtohet se nuk do të jetë e mundur t'i shpëtojnë vdekjes dhe dhënies së llogarisë përpara Allahut...”¹

Në Kuranin Kerim gjendet fara e të gjitha ngjarjeve që kanë ndodhur dhe që do të ndodhin. Përveç udhëtimit të jashtëzakonshëm për të cilin bëhet fjalë, ky ajet na fut në një udhëtim në thellësitë e hapësirave të shpirtit, të cilat janë më të rëndësishme për ne. Pra, rezultatet që arrihen me anë të mendjes, t'ia shfaqim njerëzimit me anë të pasurisë shpirtërore.

Besojmë se njerëzit që i japin më tepër rëndësi përmirësimit të gjendjes së tyre shpirtërore, ditën që do të dalin në udhëtimin e përmendur në ajet, do ta gjejnë kuptimin e vërtetët të udhëtimit në hapësirë.

1. Shih. “Kur'an Yolu” përkthimi dhe tefsiri në turqisht në lidhje me ajetin e përmendur.

UDHËZIMI NË RRUGËN E DREJTË

— Sadik Dana —

Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë:

“Na udhëzo në rrugën e drejtë!” (Fatiha, 6)

Robi duhet ta kalojë me adhurim dhe ibadet rrugën që ka për të bërë, në mënyrë që të arrijë te Allahu. Ai duhet të kërkojë ndihmë nga Allahu i Madhëruar për pengesat dhe fatkeqësitë me të cilat përballet në këtë rrugë, duhet të durojë ndaj mizorive që i vijnë nga njerëzit dhe malin e nefsit që e ka përpara duhet ta kalojë me përpjekjen që do japë me ndihmën e Allahut. Në këtë mënyrë, do arrijë te dëshmimi i ekzistencës së Zotit.

Gjetja e rrugës së përpjekjes dhe vazhdimësia

në këtë rrugë, që rezulton me dëshmimin e çdo gjëje për të arritur tek Allahu i Lartësuar, do të thotë udhëzim në rrugën e drejtë. Sipas mendimit të dijetarëve dhe evlijave myslimanë, kjo është ajo që synohet me rrugën e drejtë.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.” (En’am, 153)

Robi nuk mund ta arrijë rrugën e drejtë, përderisa të mos ua kthejë kurrizin të gjitha gjërave përveç



Allahut Teala. Për t'ia dalë mbanë kësaj është kusht fitimi i marifetullahut (njohjes së Zotit). Rruga e drejtë është marifetullah.

Sipas një mendimi tjetër, rruga e drejtë është qëndrimi me vendosmëri në këtë rrugë duke mos rënë në ifrat dhe tefrit dhe duke e ruajtur gjendjen normale. Kjo do të thotë që urdhrat e Zotit të zbatohen ashtu siç janë urdhëruar për t'u zbatuar. Ajeti fisnik në suren Hud, për të cilën i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, thotë se e ka plakur, shprehet:

“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty, e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju.” (Hud, 112)

Njeriu, nisur nga aspekti i forcave të brendshme dhe të jashtme, ka disa morale dhe cilësi natyrale dhe shpirtërore. Dikush është në gjendjen e ifratit dhe dikush është në gjendjen e tefritit. Ajo që duhet të bëjë robi, është ruajtja e gjendjes normale ndërmjet këtyre të dyjave.

Në fenë tonë edhe koprracia, edhe israfi është i papranueshëm.

Disa sahabë kërkuan nga i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, që të mbanin agjërime përgjatë gjithë vitit, t'i kalonin netët duke bërë ibadet, të kufizoheshin nga liria dhe ta shndërronin të gjithë jetën e tyre në adhurim. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i ndaloi të gjitha këto dhe u tregoi rrugën e drejtë. Kjo do të thotë që ta bëjmë çdo gjë që ka urdhëruar i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem dhe të largohemi prej atyre që na ka ndaluar.

Në ajetin fisnik thuhet:

“...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësoni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtetë ashpër.” (Hashr, 7) Prandaj zbatimi i fesë është: Qëndrueshmëria me vendosmëri në rrugën e drejtë.

Hoxhën e nderuar, Abdulhalik Guxhdyvanin e pyetën:

“A të bëjmë ato që do nefsi, apo të bëjmë ato që nuk i do?” Ai u përgjigj:

“Njeriu mund të gabojë shpeshherë në caktimin e kësaj. Për këtë arsye, duhet të bëhet ajo që ka urdhëruar Allahu Teala dhe të mos bëhet ajo që ka ndaluar. Ky është adhurimi i vërtetë.

Pastaj e pyetën:

“A ndërhyjnë shejtani në rrugën e udhëtarit për te Allahu?”

“Një udhëtar që nuk ka arritur në kufirin e fundit të shkatërrimit të nefsit, në rrugë i përzihet zemërimi, mendimi dhe shejtani. Zemërimi nuk gjendet te një udhëtar që e ka shkatërruar nefsin. Vetëm se përpjekja nuk duhet të ngatërrohet me zemërimin. Përpjekja është një sjellje dhe heroizëm kundër atyre që kundërshtojnë në çështjen e zbatimit të urdhrave të Allahut Teala dhe pasimit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Thuhet se kur shfaqet një përpjekje e tillë, shejtani arratiset.”

Një natë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, shkoi te shtëpia e Umerit, (r.a.).

Umeri, (r.a.), po lexonte Kuran me zë të lartë. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, e pyeti:

“Përse veprojnë kështu?” Umeri (r.a.), iu përgjigj:

“Për t'i zgjuar ata që po flenë dhe për të përzënë shejtanin, o i Dërguari i Allahut.” I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i tha:

“Ule pak zërin!”

Pastaj shkoi te Ebu Bekr es-Siddiku, (r.a.). Edhe ai po lexonte Kuran, por me zë shumë të lehtë. Atë e pyeti:

“Përse veprojnë kështu?” Ai iu përgjigj:

“Edhe kaq e dëgjon Ai të Cilit po i lutem.” I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i tha Ebu Bekrit:

“Ngrije pak zërin!”

Ajo që bëri i Dërguari i Allahut (s.a.s.), shprehet edhe në këtë ajet fisnik: **Thuaj: “Thirrni Allahun ose thirrni të Gjithëmëshirshmin, me cilindo emër që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur. Gjatë namazit, mos lexo (Kuran) me zë të lartë dhe as me zë tepër të ulët, por kërkoni një rrugë të mesme.”** (Isra, 110)

Edhe në një ajet tjetër fisnik thuhet:

“Allahu zgjedh për vete atë që dëshiron. Atyre që i drejtohen Atij, u tregon rrugën që shkon te Ai.”

Allahu i madhëruar i udhëzon ata të cilët i drejtohen Atij. Ky është udhëzimi i Allahut në rrugën e drejtë. Për ta arritur udhëzimin, është kusht që të kapemi fort pas Kuranit dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Në ajetin fisnik thuhet:

“Me të vërtetë ti tregon siratun l-mustekimin / rrugën e drejtë të Allahut. Çdo gjë që ndodhet në qiej dhe në tokë është e Allahut. Dijeni se të gjitha veprat, më së fundi do të shkrijnë te Allahu.”

Kurbani dhe vetëdija për devotshmëri

— Dr. Kerim Bulladë —

Kuptimi leksikor i fjalës kurban është afrim dhe diçka që përdoret për t'iu afruar Allahut Teala. Në kuptimin e përgjithshëm përdoret si emër i kafshës e cila theret për hir të Zotit.¹ Kurse në kuptimin terminologjik është emri që i jepet kafshës e cila mbart disa kushte dhe theret sipas një mënyre të caktuar përgjatë ditëve të Kurban Bajramit me qëllimin për t'iu afruar Allahut Teala dhe fitimin e kënaqësisë së Tij.² Në një kuptim edhe më të përgjithshëm fjala “kurban” është përdorur për kafshën që theret për t'iu afruar Allahut, për lëmoshën dhe për gjëra të tjera të ngjashme me këto.³

Pavarësisht se çështja e kurbanit është prej temave që shtjellohet shpesh, sidoqoftë është e dobishme që ta përsërisim edhe një herë tjetër. Brenda këtij konteksti, në këtë shkrim do të shpjegohen sipas dispozitave të Kuranit Fisnik qëllimet e therjes së kurbanit dhe urtësitë e legjitimitetit të tij. Po ashtu do të përpiqemi t'u japim përgjigje pyetjeve si: Përse është bërë legjitim kurbanit? Çfarë kontributi ka për individin dhe shoqërinë kryerja e kësaj përgjegjësie/detyre? Cilat specifikave


duhet t'u japim përparësi përgjatë kryerjes së këtij ibadeti? Këtyre pyetjeve në mënyrë të përmbledhur mund t'u jepen këto përgjigje:

I-KURBIJET / AFRIMI TE ALLAHU

Kur fjala kurban të shtjellohet në një kuptim më të gjerë, siç u përmend edhe më sipër, atëherë përdoret për kafshën që theret për t'iu afruar Allahut, për lëmoshën dhe për gjëra të tjera të ngjashme me këto. Bazuar në këtë, kurbanit/kurbijeti është çdo vepër e madhe apo e vogël që e afron njeriun te Allahu Teala dhe që bëhet shkak për fitimin e kënaqësisë së Tij. Së pari le të japim ajetin e mëposhtëm si shembull për këto shpjegime:

“Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit.”⁴

Siç vihet re në ajet, flitet për dy bijtë e Ademit (a.s.). Siç thuhet nëpër tefsire të ndryshme, emri i atyre ka qenë Habil dhe Kabil apo kanë qenë dy per-



sona nga bijtë e Izraelit. Mbi të gjitha janë bërë disa shpjegime rreth çështjes së pranimit të kurbanit⁵ dhe janë bërë komentime rreth faktit se pranohet nga Allahu Teala kurban i atij që sakrifikon nga pasuria e mirë dhe e vlefshme dhe se nuk pranohet kurban i atij që sakrifikon nga pasuria e keqe dhe jo cilësore.⁶

2-KURBANI DHE NËNSHTRIMI NDAJ ZOTIT

Kurani Fisnik na informon se Ibrahim (a.s.), ka kërkuar një fëmijë të devotshëm nga Allahu Teala. Ibrahim (a.s.), të cilit iu pranua kjo kërkesë, Allahu i dhuroi një djalë me natyrë të butë. Emri i këtij djali ishte Ismail (a.s.). Kur djali arriti në moshën e punës, Ibrahim (a.s.), pa në ëndërr se theri djalin e tij si kryerje e një pune për hir të Allahut Teala dhe shfaqje e bindjes ndaj Tij. Ibrahim këtë çështje e diskutoi me të birin, Ismailin (a.s.). Siç tregohet, Ibrahim (a.s.), ka parë në ëndërr tri net me radhë, pra në natën e tetë, natën e nëntë dhe natën e dhjetë të dhulhixhës (natën e tevrijës, arafatit dhe nahrit/kurban bajramit) duke therur birin e tij, Ismailin (a.s.). Ngaqë ëndrrat e peygamberëve janë shpallje, Ibrahim (a.s.), e konsideroi këtë si një detyrë që duhej ta kryente. Kështu që shfaqti nënshttrim të plotë ndaj Zotit bashkë me të birin dhe u përpoq për ta kryer këtë përgjegjësi. Ai fitoi një sprovë shumë të qartë dhe të madhe duke shfaqur vendosmërinë për realizimin e ëndrrës që kishte parë. Allahu nuk e çoi dëm këtë nënshttrim të tyre dhe suksesin që e arritën në adhurimin ndaj Tij. Kështu që dërgoi një kafshë të madhe kurban në këmbim të birit të tij, Ismailit. Përveç të tjerash, Allahu Teala ka lënë një (nam/famë) të mirë ndërmyet brezave pasardhëse për Ibrahimin (a.s.).⁷ Ata që kanë ardhur pas Ibrahimit (a.s.), e përkujtojnë atë me këtë moment të bukur dhe bëjnë festë duke praktikuar sunetin/traditën e tij.⁸

Therja e kurbanit është shprehje e nënshtimit ndaj Zotit (xh.xh.). Ai që ther kurban, nga një aspekt luan rolin e Ibrahimit me këtë ibadet dhe shfaq bindjen e besnikërinë ndaj Allahut siç e ka shfaqur ai. Ibrahim (a.s.), vendosi ta bëjë kurban birin e tij duke u bazuar në urdhrin e Allahut Teala. Si rrjedhojë e këtij nënshtrimi që ai e shfaqti me sinqeritet dhe dëlirësi, Allahu i Lartësuar e shpërbleu dhe i dërgoi një kafshë të madhe për ta bërë kurban në vend të birit. Ibrahim (a.s.), u shpërblye me një përkujtim të mirë ndërmyet brezave që do të vinin pas tij si rrjedhojë e fitimit të kësaj sprove të rëndë që iu dha nga Allahu (xh.xh.). Për besimtarët e pasur që do të vinin pas tij, si një mëshirë e Allahut Teala, është legjitimuar bërja kurban e kafshëve që



mbartin disa kushte të caktuara në vend që të bëjnë kurban bijtë e tyre.

Ky hadith (thënie profetike) na tregon se ibadeti i kurbanit ka mbetur nga Ibrahim (a.s.) dhe se është një metodë dhe praktikë e tij. Kur sahabët e nderuar e pyetën të Dërguarin e Allahut (a.s.), rreth çështjes së kurbanit në formën: “O i Dërguari i Allahut! Cila është natyrë e kafshëve të kurbanit? Përse therim kurban?”, Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj: “Ai është suneti (praktika) e babait tuaj, Ibrahimit...”⁹

3-KURBANI KA QENË I LEGJITIMUAR PËR ÇDO UMET

Allahu Teala e ka thënë qartë se therja e kurbanit ka qenë legjitime për çdo umet duke u shprehur në ajetin fisnik: *“Për çdo popull, Ne kemi caktuar një ritual, që ata të përmendin emrin e Allahut gjatë flijimit të kafshëve, që Ai ua ka dhuruar për ushqim. Zoti juaj është një Zot i vetëm, prandaj vetëm Atij përuljuni. Dhe jepu lajme të mira atyre që janë të përulur.”*¹⁰ Sipas komentimit të Fahrud-din er-Razit, ibadeti i kurbanit që shprehet në ajet ka qenë legjitim për të gjitha umetet që nga Ibrahim (a.s.) dhe arsyeja themelore e këtij adhurimi është që të përmendet emri i Allahut mbi këto kafshë kurban. Sepse arabët nuk thernin kurban në emër të Allahut, por në emër të idhujve. Në këtë komentim është thënë se shprehja “çdo popull” është një shprehje e përgjithshme.¹¹ Bazuar në këtë, therja e kurbanit ka qenë legjitime që nga Ademi (a.s.), e deri në ditët e sotme. Madje do të jetë e tillë deri në kiamet për të gjitha umetet.

4-KURBANI DHE VETËDIJA PËR DEVOTSHMËRI

Në ajetin e 27-të të sures Maide, në të cilin tregohet se Habili dhe Kabili i kanë paraqitur kurban Allahut Teala, thuhet qartë se do të pranohen kurbanet që i therin të devotshmit, domethënë ata që kanë frikë siç duhet nga Allahu dhe që ndajnë respekt ndaj Tij. Siç është shprehur Zemahsheri (v. 538/1143), ky ajet është argument se Allahu i Madhëruar e pranon vetëm ibadetin dhe bindjen e robit besimtar që është i devotshëm.¹²

Ky ajet është argumenti më i fortë që tregon se qëllimi i vërtetë i kurbanit është devotshmëria: **“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!”**¹³

Siç mund të kuptohet edhe nga ajeti, çështja më e rëndësishme dhe e nevojshme në kryerjen e ibadetit të kurbanit është arritja e vetëdijes për devotshmëri. Detyra e therjes së kurbanit në një kontekst është provim për devotshmërinë dhe sinqeritetin. Po ashtu është sprovë që Allahu ua bën robërve të Tij me pasurinë dhe mirësitë që ua ka dhënë. Prova nëse Ibrahim (a.s.), do ta bënte kurban të birin apo jo, është një sprovë shumë e qartë dhe e kuptueshme. Për këtë arsye therja e kurbanit në një kontekst është shfaqje e sinqeritetit dhe besnikërisë ndaj Allahut (xh.xh.).

5-KURBANI DHE FALËNDERIMI NDAJ ZOTIT

Kurbanit është një ibadet që kryhet me qëllimin për të shfaqur respekt dhe falënderim ndaj mirësive të Allahut Teala. Ndërmjet qëllimeve të ibadetit të kurbanit përgjatë ditëve të bajramit është përmendja e emrit të Allahut kur theren kafshët që na janë dhënë si rrësk dhe bërja e kësaj sakrifice për hir të Allahut (xh.sh.). Përveç të tjerash është shprehur qartë se një qëllim tjetër i rëndësishëm i therjes së kurbanit është ushqyerja e të varfërve.¹⁴ Në Kuranin Fisnik është shprehur qartë se qëllimi i ibadetit të therjes së kurbanit është ushqyerja e të varfërve që e fshehin nevojën apo që nuk e fshehin dhe falë-

nderimi i poseduesit të vërtetë (Zotit) të kafshëve të cilat janë dhënë si mirësi dhe rrësk:

“Devetë dhe gjedhët i kemi bërë për ju si një nga ritet e Allahut për flijim dhe ju keni dobi nga ato. Prandaj, përmendeni emrin e Allahut mbi ato, ndërsa i radhisni në këmbë (për t’i therur). **Kur ato të bien në tokë, hani prej** (mishit të) **tyre dhe ushqeni edhe atë që lyp, edhe atë që nuk lyp. Kështu pra, Ne i kemi vënë ato në shërbimin tuaj, që ju të jeni mirënjohës.**”¹⁵

Besimtari që ligjërisht konsiderohet i pasur, nëpërmjet therjes së kurbanit qoftë në haxh apo qoftë në vendin e tij, thotë: “Po e ther këtë kafshë për kënaqësinë Tënde dhe me qëllimin për të të falënderuar për të gjitha mirësitë që mi ke dhënë. Nëse është e nevojshme, mund ta flijoj edhe birin, jetën dhe çdo gjë timen në rrugën Tënde.” Për këtë arsye, therja e kurbanit është një ibadet madhështor. Në të njëjtën kohë është një shprehje e lartë e sakrificës dhe falënderimit.

Ditët e kurbanit janë sezoni i afrimit me Zotin (xh.xh.). Pra, janë një segment kohor përgjatë të cilit afrimiteti ndaj Allahut arrin në pikën kulmore. Në të njëjtën kohë, falë këtij ibadeti besimtarët formojnë edhe afrimitetin material dhe shpirtëror me vëllezërit e tjerë myslimanë që janë afër dhe larg. Për këtë arsye, Pejgamberi (a.s.), i ka paralajmëruar dhe dënuar ata që kanë mundësi të therin kurban, por nuk e kryejnë këtë ibadet, duke u shprehur: **“Ai që ka mundësi dhe nuk ther kurban, të mos i afrohet vendit të faljes!”**¹⁶ Sepse therja e kurbanit krahas aspektit si ibadet, nënshtrim e devotshmëri ndaj Zotit, ka edhe aspektin social. Në të njëjtën kohë nuk duhet të harrohet se ibadeti i kurbanit është solidarizim, ndarje e pasurisë me të tjerët dhe para së gjithash është infak (dhurim për hir të Zotit). Siç është kryerja e këtij ibadeti solidarizim në një masë të konsiderueshme për bashkëpunimin, bashkimin dhe stabilitetin e besimtarëve, edhe moskryerja e tij është shfaqje e mosmirënjohjes në mënyrë serioze kundrejt mirësive të Allahut (xh.xh.) dhe mosmarrje përsipër e përgjegjësisë kundrejt shoqërisë. Për këtë arsye, paralajmërimi që bëhet në hadithin fisnik duhet të vlerësohet/shtjellohet brenda kësaj kornize.

■ **REFERENCAT:** 1) Ragib el-Isfehana, Mufredatu Elfadhi'l-Kur'an, Daru'l-Kalem, Bejrut, 2011, fq. 664; Ibn Mandhur, Lisani'l-Arab, Bejrut, 1999, XI, 83. 2) Mevsili, Abdullah b. Muhammed b. Mevdud el-Mevsili, el-Ihtijar li Talili'l-Muhtar, Stamboll, 1980, V, 16. 3) Zemahsheri, Ebu'l-Kasim Xharullah Muhammed b. Omer, el-Keshshafu an Hakaiki Gavamid'it-Tenzil ve Ujuni'l-Ekavil fi Vuxhuhi't-Te'vil, Tas'hah, Mustafa Hysejin Ahmed, Bejrut, pa datë, I, 624. 4) Maide, 27. 5) Taberi, Muhammed b. Xhafer et-Taberi, Xhamiu'l-Bejan fi Tefsiri'l-Kur'an, Kajro, 1987, vëll. IV, pjesa VI, 120-123; Zemahsheri, Keshshaf, Daru'l-Kutubi'l-Arabijji, Bejrut, pa datë, I, 624. 6) Për informacion më të gjerë shik. Taberi, Xhamiu'l-Bejan, vëll. IV, pjesa VI, 120. 7) Shik. Saffat, 102-111. 8) Për informacion më të gjerë shik. Muhammed Hamdi Jazër, Hak Dini Kur'an Dili, Botimet Eser, Stamboll, 1971, VI, 4061-4064. 9) Ibn Maxhe, Edahi, 3. 10) Haxhaxh, 34. 11) Zemahsheri, Keshshaf, III, 157; Fahrudin Razi, Mefatihul-Gajb, Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut, 1990, XXIII, 30. 12) Shik. Zemahsheri, Keshshaf, I, 624. 13) Haxhaxh, 37. 14) Shik. Haxhaxh, 28. 15) Haxhaxh, 36. 16) Ibn Maxhe, Edahi, 2; Ahmed ibn Hanbel, II, 321.

Puna e mirë dhe jeta e bukur

— A. Jasin Demirxhi —

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” (en-Nahl, 97.)

Është fakt se pothuajse tek të gjithë, botëkuptimi i “lumturisë” dhe “jetës së bukur” është i ndryshëm. Sipas shumicës, mundësitë e mëdha materiale janë çelësi më i rëndësishëm i një “jete të bukur”. Prandaj, për të arritur këtë “jetë të bukur” në kuptimin material, shpenzohen përpjekje të jash-tëzakonshme.

Por krejt ndryshe është çelësi që hap dyert e “jetës së bukur” sipas disa të tjerëve...

Ndërkohë që në Kuranin Kerim, ashtu siç tregon edhe ajeti 97 i sures en-Nahl, që kemi dhënë më sipër, për ata që dëshirojnë një “jetë të bukur” propozohet një çelës ndryshe: “Puna e mirë”.

Puna e mirë; pra adhurimet që bën njeriu për hir të Allahut dhe të gjitha mirësitë e vogla e të mëdha që bën ai për veten, familjen dhe njerëzit e tjerë. Mirëpo, mufesirët (dijetarët e komentimit të Kuranit), të cilët e kanë komentuar konceptin “punë e mirë”, kanë vënë edhe një kusht që një punë të quhet e mirë... Ata kanë nënvizuar se asnjë punë, e cila nuk i ka rrënjët të mbështetura në besim, nuk mund të konsiderohet “punë e mirë”. E shprehur ndryshe, çfarëdo lloj pune qoftë, edhe nëse bëhet në përputhje me udhëzimet e Allahut dhe të Rasullallahut (a.s.), nëse nuk i ka rrënjët në besim, nuk mund të konsiderohet “punë e mirë”. Prandaj dhe në Kuranin Kerim, kudo që përmendet puna e mirë, bashkë me të përmendet edhe besimi.

“Jeta e bukur” që është premtuar, është në këtë botë apo në botën tjetër?

Vallë, “Jeta e bukur” e cila u është premtuar atyre që bëjnë “punë të mira”, do të jetë në këtë botë apo në botën tjetër? Në lidhje me këtë çështje, shumica e mufesirëve janë të mendimit se jo vetëm në xhennet, por edhe në këtë botë do të mbretërojë jeta e lumtur dhe e qetë.

Përveç “jetës së bukur”, Allahu Teala ka edhe premtime të tjera për ata që bëjnë “punë të mira”.

Disa nga këto premtime, janë:

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra

të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.” (Merjem, 96.)

“Për sa u përket atyre që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, ata do t’i pranojë Zoti i tyre në mëshirën e Vet. Kjo është fitorja e lavdishme!” (el-Xhathije, 30.)

Shkurtimisht, robërit e mirë e të sinqertë që besojnë sinqerisht dhe jetojnë në përputhje me kënaqësinë e Allahut, i pret një “jetë e bukur” në të dyja botët. Në këtë çështje, nuk ka asnjë dyshim, sepse Kurani Kerim, **“është Libri në të cilin nuk ka dyshim”.** (el-Bekare, 2.)

Allahu i Madhëruar, na bëftë të gjithëve prej robërve të mirë që bëjnë “punë të mira”, të cilat do të na sigurojnë “jetën e bukur”...

Përse nuk pranohen duatë?

Një ditë, kur Ibrahim bin Edhem po shëtiste në pazarin e Basrës, populli i mblihet pranë dhe e pyet në lidhje me ajetin fisnik: **“Lutmëni Mua, se do t’ju përgjigjem!..”** (el-Gafir, 60.) Pastaj u ankuan duke thënë: “Ne i lutemi Allahut, por Ai nuk na përgjigjet. Përse vallë?”

Ibrahim bin Edhem tha: Zemra juaj ka vdekur në dhjetë gjëra:

1- Ju e njihni Allahun, por nuk i jepni të drejtën që ka.

2- Ju e lexoni librin e Allahut, por nuk veproni me të.

3- Thoni se iblisi është armiku juaj, por veproni sipas tij.

4- Thoni se e doni shumë të Dërguarin e Allahut, por e braktisni rrugën dhe sunetin e tij.

5- Dëshironi xhennetin, por nuk punoni për të.

6- Keni frikë nga xhehenemi, por nuk ruheni nga gjynahet.

7- E dini se vdekja është e vërtetë, por nuk përgatiteni për të.

8- Merreni me të metat e të tjerëve, por nuk i shikoni të metat tuaja.

9- Hani prej riskut (furnizimit) që ju jep Allahu, por nuk falënderoni.

10- Varrosni të vdekurit tuaj, por nuk merrni mësim prej tyre.

TULEJBI

- radijallahu anhu -

— Adem Saraç —

Dielli i Islamit po i ndriçonte fatlumët duke depërtuar edhe në vendet më të shkreta... Tashmë kishte filluar periudha e procesit të ndriçimit, por sidoqoftë çdo njeri mbante një qëndrim sipas strukturës së tij. Siç kishte prej atyre që nuk ndjenin interes kundrejt diellit të Islamit, kishte edhe prej atyre që ishin të verbër dhe që nuk e konceptonin dot. Dikush tjetër nuk e kuptonte këtë mirësi të madhe që i kishte shkuar deri te këmbët. Ndërsa dikush tjetër, edhe pse e shikonte dhe kuptonte se çfarë po ndodhte, këmbëngulte në kufër dhe shirk për shkak të inatit.

Këta njerëz, siç e mbyllën veten ndaj së vërtetës, ia kthyen shpinën edhe Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.). Këta fatzinj që e kishin çdo gjë të errët, vazhdimisht bënë hesape të errëta nëpër vende të fshehta.

Nga ana tjetër, ata që e kthyen fytyrën, sytë, qenien dhe zemrën e tyre drejt diellit të Islamit, po hapnin derën e një ndriçimi krejt të ri. Ata kishin hyrë në një proces të tillë ndriçimi sa që kur ndriçoheshin vetë menjëherë fillonin të ndriçonin edhe të tjerët. Prej këtyre njerëzve të zgjedhur ishte edhe Tulejb ibn Umejri (r.a.)...

Tulejbi (r.a.), i cili ishte djali i Umejri ibn Vehbit dhe Erva binti Abdulmuttalibit, lindi në vitin 599 në Mekë. Domethënë, kur lindi dielli i Islamit, ai akoma ishte një fëmijë njëmbëdhjetë vjeçar. Nëna e Tulejbit, zonja Erva ishte njëra prej hallave të të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam. Si rrjedhojë, i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe Tulejbi ishin djalë dajë dhe djalë halle.¹

Babai i Tulejbit (r.a.), vdiq kur Tulejbi ishte akoma i vogël. Për këtë arsye, nëna e Tulejbit (r.a.), u detyrua të martohej me Kelde ibn Hashimin apo Ertat ibn Shurahbilin. Nga kjo martesë u lindi edhe një vajzë që e quajtën Fatime.²

Halla Erva, radijall-llahu anha, ia dedikoi veten birit të saj i cili e humbi babain e tij në moshë shumë të vogël dhe u rrit nën mbrojtjen

dhe përkujdesjen e njerikut. Ajo bëri çdo gjë për ta edukuar Tulejbin (r.a.), në mënyrën më të mirë.

Edhe Tulejbi, radijall-llahu anhu, nuk e mërziiti asnjëherë nënën e tij dhe ia dëgjoi fjalën duke iu bindur pa pasur nevojë që ajo ta përsëriste dy herë diçka. Ai shkonte aq mirë me motrën e vogël, sa që kushdo që i shikonte nuk mund të mendonte se ishin motër e vëlla vetëm nga nëna. Kjo familje me dy fëmijë, njëri djalë dhe tjetri vajzë, njihej nga të gjithë në Mekë. Ata i arritën këto ditë pa përjetuar asnjë problem...

Lindja e diellit të Islamit do të thoshte ndryshim i çdo gjëje, sepse Islami po sillte një jetë krejt të re. Tulejbi (r.a.), jetoi bashkë me shoqërinë në të cilën gjendej dhe asnjëherë nuk u shkëput prej saj në asnjë periudhë të jetës së tij. Ngaqë ishin të afërm me njëri-tjetrin, Tulejbi (r.a.), e njihte shumë mirë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Tulejbi (r.a.), që në vitet e para u bë pjesë e procesit të ndryshimit që filloi me lindjen e diellit të Islamit.

Tulejbi (r.a.), mori rrugën për në shtëpi me një dritë që i reflektonte në fytyrën e tij ngaqë kishte arritur nderin më të madh në Daru'l-Erkam.³

Tulejbi (r.a.), kishte shumë gjëra për t'i shpjeguar nënës së tij të dashur, në mënyrë që ajo të

1. Zubejri, Kitabu Nesebi Kurejsh, fq. 19.

2. Belazuri, Ensabu'l-Eshraf, vëll. 4, fq. 424.

3. Ibn Haxher el-Askalani, el-Isabe fi Ma'rifeti's-Sahabe, vëll. 4, 2413.

largohej nga gjembat e idhujtarisë dhe të hynte në kopshtin e trëndafilave të Islamit. Për shkak se motra e tij ishte akoma e vogël, atë e la në plan të dytë. Por ai nuk dinte nga t'ia fillonte. Ngaqë e donte shumë nënën e tij, kurrë nuk donte që ta zemëronte apo lëndonte. Për këtë arsye, përgjatë një kohe nuk u tregoi atyre se ishte bërë mysliman. Ndërkohë nëna e Tulejbit (r.a.), e cila i pa zhvillimet dhe ndryshimet e bukura te biri i saj, filloi të ndjente diçka. Më thënë të drejtën, Tulejbi (r.a.), e bëri atë që t'i ndjente këto gjëra.

Qëndrimi pozitiv i nënës së Tulejbit (r.a.), i dha shpresë atij. Ai e kuptoi se tashmë kishte ardhur koha për t'ia shpjeguar Islamit dhe për ta thirrur atë në Islam. Kur e gjeti kohën e përshtatshme në shtëpi, tha “besmelenë” me vete dhe filloi t'i fliste me një gjuhë të ëmbël:⁴

-Nëna e dashur, dua të të them diçka.

-Urdhëro bir!

-Ti e di që unë nuk dua të të mërzis apo të të lëndoj.

-Kur më ke mërzitur apo lënduar ndonjëherë, që ta bësh tani diçka të tillë bir?

-A mund të më thuash nënë, kë do më shumë prej fëmijëve të vëllezërve dhe motrave të tua?

-A pyetje është kjo? Sigurisht që dua Muhammedu'l-Eminin (a.s.)!

-Mirë atëherë, kush është nipi apo mbesa që të do më shumë ty?

-Sigurisht që është Muhammedu'l-Emini (a.s.).

-Atë e do shumë, apo jo?

-A është ai njeri që nuk mund të duhet?

-A mund të gënjejë nipi yt që e do kaq shumë, nënë?

-Ç'është ajo fjalë bir?

-A gënjen apo nuk gënjen?

-Jo vetëm ne, por të gjithë i thonë “Muhammedu'l-Emin” atij. A nuk e di këtë?

-Çfarëdo që të thotë ai është e vërtetë, apo jo nënë e dashur?

-Më thuaj se ku do të dalësh bir!

-A nuk e ke dëgjuar se ai thotë: “Unë jam i Dërguari i Allahut?”

-A ka ngelur ndonjë që nuk e ka dëgjuar!

-A e ke dëgjuar se ai thotë edhe këtë: “Shpëtojini veten tuaj duke i besuar Allahut dhe të Dërguarit të Tij!”

-Të gjithë po flasin për këtë bir!

-Po ti?

-Ti më thuaj atë që deshe të më thoshe!

-Unë jam bërë mysliman, nënë e dashur.

-Je bërë mysliman?

-Po nënë e dashur, i kam besuar Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

-Që kur?

-U bënë shumë.

-Përse nuk më ke thënë asgjë mua?

-Pata frikë.

-A mund të ketë frikë fëmija nga nëna e tij, bir?

-Sigurisht që nuk ka frikë, madje nuk duhet të ketë frikë.

-Atëherë, përse pate frikë ti?

-Pata frikë mos e shkatërron këtë botë dhe botën tjetër duke mos i besuar dhe duke e kundërshtuar të Dërguarin e Allahut (a.s.)!

-A për këtë arsye nuk më ke treguar se je bërë mysliman?

-A u nxehe nënë?

-A mund t'i nxehem një fëmije të mençur si ti, bir?

-Atëherë?

-Çfarë atëherë?

-Atëherë edhe ti do të bëhesh myslimane duke i besuar Allahut dhe të Dërguarit të Tij, apo jo nënë e dashur?

-Unë? Eëë...

-Mos vallë po heziton nënë?

-Nuk e di. Më duhet të mendohem.

-Unë jam bërë ndjekës i të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam dhe kam hyrë në rrugën e tij!

-Bir, sigurisht që ai është djali i dajës tënd. Padyshim që e ke detyrë t'i besosh atij para të gjithëve!

-Po ti?

-Unë do të mendohem.

Halla Erva, e cila ishte njëra prej hallave të të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, po thoshte se do të mendohet. Ndërkohë Tulejbi që akoma ishte në moshë fëmijërore, ishte bërë mysliman duke u nderuar me besimin.

Tulejbi (r.a.), i cili dëshironte shumë që edhe nëna e tij e dashur të bëhej myslimane, nuk këmbënguli më shumë. Por sidoqoftë, kjo provë e parë e tij konsiderohej e suksesshme. Çfarëdo që të ndodhte, ai ishte i vendosur për t'ia shpjeguar Islamit nënës së tij.⁵

Pra, do t'i shpjegonte asaj se në çfarë gjërash thërriste i Dërguari i Allahut.

Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem...

4. Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe fi Ma'rifeti's-Sahabe, vëll. 5, fq. 6.

5. Ibn Sejjidu'n-Nas, Ujunu'l-Eser fi Fununi'l-Megazi ve's-Sijer, vëll. 2, fq. 389.

VËLLAZËRIA

dhuratë nga Zoti

— Ferit Piku —

Allahu thotë në Kuranin fisnik: “**Është Allahu Ai që i bashkoi zemrat e tyre**”. (Enfal: 63).

Në këtë temë do të flasim për një nga dhuratat e Zotit, për vëllazërinë. Ajo nuk fitohet as me para, as me interesa, as me imponim, por ajo është dhuratë e Zotit. Kjo vëllazëri është dhuratë e besimit dhe nuk ka besim, ku nuk ka vëllazëri. Kjo fe është daluar gjithmonë për lidhjen që kanë besimtarët me njëri-tjetrin. Këtë vëllazëri e kanë zili shejtani dhe pasuesit e tij, prandaj duhet ta mbajmë fort këtë vëllazëri. Këtë çështje e ka sqaruar Zoti, për këtë çështje ka folur profeti (a.s.), i cili e ka praktikuar atë bashkë me besimtarët. Pra këtu do të flasim për të drejtat e vëllazërisë dhe çfarë e prish atë.

E pyetën profetin (a.s.), se cili është haku i një myslimani ndaj një tjetri. Ai u përgjigj: “Ato janë gjashtë:

1- KUR TA TAKOSH VËLLAIN TËND, JEPI SELAM ATIJ.

Prandaj ai që jep selam i pari është më i mirë dhe ndërsa ai që jep selam i pari bën sunetin, ai që e

dëgjon e ka vaxhib ta kthejë selamin. Selami është përshëndetja e Zotit për banorët e xhenetit, është përshëndetja, që melekët i dhanë Ademit (a.s.). Selami është ai që i bashkon zemrat, selami është dua (lutje). Kur t’i japësh dikujt selam, dije se je lutur për atë njeri, që paqja dhe mëshira e Allahut të jetë mbi të. Prandaj le ta përhapim selamin jo vetëm ndërmjet nesh, por edhe më gjerë. Selami nuk është shprehje arabe, por është shenjë e besimit, është tregues i vëllazërisë muslimane dhe është ajo që i bashkon muslimanët kudo që janë. Profeti (a.s.) sqaron, se ai që është një i jep selam grupit, ai që është në këmbë i jep selam atij që është ulur, i vogli i jep selam më të madhit e kështu me radhë, derisa në fund ka thënë, se më i miri mes dy muslimanëve është ai që e nis me selam. Pra selami duhet të bëhet me nijetin, që më shumë se një përshëndetje të jetë një lutje dhe bashkim i zemrave të njerëzve.

2- NËSE TË FTON, PËRGJIGJU FTESËS SË TIJ.

Nëse vëllai yt të thërret në familjen e tij, në ndonjë

gëzim apo hidhërim që ka dhe ti nuk sheh ndonjë pengesë, atëherë shko tek ai. Përgjigjia e ftesës në hidhërim është më obligative sesa në gëzim. Ndryshe është një musliman, që të ka vizituar dhe e ke vizituar dhe ndryshe është një tjetër, që vetëm të jep selam dhe nuk e di as ku e ke shtëpinë, as çfarë hallesh ke. Përveç kësaj, çdo musliman që hyn në shtëpinë e një tjetri, është ftesë për të tjerët, sepse ne besojmë se kur një musliman hyn në një shtëpi, aty hyn bereqeti i Zotit. Gjithashtu nuk duhet të bëjmë dallim, nëse ai që të fton është i pasur apo i varfër, i shkolluar apo i pashkolluar, por duhet t'u përgjigjemi të gjithëve dhe Zoti na faltë se sa herë mund t'ia thyejmë zemrën dikujt dhe ai mund të mendojë keq për ne, për shkak të këtij veprimi. Profeti (a.s.) nuk ka refuzuar asnjë ftesë. Ai shkoi tek një plakë, e cila e ftoi për drekë. Ai (a.s.) nuk refuzonte ftesat e vajzave të vogla të Medines, kur ato e merrnin për dore dhe e çonin nga të donin për të kryer hallet e tyre. Ai (a.s.) nuk ka refuzuar as ftesën e çifutëve, që në atë kohë ishin jobesimtarë dhe jetonin në Medine.

3- NËSE TË KËRKON KËSHILLË, KËSHILLOJE.

Këshilla duhet të jepet gjithmonë, por nëse të kërkohet, atëherë e ke obligim akoma më shumë që ta japësh, sepse ai që ta kërkon, të ka zgjedhur ty si konsulent për të zgjidhur hallin e tij, prandaj jepja këshillën dhe thuaja të vërtetën siç është ajo, pa hatërmbetje, pa lajka dhe pa zbukurim fjalësh, por vetëm këshilloje me të vërtetën. Por duhet ta këshillosh edhe kur nuk ta kërkon atë, sepse këshilla është thelbi i kësaj feje. Profeti (a.s.) thotë: **“Feja është këshillë”**.¹ Nëse nuk shkon në Arafat, nuk të quhet haxhi. Po kështu nëse nuk e jep këshillën, ti nuk e ke kuptuar Islamin. Profeti (a.s.) tha: **“Ndhmoje vëllain tënd edhe kur ka të drejtë edhe kur nuk ka të drejtë”** Shokët e tij e pyetën: “O profet i Zotit! Ne e ndihmojmë kur i kanë bërë padrejtësi, por si do ta ndihmojmë atë, kur ai vetë bën padrejtësi”? Profeti (a.s.) tha: **“Ndhmoje duke e ndaluar nga padrejtësia”**.² Pra ndalesa mund të jetë edhe me një këshillë. Shpesh vihemi në siklet për t'i thënë një këshillë vëllait tonë, duke menduar se mund të na e marrë për keq, por har-

rojmë se dhënia e këshillës është obligim përpara Zotit. Disa nga sahabët kanë thënë: “I dhamë besën profetit (a.s.), që të dëgjojmë të parët tanë dhe t'ia japim këshillën çdo muslimani”. Por një rëndësi të madhe ka edhe forma sesi jepet këshilla. Merre vëllain anash dhe thuaji fjalë të buta, se këshilla është amanet dhe qëllimi kryesor nuk është ta demaskosh tjetrin, por t'i tregosh një gabim, që ai nuk e shikon. Surja “Asr” ka qenë ajo sure, me të cilën sahabët ndaheshin nga njëri-tjetri, pasi kishin biseduar. Ajeti i fundit i sures Asr thotë, që besimtarët porosisin njëri-tjetrin për të ndjekur të vërtetën dhe për të pasur durim. Të urdhërosh për mirë dhe të ndalosh nga e keqja është urdhër për njerëzit e tjerë, jo më pastaj për vëllezërit e tu. Sikur të ekzistonte sinqerisht kjo punë, ne do të ecnim shumë përpara, por kam frikë se shpesh ne i mbyllim sytë dhe veshët, ndërsa gabimet shtohen dita-ditës dhe secili mendon vetëm për vete. Duke vepruar kështu, ne mbetemi individë dhe individët gjithmonë janë të dobët. Ndërsa xhemati sado gabime që të ketë, përsëri është më i fortë se individi. Zoti na bëftë nga ata që e japin këshillën në formën më të mirë.

Ne themi
“Shëndet”. Kjo nuk
është fjalë e keqe,
por duaja që ne bëjmë
për atë njeri që teshtin,
është më e madhe se shëndeti.
Pra ne lutemi, që Zoti ta
mëshirojë atë person, ta
pastrojë nga të këqijat
në dynja dhe
ahiret.

4- NËSE TESHTIN DHE FALËNDERON ZOTIN, LUTU PËR TË.

Kjo duhet diçka shumë e rëndomtë, por e kemi detyrë që të lutemi për vëllain tonë, kur ai teshtin dhe falenderon Allahun. Teshtima është pjesë e fizikut të njeriut. Ajo mund të jetë çlirim, por edhe tregues sëmundjeje. Kur njeriu teshtin, ai çliron energji. Në këtë moment njeriu falënderon Zotin për këtë, ndërsa ai që e dëgjon i thotë: “Zoti të mëshiroftë”. Nëse ai nuk e falënderon Zotin, atëherë mësoje ti që ta falenderojë Zotin. Ne themi “Shëndet”. Kjo nuk është fjalë e keqe, por duaja që ne bëjmë për atë njeri që teshtin, është më e madhe se shëndeti. Pra ne lutemi, që Zoti ta mëshirojë atë person, ta pastrojë nga të këqijat në dynja dhe ahiret. Kështu na ka mësuar profeti (a.s.). Profeti (a.s.) na ka mësuar edhe formën e teshtimës. Ai ka thënë: **“Nëse dikut i vjen për të teshtirë, të mundohet sa të mundet ta mbajë zërin e tij dhe ta largojë gojën e tij nga njerëzit e tjerë. Gjithashtu duhet ta afrojë edhe dorën tek goja”**. Çifutët kishin dëgjuar, se profeti (a.s.) lutej për atë që teshtinte dhe lutja e profetit (a.s.) nuk kthehet mbrapsht. Prandaj ata shkonin

1. Hadith i vërtetë. Muslimi (55).

2. Hadith i vërtetë. Buhariu (2444).

tek ai dhe e provokonin teshtimën, por kur e bënin këtë, profeti (a.s.) u thoshte: **“Zoti u drejtoftë dhe ua rregulloftë punët”**.³ Pra e ke obligim të lutesh për atë që teshtin.

5- NËSE VËLLAI YT ËSHTË SËMURË, SHKOI PËR VIZITË.

Kur njeriu sëmuret, në atë formë që shtrihet në shtrat, ai pret njerëz dhe është më afër se asnjëherë tjetër me Allahun, sepse është i dobët e i pafuqishëm dhe është i dorëzuar tek Allahu. Ne e dimë, se profeti (a.s.) ka shkuar për vizitë tek çifutët, kur ata ishin sëmurë. Por nëse e ke obligim njëherë tek njerëzit e tjerë, mendo si është puna e vëllait tënd, që pret vizitën tënde. Pra shkoji për vizitë vëllait tënd, ngushëlloje dhe jepi atij durim e shpresë. Ditën e Gjykimit Zoti i thotë njeriut: “O bir i Ademit, U sëmura dhe nuk erdhe të më shikosh”. Njeriu thotë: “I lartësuar qofsh ti o Zot. Po ku sëmuresh Ti”?! Allahu thotë: “U sëmuri rob i Im. Po të vije tek ai, do të më gjeje Mua aty”. Profeti (a.s.) thotë: **“Ai që bën nijet dhe niset të vizitojë vëllain e tij të sëmurë, 70.000 melekë e shoqërojnë atë person dhe lutën për të derisa të kthehet”**.⁴ Të gjithë e kemi provuar, se kur sëmuremi dhe nuk na vjen kush për vizitë, na mbetet merak kjo gjë. Prandaj sa herë që profeti (a.s.) merrte vesh se dikush është sëmurë, menjëherë nxitonte t’i shkonte për vizitë.

6- NËSE VËLLAI YT VDES, SHOQËROJE XHENAZEN E TIJ.⁵

Ky është obligimi i fundit që ke ndaj vëllait tënd. Të marrësh pjesë në xhenazen e dikujt, ka sevap shumë të madh. Profeti (a.s.) thotë: **“Kush e shoqëron xhenazen e një muslimani dhe e pret derisa të varroset, merr dy male me sevape. Nëse nuk pret derisa të varroset, merr vetëm një mal me sevape”**.⁶ Pra ky veprim është sevap për ne, por është gjithashtu edhe lehtësim për të vdekurin, sepse profeti (a.s.) thotë: **“Nëse mbledhen dyzet persona për të falur xhenazen e një besimtari, Zoti i bën ata ndërmjetës për atë person dhe e fut atë në xhenet”**.⁷ Prandaj merr pjesë në xhenazen e vëllait tënd musliman, sepse kjo është dita, kur ai ka më shumë nevojë se kurrë për duanë (lutjen)

3. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (6223), Muslimi (2995) dhe Ebu Daudi (4999).

4. **Hadith i vërtetë.** Ibn Maxheh (1442) dhe Ebu Daudi (3099). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

5. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (1240) dhe Muslimi (2162). Në rivajetin e Buhariut përmenden pesë detyrime, ndërsa rivajeti i Muslimit përmend gjashtë detyrime.

6. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (1325) dhe Muslimi (945).

7. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (948).

tënde. Kur dikush vdiste, profeti (a.s.) shkonte tek varri i atij personi dhe lutej: **“O Zot fale, o Zot mëshiroje, zgjeroja varrin, bëja kopsht prej kopshteve të xhenetit dhe jo gropë prej gropave të zjarrit, falja gjynahet dhe prite me mëshirën Tënde”**.⁸ Prandaj prania jote në xhenazen e dikujt është gjë e mirë për ty, për atë që ka vdekur dhe për të afërmit e tij. Kjo është ftesë në vetvete. Nuk është njëlloj si ai që e provon e si ai që flet. Na ka ndodhur të gjithëve të marrim pjesë në xhenazet e vëllezërve tanë, por është ndryshe kur të tjerët marrin pjesë në xhenazen e njeriut tënd të afërm. Kur njerëzit lënë punën dhe vijnë për të marrë pjesë në xhenazen e një muslimani, pa pasur asnjë interes, kjo është ftesa më e madhe që mund të bëhet, sepse të afërmit e atij që ka vdekur e kuptojnë, se këta njerëz i ka sjellë në këtë vend vetëm vëllazëria e besimit që kanë pasur me të vdekurin, mëshira e Zotit dhe sevapi i Tij.

Prandaj lus Zotin e gjithësisë të na mundësojë t’i bëjmë këta punë, të na mundësojë që t’i rregullojmë kohët tona, detyrimet tona, po gjithashtu t’i kryejmë edhe detyrimet ndaj këtyre myslimanëve të tjerë. Njeriu mund ta rregullojë edhe me pak të mira aty ku s’ia merr mendja, por mund ta prishë edhe me pak gjëra aty ku nuk ja merr mendja. Inshallah dëshira është e madhe, po shpresojmë që të ekzistojë edhe mundësia, se me të vërtetë ka shumë mundësi për të ofruar një model të mirë për njerëzit e tjerë. Zoti na mundësoftë t’i bëjmë këta punë.

Këto ishin gjashtë detyrime të përmendur në një hadith dhe po i përsëris edhe njëherë shumë shkurt:

- 1- Kur ta takosh një mysliman, jepi selam atij.
- 2- Kur të të ftojë, përgjigju ftesës së tij.
- 3- Kur kërkon këshillë, këshilloje atë.
- 4- Kur teshtin, lutu për të.
- 5- Kur sëmuret, vizitoe atë.
- 6- Kur të vdesë, shko dhe fali xhenazen atij.

Ka disa rregulla disa detyrime të tjera, të cilat i kam zgjedhur. Ato janë:

- Detyrimi i një myslimani ndaj një tjetri është **dua** (lutja) për të, pra është detyrë të lutesh për vëllain tënd mysliman. Prandaj po të shikoni duatë e besimtarëve në Kuran, ata lutën për vëllezërit e tyre dhe për ata që kanë kaluar përpara tyre, se vëllazëria është e madhe e muslimanët nuk janë vetëm ata që sheh me sy. Ka shumë muslimanë

8. **Hadith i dobët.** Tirmidhiu (2460). Shejh Albani e vlerëson hadithin shumë të dobët, ndërsa shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të dobët, por për pjesë të hadithit ka dëshmi përforcuese.

në botë, ka dhe shumë të tjerë që kanë kaluar në shpinën e kësaj toke dhe ka shumë të tjerë që do të vijnë mbas nesh, prandaj muslimani e ka lutjen e madhe. Duaja e tij nuk ka kufij dhe profeti (a.s.) i mësonte shokët e tij, të bënin dua për njëri-tjetrin, madje i mësonte të bënin dua edhe për atë vetë personalisht. Mos mendon se profeti (a.s.) ka nevojë për lutjet e ndonjë njeriu? Thonë, që kur e çoi një herë Omerin (r.a.) në një mision, i tha: “Mos na harro me dua o vëllaçko”, pra ia tha me përkëdheli. Imagjino se çfarë ndikimi kishte kjo tek Omeri (r.a.), që profeti (a.s.) i kërkon atij të lutet për të (a.s.). Profeti Muhamed (a.s.) i mësonte gjithmonë shokët e tij, të bënin dua për njëri-tjetrin, madje ka pasur prej pasuesve të sahabëve, që në duatë

vëllain tënd”. Pra në këtë rast ti indirekt po bën një dua për vete. Lutu për tjetrin, sepse lutja të kthehet edhe tek vetja jote. Duaja është obligim për të gjithë muslimanët. Nëse një musliman ka një problem dhe ti s'ke mundësi ta ndihmosh me ndonjë mënyrë tjetër, atëherë lutu për të, se ndoshta duaja jote ka peshë të madhe dhe sot kemi vëllezër në katër anët e botës, që kanë nevojë për lutjet tona.

- Detyrim tjetër është **ta falësh muslimanin, kur ti ke mendim të ndryshëm me të**. Asnjëherë nuk kanë qenë dy muslimanë me mendime të njëjta. Ibn Tejmija thotë kështu: “Nëse dy muslimanë do të ziheshin me njëri-tjetrin vetëm se kanë mendime të ndryshme, s'do të ngeleshin dy muslimanë në këtë botë, që do të ishin të pajtuar”. S'ka njerëz që kanë

“NËSE DY MUSLIMANË
DO TË ZIHESHIN ME NJËRI-TJETRIN
VETËM SE KANË MENDIME
TË NDRYSHME,
S'DO TË NGELESHIN
DY MUSLIMANË NË KËTË BOTË,
QË DO TË ISHIN TË PAJTUAR”

e tyre nuk thoshin vetëm “O Zot fali muslimanët dhe muslimanet besimtarët dhe besimtare”, por i përmendnim tek për tek me emra, saqë njëri prej tyre thoshte: “70 emra i kam gjithmonë gjithmonë ndërmend, kur lutem”. A e dini çfarë peshe ka kjo tek Zoti? Çfarë peshe ka në zemër, kur e përmend dhe emrin e tjetrit.

Të mësojmë të bëjmë dua edhe për të tjerët. Le të mos tregohemi egoistë, sepse shpeshherë mendojmë, se duaja është vendi ku ne jemi afër me Zotin, dhe njeriu ndjen një kënaqësi të madhe, kur ia hap zemrën Zotit dhe i lutet për problemet e veta. Megjithatë mos i harroni njerëzit e tjerë, sepse për atë njeri, i cili lutet për vëllain e tij, engjëjt i thonë: “Zoti të dhashtë edhe ty si ajo që po lutesh për

mendime të njëjta, sepse pa dyshim që çdonjëri do të ketë mendim të ndryshëm nga tjetri, pprandaj mos u mërzit për këtë gjë. Kjo fe është e madhe dhe ka lënë hapësira për mendime ndryshe. Shokët e profetit (a.s.) kanë pasur mendime të ndryshme, kanë pasur edhe konflikte, por profeti (a.s.) i mësoi, që të mos urrehen, të mos përçahen për mendimet që i kanë të ndryshme, i mësoi që edhe kjo është e drejtë edhe kjo është e drejtë. Është hak i një muslimani ndaj një muslimani tjetër, që ta falë atë, kur ka mendime ndryshe nga ai. Sot shohim se ka njerëz, të cilët duan të shkosh drejt Zotit ashtu sikur do ai, pra sipas rrugës së tij. Këta njerëz harrojnë, se rruga për tek Zoti është e madhe dhe e gjerë. Është e vërtetë që është vetëm një rrugë, por ama ajo është

shumë e gjerë. Mund të ketë mendime dhe ide të ndryshme. Kjo rrugë ka mbajtur shumë njerëz para nesh, dijetarë të mëdhenj, të cilët kanë pasur debate me njëri-tjetrin, por asnjëherë nuk e kanë prishur zemrën. Pra fale vëllain tënd që ka mendim të ndryshëm nga mendimi yt.

Ekziston një rregull i artë: **“Ejani të bashkëpunojmë për ato gjëra që biem dakord dhe ta falim njëri-tjetrin për ato gjëra, që nuk biem dakord. Të paktën të ketë bashkëpunim për atë pika ku biem dakord”**. Shpesh njeriu shikon pika, ku nuk bie dakord me tjetrin dhe nuk bashkëpunon me të, por po të shikojmë mirë, do të vërejmë se kemi shumë mendime të përbashkëta. Por për një arsye apo për një tjetër, sot muslimanët nuk bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sepse shikojnë vetëm dallimet mes tyre. Shembulli më i mirë për bashkëpunim me tjetrin janë imamët e medh’hebeve Ebu Hanife, Maliku, Shafiu dhe Ahmed. Kur shikon pasuesit e këtyre imamëve, të krijohet ideja se imamët kanë qenë armiq të njëri-tjetrit. Por po të lexosh historitë e tyre, do të gesh se kur ata takoheshin mes tyre, puthnin dorën e njëri-tjetrit dhe toleronin mendimet e njëri-tjetrit. Kur imam Shafiu shkoi në Irak, aty ku gjendej varri i Ebu Hanifes dhe kur fali namazin e sabahut (shafiiitë kur falin sabahun bëjnë dua dhe i ngrenë duart), ai nuk i ngriti duart. Nxënësit e tij i thanë: “O Imam. Një dijetar nuk ka të drejtë ta lerë mendimin e tij. Pse e bëre këtë”? Imam Shafiu u përgjigj: “E lashë në shenjë respekti ndaj këtij njeriu, që është në varr (ndaj Ebu Hanifes)”. Pra ata kishin mirëkuptim me njëri-tjetrin dhe asnjëherë nuk e akuzonin tjetrin në nijet, pasi atë e di vetëm Zoti.

- Detyrim tjetër i muslimanit është, **t’ia mbulojë të metat tjetrit**. Nuk ka njeri pa të meta, prandaj ai që kërkon një shok pa të meta, nuk ka për të gjetur asnjë shok. Mund të shohësh dikë, që bën një gabim të madh, prandaj ruaje atë dhe mbuloja gabimin, përveç rastit kur bëhet fjalë për një padrejtësi që ai i bën dikujt tjetër. Por kur ai po bën një gjynah për veten e tij, atëherë ti këshilloje atë dhe mos ia zbulo të metat përpara njerëzve të tjerë. Sikur Zoti t’i zbulonte gjynahet tona para njerëzve të tjerë, s’do të gjeje më dy vetë bashkë. Thonë se çifutëve iu shkruhej në derë gjynahu, që kishin bërë një natë më parë. Por Zoti e ka mëshiruar shumë umetin e profetit (a.s.) dhe ua ka mbuluar gjynahet. Zoti është Mbulues prandaj edhe besimtari duhet të jetë mbulues i gabimit të tjetrit. Profeti (a.s.) thotë:

“Kush e mbulon të metën e një muslimani në dynja, Zoti do ta mbulojë atë person në dynja dhe ahiret”.⁹ Kjo nuk bie ndesh me këshillën, pasi mbulimi është diçka tjetër. Ka njerëz që janë të sëmurë me këtë sëmurdje, pra me nxjerrjen në shesh të gabimeve të të tjerëve, a thua se filani është dërguar nga Zoti që të zbulojë gabimet e të tjerëve, duke harruar kështu veten e tij. Këta njerëz janë të ligj dhe fatkeq. Ata përfundojnë viktimitë e vetes së tyre. Profeti (a.s.) thotë: **“Kush i ndjek gjynahet dhe të metat e vëllait musliman, Zoti do ta turpërojë atë person qoftë edhe në dhomën e gjumit”**.¹⁰ Zoti nuk bën padrejtësi. Të gjithë kemi të meta, por ne duhet t’ia mbulojmë të metat njëri-tjetrit, nëse nuk i bëhet padrejtësi kujt dhe kjo nuk bie ndesh me dhënien e këshillës.

- Detyrim tjetër është që **t’ia pranosh betimin muslimanit**. Në radhë të parë mos e detyro që të betohet, mos i thuaj: “Betohu për Zotin”, sepse muslimani nuk gënjen kur flet, por nëse ai betohet dhe thotë: “Vallahi nuk e kam bërë këtë gjë”, atëherë duhet ta besosh atë. Këto ishin disa nga të drejtat që ka një musliman ndaj një vëllai tjetër musliman. Profeti (a.s.) na i ka mësuar të gjitha këto të drejta dhe detyrime.

Kjo lidhje nuk i pëlqen fare shejtanit, i cili nuk është aspak i lumtur, kur i shikon muslimanët që kanë lidhje të mira me njëri-tjetrin, janë të bashkuar dhe marrin pjesë në gëzime e në hidhërime. Pasuesit të shejtanit sado që mundohen për të pasur marrëdhënie të tilla, përsëri nuk ia arrijnë këtij qëllimi. Ata e kanë zili këtë lloj lidhjeje dhe do të mundohen me çdo formë ta prishin atë, por duhet të kemi parasysh disa gjëra, që vetë ne i prishim. Ato janë:

1- Gjëja e parë që e prish këtë vëllazëri, është **padrejtësia**. Nëse ka padrejtësi mes vëllezërve, nëse vetë ti ke bërë padrejtësi, dije se këtu nuk mban puna, dije se këtu fillon e shkatërrohet vëllazëria. Prandaj ji i drejtë me çdo njeri, madje tregohu i drejtë edhe me armiqtë e tu, sepse kjo është më afër devotshmërisë. Zoti na urdhëron të jemi të drejtë me miqtë dhe me armiqtë tanë. Atëherë, nëse urdhërohesh të jesh i drejtë me armiqtë, ç’mund të thuash për qëndrimin vëllezërve të tu!? Atëherë kij frikë Zotin. Profeti (a.s.) ka thënë: **“Muslimani është vëllai i mus-**

9. **Hadith i vërtetë**. Muslimi (2999).

10. **Hadithi i vërtetë për shkak të dëshmime përforcuese**. Ebu Daudi (4880). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë për shkak të dëshmime përforcuese.

limanit dhe nuk i bën padrejtësi atij".¹¹ Cilësia e parë e një muslimani është, se nuk i bën padrejtësi vëllait musliman. Padrejtësia e prish vëllazërinë, sidomos kur e ndjen që vëllai yt, njeriu yt i afërt të bën padrejtësi. Prandaj mos na bëftë Zoti njerëz të padrejtë as ndaj besimtarëve e as ndaj jobesimtarëve, aq më tepër ndaj vëllezërve tanë.

2- E dyta që prish vëllazërinë është **tallja dhe përbuzja qoftë edhe me shaka**. Pra nuk duhet të tallesh me tjetrin, ta vësh në lojë atë. Na ndodh që ta bëjmë këtë gjë, ndonjëherë me qejf, ndonjëherë me shaka. Por kjo është nga ato gjëra, që e prishin vëllazërinë, sepse tjetri mund ta durojë një herë dhe dy herë dhe nuk e duron më. Ose ke për ta ulur vëllain tënd musliman dhe ai do ta durojë këtë për hir të vëllazërisë, ose ai nuk ka forcë të reagojë, ose ti ke për ta thyer këtë vëllazëri. Shpesh e prishim në këtë pikë, duke bërë shaka dhe harrojmë që e vemë vëllain tonë në pozitë të vështirë, saqë ai nuk di se çfarë të bëjë, a të ta ktheje me forcë apo të durojë. Prandaj profeti (a.s.) na mëson, që t'i drejtohem tjetrit me fjalë sa më qetësuese. Profeti (a.s.) thotë: **"I mjafton muslimanit si gjynah, që ta përbuzë vëllain e tij"**.¹²

3- Ajo që e prish vëllazërinë është **paragjykimi**. Të mendosh keq për tjetrin e të jetosh me dyshime, do të thotë ta prishësh vëllazërinë. Profeti (a.s.) thotë: **"Kini kujdes nga paragjykimi, se është gënjeshtër më e madhe"**.¹³ Pra të ndërtosh një ide thjesht duke dyshuar. Nëse ke dëgjuar diçka për të, është më mirë ta marrësh anash dhe ta pyesësh nëse ajo që ke dëgjuar është e vërtetë apo jo. Profeti (a.s.) u thoshte shokëve të tij: **"Mos më flisni për të tjerët, por më lini që t'i njoh vetë njerëzit"**. Kur dikush të thotë një fjalë për dikë, dashje pa dashje krijon një mendim për atë njeri dhe kur e shikon tjetrin e mat mbi bazën e asaj që ke dëgjuar. Paragjykimi e prish

vëllazërinë dhe burrëria më e madhe është ta pyesësh tjetrin për atë që ke dëgjuar, të sqarohesh e të mos mbash gjë në zemër, sepse zemrat largohen vetvetiu nga njëra-tjetra.

4- Gjë tjetër që e prish vëllazërinë është **përgojimi**. Ky është kanceri i lidhjeve tona, sidomos kur përgojimi bëhet i ëmbël. Për këtë kemi ndalesa nga Kurani dhe nga hadithet e profetit (a.s.). Ajo që e prish vëllazërinë është smira, zemërimi, inati dhe debati i fortë. Në përgjithësi shikojmë, se kur bëhet debat, njerëzit bëhen nervozë për diçka që është shumë e thjeshtë. Pastaj muhabeti kalon në inat personal, në armiçësi, e cila nisi për diçka shumë qesharake. Në vëllazëri duhet pasur kujdes se si e thua fjalën, çfarë fjalësh thua dhe sido që të jetë puna, nuk duhet që debati të kalojë në inat personal. Prandaj replikat nuk janë shumë të pëlqyeshme. Profeti (a.s.) ndërhynte gjithmonë, kur nuhaste se debati po kthehej në inat personal, sepse shejtani luan me zemrat e njerëzve.

5- Vëllazërinë e prish **nervozizmi**, e prishin fjalët e pamatura dhe debati që bëhet thjesht për të kundërshtuar mendimin e tjetrit.

6- Vëllazërinë e prish **mendjemadhësia**. Njeriu nuk e duron mendjemadhësinë, aq më tepër kur ta bën ai që është vëllai yt. Ajo mund të jetë për shkak posti, për shkak pasurie apo familjeje. Prandaj profeti (a.s.) ulej bashkë me sahabët e tjerë dhe çdokush e ndjente veten të barabartë me të (a.s.). Nuk mbahet mend asnjë rast, kur ai ka dalë sipër tyre dhe po të mos ishte drita e fytyrës dhe sjelljet e tij, ai (a.s.) nuk do të njihej mes shokëve të tij.

E lus Zotin t'i afrojë zemrat tona, të na bëjë vëllezër që meritojnë ndihmën e Zotit në dynja dhe mëshirën e Zotit në ahiret, ta largojë shejtanin nga zemrat tona dhe të gjitha këto sëmundje që përmendëm. E lus Allahun që t'i japim hakun vëllazërisë, ta meritojmë emrin vëllezër dhe u bëftë kjo vëllazëri shkak për të mira në këtë botë dhe për faljen e Zotit në botën tjetër.

Amin!

11. **Hadith i vërtetë**. Muslimi (2580).

12. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (6076) dhe Muslimi (2559).

13. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (6066) dhe Muslimi (2563).

SHUMË UJË PAK KALORI:



9 Ushqimet më të Mira të Verës

Balanca mes hidratimit dhe djegies së kalorive është mëse e nevojshme të ruhet rregullisht, sidomos në stinën e verës.

Këto ushqime të shëndetshme të listuara, të cilat jo vetëm hidratojnë, por edhe përmirësojnë energjinë, përqendrimin dhe shëndetin e përgjithshëm e mbi të gjitha kanë pak kalori.



KASTRAVECI

Kastraveci është një ndër ushqimet më hidratuese në botë.

95 përqind e përmbajtjes së tij përbëhet nga uji dhe një pjesë e mirë e vitaminës K.

Për më tepër ai ka pak kalori dhe nuk ju shëndosh.



SELINOJA

95 përqind e selinosë përbëhet nga uji dhe për fat të mirë është një ushqim me pak kalori.

Selinoja është një ushqim freskues dhe shumë hidratues dhe me pak kalori.



SPECAT

Sipas të dhënave të AgroWeb.org, specat janë të pasur me antioksidantë dhe vitaminë C.

Për më tepër, 92 përqind e tyre përbëhet nga uji.


Për pasojë, speci ju ndihmon të humbisni në peshë.



PJEPRI

Pjepri përbëhet nga 90 përqind ujë dhe është një nga ushqimet që hidratojnë më shumë dhe me pak kalori

Pjepri është i pasur me vitaminë A, C shumë nga vitaminat e kompleksit B.



QITRO

Qitro është një frut me shumë vlera të mira shëndetësore dhe ka aftësinë të shuajë oreksin, duke përsheptuar metabolizmin nga ana tjetër

Qitro përmban 90 përqind ujë, njësoj si pjepri.

SPINAQI

Spinaqi është një ushqim që i bën shumë mirë organizmit dhe hidratimi është një nga vlerat më të mira të tij.

Spinaqi përmban 91 përqind ujë ndaj është një nga barishtet më të shëndetshme që mund të konsumoni.

DOMATJA

Spinaqi i lartpërmendur kombinohet mjaft mirë me domaten.

Ajo është një nga ushqimet më hidratuese me një përmbajtje ujore prej 94 përqind.

Për më tepër, domatja përmban edhe sasi domethënëse të biotinës, vitaminave C dhe K.

RREPKAT

Rrepkat e kuqe krokante dhe pak të athëta përmbajnë shumë ushqyes të rëndësishëm dhe 95 përqind e tyre përbëhet nga uji, sipas informacioneve të AgroWeb.org.

SHALQINI

Shalqini është fruti ynë më i preferuar i verës.

91 përqind e strukturës së tij përbëhet nga uji.

Ky frut kaq i shijshëm dhe i lëngshëm përmban edhe doza të shëndetshme të vitaminës A, B6 dhe shumë antioksidantë.

SI NDIKON XHENXHEFILI



në Shkrirjen e Dhjamit në Trup

Xhenxhefili, si një përbërës i recetave dhe çajrave, mund të mbrojë organizmin nga dhjami i tepër si dhe ndaj sëmundjeve kronike.

Konsumimi i xhenxhefilit është një metodë e zgjuar dhe e thjeshtë parandaluese e shumë problemeve.

Një nga shqetësimet që nuk po i kushtohet shumë vëmendje është pikërisht tretja.

Mjekë dhe studiues të ndryshëm kanë vërtetuar se tretja është një nga shkaktarët kryesorë të sëmundjeve të zemrës apo dhe përkeqësimit të simptomat e diabetit e tipit 2.

Janë publikuar artikuj ku janë paraqitur efektet mirëbërëse të xhenxhefilit, si dhe kura të ndryshme të cilat ndihmojnë aparatit tretës në funksionet e tij.

Si ndikon xhenxhefili në organizëm

Arsyeja se pse xhenxhefili është ushqimi ideal për eliminimin e dhjamit në organizëm, vjen si pasojë e fotoenzimave dhe antioksidantëve të shumtë që ai përmban.

Këto dy substanca luajnë rolin kryesor në djegien e dhjamit, tretjen e karbohidrateve dhe sekretimin e insulinës, përveç të tjerave.

Gjithashtu xhenxhefili ka aftësi parandaluese për inflamacionin, uljen e kolesterolit dhe tensionit të gjakut, si dhe formimin e kalcifikimeve në kapilarë dhe arterie.

Cila është mënyra e duhur për ta konsumuar?

Nuk është fare e rëndësishme.

Mund ta pini si çaj, ta konsumoni si erëz, apo dhe të përfshirë nëpër gatimet tuaja, efekti do të jetë i njëjti.

Në momentin që xhenxhefili bie në kontakt me enzimat tretëse të stomakut, fillon të përshpejtojë tretjen me 30%.

Pasi substancat e tij përthithen nga organizmi, fotoenzimat nxisin djegien e dhjamit dhe heqin ndjesinë e urisë. Duke qenë se masa e dhjamit dhe yndyrnave në trup bie, ka një ndryshim të dukshëm në nivelet e kolesterolit.

Xhenxhefili dhe shëndeti i organeve jetësore

Të dhëna nga studime të ndryshme tregojnë dhe funksionin e xhenxhefilit për ekuilibrimin e tensionit të gjakut. Aftësitë e tij antioksiduese dhe anti-inflamatore bëjnë të mundur shkrirjen e yndyrnave që grumbullohen në kapilarë dhe arterie.


Kjo rezulton në një qarkullim gjaku më të mirë, dhe si pasojë zemra është e mbrojtur.

Një tjetër pasojë pozitive që ka xhenxhefili në organizëm është pikërisht shkrirja e dhjamit që krijohet rreth organeve. Diçka e tillë lehtëson dukshëm funksionin dhe përmirëson shëndetin e tyre.

Gjithashtu xhenxhefili lehtëson dhe dhimbjet muskulare. Duke qenë se përmirëson qarkullimin e gjakut, muskujt furnizohen më mirë me oksigjen.

Por jo vetëm, kjo erëz lufton inflamacionin e tyre dhe nxit rigjenerimin e qelizave muskulare.





“Ai ua pranoi pendimin
edhe atyre të treve,
që mbetën prapa atëherë,
kur toka, sado e gjerë,
iu duk e ngushtë dhe
iu shtrënguan shpirtrat,
aq sa u bindën
se nuk ka strehim tjetër
përveç Allahut e pastaj
Allahu u dha mëshirë
që të pendohen. Me të vërtetë,
Allahu pranon pendimin
dhe është Mëshirëplotë.”

(Teube, 118)

